
RAPORT STUDIMOR MBI FENOMENIN E MIGRACIONIT TË PARREGULLT NË SHQIPËRI (2018-2021)

Analizë dhe gjetje mbi çështje të
luftës kundër kontrabandimit të
migrantëve dhe respektimit të të
drejtave të tyre

Autor

Anila SHEHI (DOLLANI)

Dizajni dhe faqosja
Elisa TËRSHANA

© Shoqata “Albanian Initiative for Development”
Tiranë, Janar 2022

Për dijeni

Ky Raport Studimor u prodhua në kuadër të nismës “Siguria për Qeniet Njerëzore dhe Kufijtë - Luftimi i Kontrabandës së Migrantëve në Ballkanin Perëndimor”, mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjesi vetëm e Shoqatës “Albanian Initiative for Development” dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Fotografia në kopertinë marrë nga Shutterstock image, Kontribues Andrey Popov “Silhouette Of Refugees People with Luggage Walking in A Row”.

Tabela e Përmbajtjes

I.	Përmbledhje ekzekutive.....	6
II.	Hyrje.....	8
III.	Metodologjia.....	9
IV.	Vështrim i përgjithshëm mbi situatën e migracionit të parregullt nga vendet e treta në Shqipëri për periudhën 2018-2021.....	11
	4.1 Një panoramë e flukseve të përzierra migratore gjatë viteve 2018-2021	11
	4.2 Parandalimi i migracionit të parregullt dhe lufta ndaj kontrabandimit të migrantëve	18
	4.3 Respektimi i të drejtave të migrantëve	27
V.	Analizë e kuadrit rregullator për migracionin e parregullt, parandalimin e tij dhe respektimin e të drejtave të migrantëve.	35
	5.1 Kuadri ligjor dhe strategjik gjatë viteve 2018 – qershor 2021 mbi çështjet e migracionit të parregullt në Shqipëri.....	35
	5.2 Analizë kronologjike e zbatimit të legjislacionit dhe politikave mbi migracionin sipas Raporteve të Komisionit Evropian 2018-2021	42
	5.3 Një vështrim krahasues me praktikën e BE-së dhe standarteve më të mira ndërkombëtare.....	46
VI.	Analiza e pyetësorëve të kryer	51
VII.	Përfundime	61
VIII.	Rekomandime.....	63
IX.	Bibliografia.....	65
X.	Aneks I.....	69

Lista e shkurtimeve

BE	Bashkimi Evropian
DASH	Departamenti Amerikan i Shtetit
ECRI	Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës
EUROPOL	Zyra Evropian e e Policisë
FRONTEX	Agjencia Evropian e e Kufirit dhe e Rojes Bregdetare
ILO	Organizata Ndërkombëtare për Punën
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
MARRI	Iniciativa Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët
MB	Ministria e Brendshme
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
PSH	Policia e Shtetit
PSV	Procedura Standarte Veprimi
RSH	Republika e Shqipërisë
SELEC	Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore
TIP	Trafikimi i Personave
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
VMT	Viktimë e Mundshme Trafikimi
VT	Viktimë Trafikimi

FJALORTH¹

Migrim ●●● Lëvizja e personave larg vendbanimit të tyre të zakonshëm, qoftë përtej një kufiri ndërkombëtar ose brenda një shteti.

Migrim i parregullt ●●● Lëvizja e personave që ndodh jashtë ligjeve, rregulloreve ose marrëveshjeve ndërkombëtare që rregullojnë hyrjen ose daljen nga shteti i origjinës, transitit ose destinacionit.

Migrant ●●● një person që largohet nga vendbanimi i tij ose i saj i zakonshëm, qoftë brenda një vendi ose përtej një kufiri ndërkombëtar, përkohësisht ose përgjithmonë, dhe për një sërë arsyesh².

Lëvizje të përziera migratore (ose flukse të përziera migratore) ●●● Një lëvizje në të cilën një numër njerëzish udhëtojnë së bashku, përgjithësisht në mënyrë të parregullt, duke përdorur të njëjtat rrugë dhe mjete transporti, por për arsye të ndryshme. Njerëzit që udhëtojnë si pjesë e lëvizjeve të përziera kanë nevoja dhe profile të ndryshme dhe mund të përfshijnë azilkërkues, refugjatë, persona të trafikuar, fëmijë të pashoqëruar/të ndarë dhe migrantë në një situatë të parregullt.

Azil ●●● Dhënia, nga një shtet, e mbrojtjes në territorin e tij personave jashtë vendit të shtetësisë ose vendbanimit të tyre të zakonshëm, të cilët ikin nga persekutimi ose dëmtimi serioz ose për arsye të tjera.

Azilkërkues ●●● Një individ që kërkon mbrojtje ndërkombëtare. Në vendet me procedura të individualizuara, azilkërkues është dikush, kërkesa e të cilit ende nuk është vendosur përfundimisht nga vendi në të cilin ai/ajo e ka paraqitur atë. Jo çdo azilkërkues do të njihet përfundimisht si refugjat, por çdo refugjat fillimisht është një azilkërkues.

Grup i organizuar kriminal ●●● Një grup i strukturuar prej tre ose më shumë personash, që ekzistojnë për një periudhë kohore dhe që veprojnë në bashkëpunim me synimin për të kryer një ose më shumë krime ose vepra të rënda, me qëllim që të përfitojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një financim ose përfitime të tjera materiale.

Kontrabandë (e migrantëve) ●●● Dhënia ndihmë, me qëllim që të përfitohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një përfitim financiar ose ndonjë përfitim tjetër material, për të mundësuar hyrjen e parregullt të një personi në një shtet ku ai nuk është shtetas ose banor i përhershëm i tij.

Trafikim i personave ●●● Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose marrja e personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, abuzimit me pushtetin ose një pozicion vulnerabiliteti ose i dhënies ose marrjes së

¹ Përkufizimet e këtij fjalorthi janë bazuar në IOM Glossary on Migration:

https://publications.iom.int/system/files/pdf/iml_34_glossary.pdf

² <https://www.iom.int/about-migration>

pagesave ose përfitimeve një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi.

Mbrojtja ndërkombëtare³ ●●● përfshin statusin e refugjatit dhe mbrojtjes plotësuese

Mbrojtja plotësuese⁴ ●●● është formë mbrojtjeje që i jepet shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi, që nuk i përmbush kriteret për të fituar statusin e refugjatit dhe ka arsye serioze e të bazuara të mendohet se në rast të kthimit të tij në vendin e origjinës apo në rastin e personit pa shtetësi në vendbanimin e tij të zakonshëm të mëparshëm, ai rrezikon realisht të përballët me cenime të rënda dhe nuk ka mundësi, apo për shkak të rrezikut të tillë nuk dëshiron të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi.

Kthimi dhe riintegrimi vullnetar i asistuar ●●● Mbështetje administrative, logjistike dhe/ose financiare, duke përfshirë ndihmën për riintegrim, për migrantët që nuk janë në gjendje ose nuk dëshirojnë të qëndrojnë në vendin pritës ose vendin e tranzitit dhe që vendosin të kthehen në vendin e tyre të origjinës.

Parimi i non-refoulement ●●● Ndalimi i shteteve për të ekstraduar, deportuar, dëbuar ose kthimin e një personi në një vend ku jeta ose liria e tij/saj do të kërcënohej, ose ku ka arsye thelbësore për të besuar se ai/ajo do të rrezikonte t'i nënshtrohej torturës ose trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore dhe poshtëruese, ose do të rrezikohej t'i nënshtrohej një zhdukjeje me forcë ose të pësonte një dëm tjetër të pariparueshëm.

Refugjat ●●● një person që është arratisur nga vendi i tij për arsye politike, fetare, ekonomike ose për shkak të një lufte⁵.

Vendi i destinacionit ●●● Në kontekstin e migracionit, një vend që është destinacioni për një person ose një grup personash, pavarësisht nëse ata migrojnë rregullisht apo në mënyrë të parregullt.

Vendi i origjinës ●●● Në kontekstin e migracionit, një vend i kombësisë ose i ish-rezidencës së zakonshme të një personi ose grupi personash që kanë emigruar jashtë vendit, pavarësisht nëse migrojnë rregullisht ose në mënyrë të parregullt.

Vendi i tranzitit ●●● Në kontekstin e migracionit, vendi nëpër të cilin kalon një person ose një grup personash.

³ Neni 3 të ligjit nr.10/2021” Për Azilin në RSh”, pika 18.

⁴ Ibid, pika 19

⁵ <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/refugee>

KREU I

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria është një nga vendet e Ballkanit Perëndimor që njihet si rrugë e migrantëve të parregullt për të kaluar drejt vendeve të BE-së. Pas vitit 2015 numrat e migrantëve të parregullt që kanë hyrë në territorin shqiptar kanë pësuar vetëm rritje⁶. Edhe pse gjatë intervistimit nga autoritet shtetërore, shumica e migrantëve kërkojnë azil, pjesa më e madhe e tyre largohen nga territori shqiptar pa përfunduar procedurat e azilit, duke u kontrabanduar nga persona apo grupe trafikantësh. Vetëm një pjesë e vogël e migrantëve të parregullt asistohen për t'u kthyer vullnetarisht apo ezaurojnë deri në fund procedurat e azilit duke e parë Shqipërinë si vend destinacioni.

Migrantët të cilët vijnë kryesisht nga vendet e Lindjes së Mesme apo vendet në konflikt, qëllim të vetëm kanë mbërritjen drejt vendeve të BE-së, ç'ka nxit trafikantët apo grupet kriminale që të shfrytëzojnë kërkesën në rritje për këtë qëllim, duke kontrabanduar migrantë kundrejt përfitimeve të mëdha monetare. Pasojat e migrimit të paligjshëm janë të mëdha dhe çënojnë të drejta themelore të njeriut.

Ky raport studimor *së pari* vjen me një analizë të kuadrit legjislativ dhe strategjik në Shqipëri të katër viteve të fundit (2018-2021), duke u fokusuar në zbatimin e tij.

Së dyti, në këtë raport identifikohen problematikat në luftën kundër kontrabandimit të migrantëve të parregullt dhe respektimit të të drejtave të tyre.

Së treti, raporti referon në praktikat më të mira të bashkëpunimit rajonal dhe atij me agjencitë ligjzbatuese evropiane si FRONTEX e EUROPOL.

Së katërti, në raport bëhet një vlerësim i kapaciteteve të aktorëve kryesorë dhe palëve të interesuara që janë përfshirë në luftën kundër migracionit të parregullt.

Pjesë e këtij Raporti Studimor, janë dhe intervistat e realizuara me zyrtarët e strukturave të Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, në bazë të të cilave janë evidentuar disa gjetje dhe hartuar disa rekomandime mbi përmirësimin e kuadrit legjislativ dhe organizmit të strukturave përkatëse shtetërore.

Studimi tregon se pavarësisht masave të marra për të luftuar migracionin e parregullt, ky fenomen mbetet i pranishëm në Shqipëri dhe duket se përbën një problem në të gjithë vendin. Gjetjet kryesore të këtij studimi përfshijnë kryesisht nevojat për:

- ❖ Rishikim të legjislacionit kombëtar dhe përafrimin e tij me *acquis*-në e Bashkimit Evropian;
- ❖ Rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, logjistike dhe hetimore;
- ❖ Analizim të rasteve të bashkëpunimit midis agjencive të ndryshme shtetërore në lidhje me mbrojtjen e migrantëve të trafikuar, si dhe me EUROPOL, dhe evidentimi i faktorëve që i pengojnë ato për t'u cilësuar si bashkëpunime “shumë të mira”;

⁶<https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Policia-e-Shtetit-ANALIZA-VJETORE-2019.pdf.fq.16>;

- ❖ Vënien në dijeni të punonjësve të strukturave të posaçme për praktikat më të mira lokale, rajonale dhe ndërkombëtare mbi sigurinë e qenieve njerëzore dhe kufijve;
- ❖ Rritjen e koordinimit ndërmjet institucioneve të përfshira në menaxhimin e migracionit në Shqipëri;
- ❖ Përmirësim të bashkëpunimit ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve të mbrojtjes sociale.

Ky studim empirik ka për qëllim kryesor identifikimin e masave të nevojshme në luftën kundër migracionit të parregullt, dhe si i tillë ai mund të përdoret nga punonjësit e institucioneve shtetërore, studiuesit, akademikët dhe të gjithë aktorët e shoqërisë që janë përfshirë në veprimet për parandalimin dhe luftimin e migracionit të parregullt. Studimi është një kontribut i rëndësishëm sepse përbën një bazë të qëndrueshme për kërkime të mëtejshme.

KREU II

Hyrje

Shqipëria që pas vitit 2015 vazhdon të jetë një nga vendet më të prekura të Ballkanit Perëndimor nga flukset e përziera migratore të migrantëve të parregullt të ardhur nga vendet e treta, kryesisht ato të Lindjes së Mesme. Rruga e migrantëve të parregullt që kalojnë përmes kufirit greko-shqiptar njihet si korridori perëndimor⁷ dhe shifrat e detektimit të tyre kanë ardhur gjithnjë në rritje, sidomos pas fillimit të kryerjes së operacioneve të përbashkëta me Frontex pas hyrjes në fuqi në 1 Maj 2019 të “Marrëveshjes Statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë” ratifikuar me Ligjin nr.6/2019 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”.

Të dhënat e Frontex tregojnë se shumica e rasteve të raportuara të migrantëve klandestinë në kufijtë e jashtëm të BE-së kanë ndodhur në rajonin e Ballkanit Perëndimor, kryesisht nga meshkuj të moshës 18-34 vjec⁸. Ky fenomen ka shënuar rritje dhe në Shqipëri, ç’ka rezulton qartë dhe nga të dhënat statistikore të paraqitura në këtë raport studimor.

Me qëllim parandalimin dhe luftën kundër migracionit të paligjshëm, institucionet shtetërore kanë hartuar dhe miratuar një sërë aktesh ligjore, strategji e plane veprimi ku ndërthuren tre elementë:

- siguria e kufijve;
- menaxhimi i migracionit nëpërmjet garantimit të të drejtave të migrantëve;
- lufta kundër kontrabandimit dhe trafikimit të migrantëve të parregullt.

Raporti Studimor, sa i përket legjislacionit që nga viti 2018 e deri në vitin 2021, pasqyron disa ndryshime thelbësore që ka pësuar ai, si për shembull: ligji për të huajt, ligji për azilin, ligji për kontrollin kufitar e ligji për shtetësinë. Ndërsa sa i përket kuadrin strategjik, Raporti i referohet tre strategjive të reja kombëtare të miratuara gjatë kësaj periudhe, siç janë: Strategjia Kombëtare për Migracionin 2019-2022, Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027 dhe Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025.

Në këtë Raport Studimi do të paraqiten disa gjetje të rëndësishme në lidhje me çështjet e parandalimit të migracionit të parregullt, luftës ndaj trafikimit të migrantëve dhe respektimit të të drejtave të tyre, duke ofruar rekomandime konkrete të cilat u vijnë në ndihmë strukturave shtetërore përgjegjëse për migracionin.

⁷ Raporti i Frontex “Risk Analysis for 2020”, fq.24: <https://frontex.europa.eu/publications/frontex-releases-risk-analysis-for-2020-vp0TZ7>

⁸ ibid

KREU III

METODOLOGJIA

Ky studim është kryer në kuadër të projektit “Siguria për Qeniet Njerëzore dhe Kufijtë - Luftimi i Kontrabandës së Migrantëve në Ballkanin Perëndimor”, mbështetur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Metodologjia e zbatimit të projektit përfshin aktivitete hulumtuese.

Procesi i mbledhjes së të dhënave ka përfshirë shqyrtimin e dokumentacionit dhe punën në terren. Hulumtimi u përqendrua në disa aspekte kryesore: (1) analizimi i kuadrit ligjor në Shqipëri duke u fokusuar në zbatimin e tij; (2) identifikimin e problematikave në luftën kundër kontrabandimit të migrantëve të parregullt dhe respektimit të të drejtave të tyre; (3) analizimin e praktikave më të mira të bashkëpunimit rajonal dhe atij evropian me agjencitë ligjzbatuese; (4) vlerësimi i kapaciteteve të aktorëve kryesorë dhe palëve të interesuara që janë përfshirë në luftën kundër migracionit të parregullt.

Raporti është bazuar në të dhënat statistikore të institucioneve shtetërore, organizatave ndërkombëtare dhe agjencive ndërkombëtare ligjzbatuese. Ai jep një panoramë të plotë të gjithë kuadrit aktual ligjor, bazuar në një hulumtim të detajuar të këtij kuadri duke identifikuar dhe problematikat e hasura në praktikë. Janë mbledhur të dhëna nga legjislacioni, nga studimet e mëparshme në lidhje me këtë temë, nga artikuj të mediave, faqet zyrtare në internet dhe nga raportet.

Puna në terren përfshiu mbledhjen e të dhënave cilësore nga pyetësorët. U hartua një pyetësor për të mbledhur informacione nga përfaqësuesit e strukturave shtetërore përgjegjëse për çështjet e migracionit. Pyetësorët synuan të merrnin të dhëna në lidhje me kuadrin legjislativ dhe atë të politikave, arritjet dhe problematikat për zbatimin e tyre, bashkëpunimin ndërinstytucional dhe shkëmbimin e informacionit dhe së fundmi vlerësime mbi bashkëpunimin rajonal si dhe me agjencitë e huaja ligjzbatuese si: Frontex e Europol.

Për shkak të kufizimeve nga pandemia COVID-19, pyetësorët iu dërguan elektronikisht përfaqësuesve të strukturave shtetërore përgjegjëse për çështjet e migracionit, si dhe disa prej organizatave ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri në këtë fushë. Strukturat e përfshira në aktivitetet hulumtuese ishin Sektori Anti-trafik dhe Migracioni (Ministria e Brendshme), Departamenti i Kufirit dhe Departamenti Migracionit (Policia e Shtetit), Sektori i Trafikeve (Policia e Shtetit), Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit (Ministria e Brendshme), UNHCR, IOM, PAMECA.

Të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve u koduan dhe u analizuan duke përdorur programin softuer MAXQDA, duke kontribuar në identifikimin e disa gjetjeve të rëndësishme për çështjet që lidhen me parandalimin e migracionit të parregullt, luftën kundër trafikimit të migrantëve dhe respektimit të të drejtave të tyre. Raporti është strukturuar si më poshtë:

Seksioni vijues (*Seksioni IV*) “Vështrim i përgjithshëm mbi situatën e migracionit të parregullt nga vendet e treta në Shqipëri për periudhën 2018-2021” ofron një panoramë të flukseve të përziera migratore përgjatë periudhës katër vjeçare, të problematikave lidhur me parandalimin dhe luftën ndaj migracionit të parregullt si dhe të respektimit të të drejtave të migrantëve.

Seksioni V “Analizë e kuadrit rregullator për migracionin e parregullt, parandalimin e tij dhe respektimin e të drejtave të migrantëve” trajton ndryshimet e pësura vitet e fundit në legjislacionin kombëtar dhe kuadrin strategjik që rregullon çështje të migracionit. Në këtë seksion analizohet kronologjikisht zbatimi i legjislacionit dhe politikave mbi migracionin sipas raporteve të Komisionit Evropian, si dhe analizohen praktika e BE-së dhe standartet më të mira ndërkombëtare.

Seksioni VI “Analiza e pyetësorëve të kryer” trajton rezultatet e dala nga zhvillimi i intervistave mbi bazën e pyetësorëve, drejtuar specialistëve të institucioneve shtetërore përgjegjëse në fushën e migracionit. Gjetjet nga këta pyetësorë fokusohen në çështjet e parandalimit të migracionit të parregullt, respektimit të të drejtave të migrantëve dhe praktikatat më të mira.

Seksioni VII “Përfundime” dhe *Seksioni VIII* “Rekomandime” pasqyrojnë konkluzionet e dala nga analiza e bërë në këtë Raport Studimor bazuar në statistika, kuadër ligjor, raporte ndërkombëtare dhe pyetësorët e zhvilluar. Raporti mbyllet me disa rekomandime konkrete të cilat do të kenë një vlerë të shtuar për punonjësit e institucioneve shtetërore, studiuesit, akademikët dhe të gjithë aktorët e shoqërisë që janë përfshirë në veprimet për parandalimin dhe luftimin e migracionit të parregullt.

KREU IV

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI SITUATËN E MIGRACIONIT TË PARREGULLT NGA VENDET E TRETA NË SHQIPËRI, PËR PERIUdhËN 2018-2021.

4.1 Një panoramë e flukseve të përziera migratore gjatë viteve 2018-2021

Ashtu si vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria është prekur edhe nga flukset e përziera të popullatave, për arsye jo vetëm të kushteve socio-ekonomike, por edhe të konflikteve të ndryshme. Kategoritë e të huajve që mbërrijnë në Shqipëri, përfshijnë ndër të tjera refugjatë dhe azilkërkues, migrantë, viktimë të trafikimit, të mitur të pashoqëruar dhe të ndarë, si edhe persona pa shtetësi. Disa prej tyre janë pjesë e më shumë se një kategorie të vetme. Ata janë me shtetësi të ndryshme. Shumica janë sirianë dhe afganë dhe shpesh hyjnë në vend në mënyrë të parregullt. Në shumicën e rasteve, këta individë janë në një situatë të veçantë vulnerabiliteti për shkak të situatës në vendet e tyre të origjinës prej të cilave janë larguar, për shkak të kushteve të vështira, ose të shfrytëzimit dhe abuzimit të pësuar gjatë udhëtimit. Këto flukse kalojnë kryesisht tranzit në Shqipëri, përpara se të hyjnë në vendet e Bashkimit Evropian⁹.



Figura 1

Një vlerësim i kryer nga Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri në vitin 2018, tregon një rritje të mprehtë të numrit të personave të ndaluar në zonat kufitare. 3,088 persona janë ndaluar në gjashtë muajt e parë të vitit 2018, krahasuar me 1049 në të 12 muajt e vitit 2017. Kjo rritje shoqërohet edhe me një rritje të numrit të kërkesave për azil, të cilat arritën shifrën 1,901 në

⁹ Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani Veprimit 2019-2022, fq.8 & 9: https://www.mb.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Migracionin-dhe-Plani-i-Veprimit_2019-2022.pdf

gjysmën e parë të vitit 2018, nga 309 në vitin 2017. Këto shifra janë në fakt më të larta se ato të regjistruara në vitin 2015 gjatë pikut të fluksit të migrantëve në mbarë Evropën¹⁰.

Duke u bazuar në të dhënat dhe përshkrimin e flukseve migratore të paqyruara në Profilin e Zgjeruar të Migracionit 2015-2018¹¹ miratuar me VKM nr.222, datë 20.03.2020 “Për miratimin e Profilin të Zgjeruar të Migracionit për vitet 2015-2018”, rezulton se gjatë këtyre viteve, ka pasur përpjekje nga shtetas të Lindjes së Mesme dhe vendeve arabe për të kaluar tranzit nëpërmjet territorit të Shqipërisë. Migrantët nga vendet e treta hyjnë kryesisht në Turqi e më pas kalojnë në Greqi dhe, nëpërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, synojnë vendet e Bashkimit Evropian (BE) dhe më së shumti, ato veriore. Një nga drejtimet e lëvizjes së tyre është rruga Shqipëri - Mali i Zi - Kroaci dhe, më pas, vendet e BE-së. Figura e mëposhtme paraqet një ilustrim të rrugëve kryesore të përdorura nga shtetasit e vendeve të treta.



Figura 2: Rrugët e identifikuar të lëvizjes së migrantëve nga vendet e treta në 2018¹²


Trendin në rritje të numrit të migrantëve të parregullt që hyjnë në territorin shqiptar e paraqet më së miri dhe tabela e mëposhtme nr.1, bazuar në të dhëna zyrtare të Ministrisë së Brendshme, të reflektuara këto dhe në relacionin që shoqëron projektligjin e ri për azilin të miratuar në vitin 2021¹³.

¹⁰ Shiko Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani Veprimit 2019-2022, fq.9, https://www.mb.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Migracionin-dhe-Plani-i-Veprimit_2019-2022.pdf.

¹¹ Shiko linkun: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/03/12/222>

¹²Raporti i SELEC mbi migracionin e paligjshëm në Europën Juglindore, 2019, fq.15, shiko linkun: SELEC-Report-on-Illegal-Migration-in-SEE_public-version.pdf

¹³ Shiko linkun: <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2020/10/RELACION-AZILI.pdf>



Burimi: Profili i Migracionit 2017-2019, Ministria e Brendshme, Republika e Shqipërisë&UNHCR

Tabela 1. Numri i migrantëve të parregullt të kapur në territorin e Shqipërisë (2009-2019)

Lidhur me vendet e origjinës, në periudhën janar-nëntor 2018, janë ndaluar 24361 shtetas nga Siria, prej të cilëve 2037 kanë kërkuar azil, 824 shtetas nga Pakistani prej të cilëve 623 kanë kërkuar azil, 533 shtetas nga Iraku prej të cilëve 407 kanë kërkuar azil, e më tej nga Algjeria, Libia, Maroku, Afganistani, Jemeni dhe Irani në numra më të pakët.





Figura 3

Këto shifra tregojnë se fluksi i personave që arrijnë në Shqipëri në mënyrë të parregullt konsiston kryesisht në persona, të cilët vijnë nga vende që “prodhojnë” refugjatë dhe azilkërkues. Një grup veçanërisht vulnerabël janë të miturit e pashoqëruar. Gratë dhe fëmijët përbëjnë pakicën, por është vënë re një rritje në këtë kategori sidomos nga marsi deri në maj


2018 (shih tabelën 2). Shumica e grave dhe fëmijëve kanë qenë shtetas sirianë që kanë kërkuar azil.¹⁴

Duke analizuar shifrat për kategoritë vulnerabel të migrantëve të parregullt konkretisht gratë dhe fëmijët, si dhe kërkesat për azil të bëra nga ta, vihet re se krahasimisht me vitin 2018, shifrat vijnë në rritje në vitin 2019 (shih tabelën 2 dhe 3).



Burimi: UNHCR (Dashboard 2018)

Tabela 2 Përqindjet e mbërritjeve të grave dhe fëmijëve dhe të kërkesave të tyre për azil (2018)¹⁵



Burimi: UNHCR(Dashboard2019)


Tabela 3. Përqindjet e mbërritjeve të grave dhe fëmijëve dhe të kërkesave të tyre për azil (2019)¹⁶

¹⁴ Shiko Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani Veprimit 2019-2022, fq.9

¹⁵ <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2020/10/RELACION-AZILI.pdf>

¹⁶ <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2020/10/RELACION-AZILI.pdf>

Referuar të dhënave të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët¹⁷ të pasqyruara grafikisht më poshtë, vihet re se numri i mbërritjeve të migrantëve të parregullt shkon në përpjestim të drejtë me numrin e kërkesave për azil, ku shifrat më të larta janë ato të vitit 2019.



Burimi: UNHCR (2015-2017 statistika zyrtare nga QSH / 2018-2019 UNHCR & QSH)

Tabela 4. Numri i mbërritjeve të migrantëve të parregullt dhe i kërkesave për azil (2015-2019)

Sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme¹⁸ në shkurt të vitit 2021, rezulton se për vitin 2020 janë në total 18835 migrantë të parregullt që kanë hyrë në territorin shqiptar, prej të cilëve vetëm 2232 kanë kërkuar azil, status refugjati nuk ka përfituar asnjë, ndërsa mbrojtje plotësuese janë dhënë vetëm 4.

Në të dhënat e mësipërme vihet re një trend në rritje i flukseve migratore edhe për vitin 2020. Por tjetër trend vihet re në lidhje me kërkesat për azil, konkretisht konstatohet një ulje e ndjeshme krahasuar me vitet 2019 dhe 2018. Rënie shënohet dhe në rastet e përfitimit të statusit të refugjatit dhe mbrojtjes plotësuese. Shkak i kësaj shtate nuk është ulja e interesit të migrantëve për të kërkuar azil, por situata e krijuar nga pandemia e COVID-19. Për shkak të masave kufizuese, autoritetet përgjegjëse shqiptare kanë funksionuar me numër të reduktuar stafi, duke vështirësuar së tepërmi procesimin normal të kërkesave për azil. Gjithashtu, nuk janë përdorur metoda alternative intervistimi me migrantët që kanë kërkuar azil, sikurse janë intervistat on-line. Sipas disa raportimeve në vitin 2020, në uljen e numrit të kërkesave për azil kanë ndikuar dhe rastet e kthimeve jo-formale në kufi (push-backs).

Analiza e tendencave të ndryshueshme dhe në rritje të lëvizjeve të popullatës¹⁹ nga vendet fqinje të Shqipërisë, dikton nevojën për të forcuar kapacitetin e vendit për pritjen e një numri më të madh mbërritjesh në territorin e tij. Në këtë kontekst, mbetet thelbësore ndjekja nga afër jo vetëm e dinamikave të lëvizjeve migratore për motive të ndryshme, por edhe të shenjave paralajmëruese të hershme për rritjen e numrit të migrantëve. Azilkërkuesit e ardhur nga Greqia dhe të intervistuar në Shqipëri, konstatojnë se arsyet për lëvizjen e tyre të mëtejshme janë procedurat e zgjatura të azilit në Greqi, kushtet e papërshtatshme të pritjes në brendësi dhe në ishuj, si edhe dëshira për t'u bashkuar me anëtarët e tyre të familjes në shtetet anëtare të BE-

¹⁷ Ibid

¹⁸ https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/T%C3%AB-dh%C3%ABna-p%C3%ABr-migracionin-dhe-Azilin_2015-2020.pdf

¹⁹ nënkupton migrantët e parregullt

së. Kështu, nëse këta faktorë nuk përmirësohen, sidomos kushtet e pritjes dhe procedurat e azilit, refugjatët dhe migrantët gjithnjë e më shumë do të kërkojnë mundësi të tjera alternative. Mundësitë janë kalimi në mënyrë të parregullt i kufijve tokësorë në Maqedoninë e Veriut dhe në Shqipëri, ose përpjekja me rrugë alternative detare.²⁰

Përsa i përket migrantëve të huaj të parregullt të kapur në vend, gjatë periudhës Shtator 2017-2021 numri mesatar i migrantëve të huaj të parregullt të kapur është 1,417 shtetas. Niveli më i lartë është evidentuar në Shtator të vitit 2020 me 3,103 të tillë, ndërsa niveli më i ulët ka qënë në muajin Shtator 2017 me 211 migrantë të huaj të parregullt të kapur në vend.




Figura 4

Duke iu referuar të dhënave kumulative, për nëntë muajt e vitit 2021 janë kapur 12,704 migrantë të parregullt. Në vitin 2020 janë kapur 14,215 migrantë të parregullt. Pra, në vitin 2021 janë kapur 1511 më pak migrantë ose 11.9% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.²¹

²⁰ Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani Veprimit 2019-2022, fq.19: https://www.mb.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Migracionin-dhe-Plani-i-Veprimit_2019-2022.pdf.

²¹ Raporti mujor te MB, fq 93: <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2021/11/BULETINI-SHTATOR-2021.pdf>

MIGRANTË TË PARREGULLT TË KAPUR NË SHQIPËRI

PËR JANAR-SHTATOR 2021 JANË KAPUR
12,704 MIGRANTË

*11.9% më pak krahasuar me të njëjtën
periudhë në vitin 2020*



NË VITIN 2020 JANË KAPUR 14,215 MIGRANTË

*1,511 më shumë migrantë të parregullt
se në vitin 2021*



Figura 5

Referuar kthimeve vullnetare, gjatë periudhës pesëvjeçare Shtator 2017-2021, trendi i kthimeve vullnetare ka qenë i luhatshëm duke shënuar nivelin më të lartë të kthimeve (vullnetare, azilkërkues të refuzuar, forcërisht) në muajin Shtator 2021 me 724 persona. Niveli më i ulët është shënuar në Shtator 2019 me 214 persona. Në muajin Shtator 2021 u shënuan 35 kthime (vullnetare, azilkërkues të refuzuar, forcërisht) më shumë e krahasuar me muajin Shtator 2020 ku u regjistruan 689 raste.

Duke iu referuar të dhënave kumulative për nëntë muajt e parë të vitit 2021 vihet re një rritje me 7.7% kthime krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.²² Në vitin 2020, kthimet vullnetare janë rritur 221% krahasuar me vitin 2019. Ndërkohë që në tërësi, kthimet vullnetare në vitin 2021 janë rritur 228.7% krahasuar me vitin 2019.

²² Ibid, fq.94.




Figura 6

4.2 Parandalimi i migracionit të parregullt dhe lufta ndaj kontrabandimit të migrantëve

Nga përshkrimi i mësipërm i situatës migratore rezulton qartë se Shqipëria, sidomos në pesë vitet e fundit, po përballet me një fluks migrantësh të parregullt gjithnjë e në rritje, kryesisht të ardhur nga vendet në konflikt të Lindjes së Mesme dhe nga disa vende të Afrikës Veriore, duke bërë që Shqipëria në të shumtën e rasteve të shfrytëzohet prej tyre si rrugë tranziti drejt vendeve të BE-së. Kështu, Shqipëria konsiderohet tashmë si një ndër pikat hyrëse kryesore në Ballkanin Perëndimor të migrantëve të parregullt. Kjo situatë ka bërë që dhe fenomeni i kontrabandimit të migrantëve të vijë në rritje, e po ashtu dhe lufta e agjencive ligjzbatuese shqiptare për të parandaluar dhe goditur këtë fenomen. Kontrabandimi i migrantëve të parregullt vazhdon të jetë një fenomen shqetësues për strukturat e hetimit të krimit, si një vepër penale e parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal “Ndihma për kalim të parregullt të kufijve”. Në luftën kundër këtij fenomeni bashkëpunohet ngushtë, duke ndarë çdo ditë informacion me strukturat e Interpol/Europol, Oficerët Ndërlidhës e Frontex.

Në një Raport të fundit të publikuar në Maj të vitit 2021 të Iniciativës Globale kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, ku është bërë një analizë e situatës së kontrabandimit të migrantëve të parregullt në Ballkanin Perëndimor, lidhur me Shqipërinë raportohet se:

Numri i migrantëve të parregullt të huaj në Shqipëri nga 1,981 në vitin 2013 është rritur në 11,971 në vitin 2020.




Figura 7

Rritja ka qenë veçanërisht dramatike që nga viti 2018, kur u bë më e vështirë për azilkërkuesit dhe migrantët të kalonin nga Greqia në Maqedoninë e Veriut, duke i shtyrë ata më në perëndim drejt Shqipërisë. Pikat më të njohura të hyrjes në Shqipëri për azilkërkuesit dhe migrantët janë Kakavia në Gjirokastrë dhe Kapshtica në Korçë. Pas mbërritjes në vend, ata priren të shkojnë drejt kryeqytetit, Tiranës (ku ka një qendër pritëse në Babrru), dhe më pas në veri nëpërmjet Shkodrës për në Hanin e Hotit/Bozhaj duke kaluar në Mal të Zi ose në Morinë në kufirin me Kosovën. Një alternativë më e shtrenjtë është udhëtimi në Durrës ose Vlorë dhe përpjekja për të arritur në Itali me anije.²³ Sipas të dhënave nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit, vitet 2018 dhe 2019 kanë shënuar një trend rritjeje me hapa të shpejtë, gjë që tregon se Shqipëria vijon të jetë vend tërheqës për kalimin tranzit nga Greqia drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Numrin më të lartë e zënë ata nga Siria, të ndjekur nga ata që vijnë nga Afganistani, Pakistani, Iraku, Palestina dhe Maroku.

Shumica e migrantëve dhe azilkërkuesve hyjnë në Ballkanin Perëndimor nga Greqia ose rreth Gjevgjeli në Maqedoninë e Veriut ose afër Kakavijës dhe Kapshticës në Shqipëri. Një vlerësim konservativ i tregut për kontrabandën e migrantëve në kufirin jugor të Ballkanit Perëndimor varion nga 11,8 në 17,7 milionë euro në kufirin midis Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut dhe 7,5 deri në 11,5 milionë euro midis Greqisë dhe Shqipërisë. Në total, në vitin 2020 biznesi i kontrabandës së migrantëve në pikat kryesore të hyrjes në Ballkanin Perëndimor në kufijtë midis Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë fqinje mund të vlerësohet të jetë në intervalin nga 19,5 deri në 29 milionë euro.²⁴

²³ Raport i Global Initiative Against Transnational Organized Crime t “Sp33ot prices-Analyzing flows of people, drugs and money in the Western Balkans”, fq.8: <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/05/Spot-Prices-Analyzing-flows-of-people-drugs-and-money-in-the-Western-Balkans-1.pdf>

²⁴ Ibid, fq.20

Sa i përket rreziqeve të kontrabandimit përgjatë Ballkanit Perëndimor, konstatohen dhe përshkruhen disa prej tyre si: shfrytëzimi i migrantëve, kapja dhe keqtrajtimi nga policia kufitare duke marrë sendet dhe paratë e tyre, vjedhjet me dhunë dhe përleshjet ndërmjet migrantëve (kryesisht brenda kampeve ku jetojnë), si dhe humbja e jetës për shkak të aksidenteve gjatë udhëtimit.

Gratë, veçanërisht ato që udhëtojnë vetëm, janë të cënueshme ndaj përdhunimit ose të detyruara të shpërblejnë për udhëtimin e tyre kundrejt favoreve seksuale. Në vendet ku migrantët ndalohen gjatë udhëtimit të tyre, raportohet gjithmonë e më shumë për migrantë të dëshpëruar që janë të pambrojtur ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, duke përfshirë lypjen, krimin e rrugës, punën e detyruar dhe shfrytëzimin seksual.²⁵

Sipas raportit më të fundit të Europol-it, përgjatë rrugës së Ballkanit Perëndimor, pavarësisht pandemisë Covid-19 që preku Evropën gjatë 2020-ës, janë vëzhguar grupe më të mëdha migrantësh të parregullt, ndërsa u shfaqën rrugë të reja të mundshme, si korridori detar nga Shqipëria në Itali.²⁶

Krimet e kontrabandës së migrantëve kryhen nga grupe kriminale ose nga organizata kriminale ndërkombëtare që punojnë në rrugët e trafikimit, shpesh duke rrezikuar jetën e migrantëve gjatë gjithë udhëtimit në tokë, ajër ose det. Për të ndërprerë dhe ndjekur me sukses rrugët e ndërlikuara të kontrabandës ndërkombëtare, është e rëndësishme që të përfshihen si gjyqësori, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe autoritetet e kontrollit kufitar nga të gjitha vendet përgjatë rrugës së kontrabandës apo trafikimit të migrantëve, nga vendet e origjinës jashtë BE-së, vendet e tranzitit dhe destinacionit në Evropë. Këto autoritete duhet të ndajnë informacione, të fillojnë hetime në të gjitha vendet ku veprojnë qelizat (bazat) e grupeve të organizuara kriminale, të hartojnë një strategji të koordinuar hetimore, të marrin prova të pranueshme dhe të sigurojnë një sekuestrim dhe konfiskim efektiv të aseteve.²⁷

Grupet kriminale të kontrabandës së migrantëve angazhohen rregullisht edhe në krime të ngjashme, si pastrim parash dhe përpjekje të paligjshme për të marrë nënshtetësinë e një shteti anëtar të BE-së përmes falsifikimit të dokumenteve dhe martesave fiktive. Disa ofrojnë një "paketë shërbimi kontrabandë" që mund të përfshijë përpjekje të paligjshme për të marrë nënshtetësinë e një shteti anëtar të BE-së. Grupe të tjera kriminale i kthejnë klientët e tyre dhe i bëjnë viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore dhe rasteve të tjera të shfrytëzimit të skllavërisë moderne. Numri në rritje i incidenteve që prekin shtetet anëtare në Mesdhe, e ka bërë trajtimin e kontrabandës së emigrantëve një prioritet për Bashkimin Evropian. Natyra komplekse e rasteve e bën bashkëpunimin të domosdoshëm, gjatë gjithë udhëtimit tokësor, ajror ose detar, pasi grupe të ndryshme të krimit të organizuar mund të përfshihen në transportimin e individëve nga vendi i tyre i origjinës në destinacionin e synuar. Përfshirja e autoriteteve nga të gjitha vendet e interesuara është thelbësore për të lidhur pikat nga secila qelizë (bazë) në shtigjet e kontrabandimit apo trafikimit të migrantëve, duke përfshirë vendet e origjinës dhe tranzitit jashtë Evropës. Natyra e fragmentuar, ndërkombëtare dhe komplekse

²⁵ Ibid, fq.18

²⁶ [How COVID-19-related crime infected Europe during 2020 | Europol \(europa.eu\)](#)

²⁷ [Migrant smuggling | Eurojust | European Union Agency for Criminal Justice Cooperation \(europa.eu\)](#)

e këtyre aktiviteteve paraqet pengesa të dukshme për hetuesit dhe autoritet e tjera të sistemit të drejtësisë²⁸.

Një analizë nga Eurojust tregoi se gati 75% e rasteve përfshijnë më shumë se dy Shtete Anëtare, duke shkaktuar lehtësisht hetime paralele që mbartin një rrezik të lartë të konflikteve të juridiksionit. Autoritetet kombëtare gjithashtu përballen me sfida të veçanta në sigurimin e provave të pranueshme, veçanërisht në det të hapur²⁹. Aktivitete kriminale të një natyre hibride (e drejta penale dhe civile të përfshira bashkë) mund të gjenerojnë sfida specifike juridiksionale dhe legjislative, si për shembull akti i lidhjes së një martese fiktive konsiderohet krim në disa shtete anëtare, por jo në të tjera.

Lidhur me ndalimet e migrantëve të parregullt në kufirin dhe territorin shqiptar, në Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2019-2022, citohet se nga Janari deri në Prill 2018, 74% e ndalimeve për herë të parë (në vijim ndalime) janë raportuar në kufirin jugor, më saktësisht në pikën kufitare të Kakavijës. Përveç kësaj, 305 persona janë kapur duke dalë nga vendi (në drejtim të Malit të Zi, në zonën e Shkodrës) në periudhën tre mujore nga Marsi deri në Maj 2018. Kjo mund të lidhet me krijimin e një rruge të re për kontrabandimin e qenieve njerëzore nga Greqia nëpërmjet Shqipërisë, Malit të Zi dhe Bosnje Hercegovinës, në Kroaci dhe në Evropën Perëndimore. Pavarësisht skenarëve të lartpërmendur, aktorët e përfshirë në ofrimin e ndihmës, shërbimeve dhe mbrojtjes, do të duhet të rivlerësojnë nevojat, prioritetet dhe procedurat ekzistuese.

Është e nevojshme të vazhdohet sigurimi i efektivitetit të kontrolleve në pikat e kalimit kufitar të autorizuara, kontrolli përgjatë kufirit të gjelbër, si edhe të përditësohet periodikisht profili i refugjatëve dhe i migrantëve që vijnë në Shqipëri, veçanërisht arsyet për të cilat ata synojnë të kalojnë përmes Shqipërisë. Për më tepër, rekomandohet rritja e alternativave për migracion të rregullt dhe rritja e bashkëpunimit dhe e partneriteteve ndërkombëtare për migrim të sigurt e të rregullt, për të adresuar kështu shkaqet e migracionit të parregullt.³⁰

Lidhur me **masat për parandalimin e migracionit të parregullt gjatë periudhës 2018-2021**, institucionet shtetërore përgjegjëse për migracionin, duke u bazuar në sfidat e adresuara në Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2019-2022 dhe masat e parashikuara në planin e saj të veprimit, si dhe Strategjisë Ndërsektoriale për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2021-2027, kanë ndërmarrë hapa konkretë në drejtim të:

- Rritjes së alternativave për migracion të rregullt nga të huajt drejt Shqipërisë;
- Forcimit të kontrollit kufitar;
- Rritjes së veprimtarisë parandaluese dhe goditëse të agjencive ligjzbatuese;
- Forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar e rajonal.

Në drejtim të rritjes së alternativave për migracion të rregullt nga të huajt drejt Shqipërisë si dhe lehtësimit të procedurave ligjore që lidhen me migracionin e rregullt, me rëndësi të vecantë është hartimi dhe miratimi i ndryshimeve në ligjin për të huajt në fillim të vitit 2020.

²⁸ ibid

²⁹ ibid

³⁰ Shiko Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani Veprimit 2019-2022, fq.19: https://www.mb.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Migracionin-dhe-Plani-i-Veprimit_2019-2022.pdf

Ndryshimet dhe shtesat në Ligjin nr.108/2013, “Për të huajt”, i ndryshuar, shtrihen në tri fusha kryesore, të cilat rregullojnë konkretisht:

- **Politikën e vizave** me qëllim krijimin e mekanizmave të nevojshëm për lëshimin e vizave elektronike on-line;
- **Politikën e qëndrimit** në Republikën e Shqipërisë me qëllim shkurtimin e afateve për shqyrtimin dhe lëshimin e lejes së qëndrimit;
- **Politikën e punësimit të të huajve** me qëllim përmirësimin e disa dispozitave të lidhura me lejen e punës dhe punësimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë, duke qartësuar afatet kohore dhe procedurat për t’u pajisur me leje pune dhe duke reduktuar pengesat e panevojshme për punësimin e shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto ndryshime pritet të kenë efekt direkt në rritjen e numrit të shtetasve të huaj që e shohin Shqipërinë si një mundësi për punësim e për të qëndruar në territorin e saj.

Lehtësira akoma më të mëdha në politikën e qëndrimit dhe punësimit të të huajve u sanksionuan më pas në Ligjin e ri “Për të huajt” nr.79/2021, i cili përafrohet më shumë legjislacionin tonë me *acquis* të BE-së. Ky ligj ka si qëllim përmirësimin e mekanizmave të nevojshëm për lëshimin e vizave elektronike online, duke synuar zgjidhjen e problematikave të ndeshura gjatë zbatimit të legjislacionit ekzistues, lidhur me pamundësinë për të mbuluar shumë vende me misione diplomatike apo poste konsullore.

Nëpërmjet dispozitave të tij, ky ligj rregullon pajisjen me leje unike, e cila garanton një procedurë të vetme aplikimi për të huajt, që kanë për qëllim të punojnë dhe qëndrojnë në territorin e Shqipërisë. Gjithashtu, ai synon përmirësimin e dispozitave të lidhura me çështjen e punësimit të shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë, duke qartësuar afatet kohore dhe procedurat për t’u pajisur me leje unike, si dhe duke reduktuar pengesat e panevojshme për punësimin e të huajve në territorin e Republikës së Shqipërisë. Risi është dhe përcaktimi i procedurës për t’u pajisur me leje qëndrimi edhe kategoritë e të huajve të cilët kanë hasur vështirësi në të kaluarën, si pensionistët e huaj apo personat pa shtetësi, të cilët kanë qenë tërësisht të pambuluar nga legjislacioni ekzistues.

Në drejtim të luftës kundër migracionit të paligjshëm drejt Shqipërisë dhe kontrabandës e trafikimit të migrantëve të parregullt, gjatë periudhës 2018-2021 është intensifikuar veprimtaria parandaluese e goditëse e agjencive ligjzbatuese shqiptare. Forcimi i kontrollit kufitar është përmirësuar nëpërmjet rritjes në vitet e fundit së kapaciteteve në burime njerëzore dhe logjistike, kjo e reflektuar dhe në shifrat në rritje të detektimit të migrantëve të parregullt në kufi (atë të gjelbër dhe tokësor), por edhe brenda në territor. Po kështu dhe veprimtaria goditëse ndaj fenomenit të kontrabandimit të migrantëve të parregullt nga agjencitë ligjzbatuese ka ardhur në rritje vitet e fundit.

Të dhënat për kontrabandën e migrantëve dhe numrin e autorëve për tre vitet e fundit në periudhën Mars-Shtator tregojnë përpjekjet e Policisë së Shtetit, konkretisht të Departamentit të Kufirit dhe Migracionit dhe të Policisë Kriminale në luftën kundër këtij fenomeni³¹.

Viti (periudha mars-shtator)	2018	2019	2020
Numri i veprave penale për kontrabandimin e migrantëve	66	74	67
Numri i autorëve	153	118	160

Burimi: Departamenti i Policisë Kriminale

Tabela 5: Veprat penale për kontrabandën e migrantëve dhe numri i autorëve në tre vitet e fundit (mars-shtator)³²

Për vitin të gjithë vitin 2020 shifra ka shkuar në 304 vepra penale, nga të cilat janë zbuluar 293 vepra me 572 autorë. Gjatë vitit 2020 rritja e numrit të operacioneve është realizuar në masën 4.6 herë më shumë ose +460%, pasi në vitin 2019, janë kryer 23 operacione policore, ndërsa gjatë vitit 2020 janë kryer 106, operacione policore për këtë vepër penale.

Gjatë 5 mujorit të parë të 2021 janë hetuar 75 vepra penale, me 123 autorë.

Është e rëndësishme të theksohet se, pavarësisht përpjekjeve të agjencive ligjzbatuese për goditjen e aktivitetit kriminal të kontrabandimit të migrantëve, shifrat kanë qenë të larta edhe pse gjatë vitit 2020 lëvizjet kanë qenë të kufizuara për shkak të pandemisë COVID-19. Ky fenomen që ka prekur dhe vende të tjera në Evropë është analizuar hollësisht në raportet e EUROPOL³³, ku konstatohet në përgjithësi se rrjetet kriminale të përfshira në kontrabandën e migrantëve karakterizohen nga reagimi i shpejtë ndaj ndryshimeve në mjedisin e tyre. Rrugët dhe *modus operandi* të përdorura nga kontrabandistët për të lehtësuar migrantët drejt dhe brenda BE ndryshojnë në varësi të rrethanave, të tilla si kushtet e motit, disponueshmëria e logjistikës së transportit, dhe prania e rreziqeve si psh. rritja e aktivitetit të zbatimit të ligjit ose kufizimet e udhëtimit. Pandemia e COVID-19 ka treguar se krizat globale afatgjatë nuk pengojnë ndjeshëm flukset e migracionit dhe nuk e zvogëlojnë kërkesën për shërbime të kontrabandës për të hyrë, tranzituar ose banuar në BE. Pas bllokimit të parë në Mars dhe Prill

³¹ Analysing the influence of COVID-19 on migration in the MARRI Participants, fq.30: http://marri-rc.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/FINAL-REPORT_Analysing-the-influence-of-COVID-19-on-migration-in-the-MARRI-Participants-1.pdf

³² Ibid

³³ Raportin e Europol, European Union Serious and Organised Crime Threat Assessment (EU SOCTA) 2021: <https://www.europol.europa.eu/socta-report> dhe Raportin e Europol 2020, How COVID-19-related crime infected Europe during 2020 [Report, 12 November 2020]: <https://www.europol.europa.eu/publications-documents/how-covid-19-related-crime-infected-europe-during-2020>

2020, kontrabandimi i migrantëve rifilloi shpejt. Për të kompensuar humbjet e mundshme ekonomike, rrjetet e kontrabandës u detyruan të kërkonin alternativa në rrugë, mënyrën e transportit dhe madhësinë e grupeve të kontrabanduara.

Në vitin 2020 kriza e COVID-19 bëri që kërkesa për kontrabandë të sigurt (e padetektueshme nga agjencitë ligjzbatuese) në BE të rritej, përfshi këtu dhe vështirësitë në shmangien e karantinës në ambientet e pritjes. Raportet e Frontex evidentojnë se si rezultat kontrabandistët kërkuan dhe arritën çmime më të larta për shërbimin e ofruar. Sipas Europol, kontrabanda e migrantëve është dhe do të mbetet një aktivitet kyç për rrjetet kriminale, si pasojë e kërkesave të vazhdueshme për shërbime lehtësi.³⁴

Krerët e rrjeteve të kontrabandës kanë aftësi të forta menaxheriale dhe janë në gjendje të orkestrojnë biznesin kriminal nga distanca, ndërsa kryesisht ekspozojnë kriminelët e nivelit të ulët të përfshirë në transport dhe logjistikë, ndaj zbulimit nga agjencitë ligjzbatuese. Shpesh me ta bashkëpunojnë edhe ekspertët në falsifikimin e dokumenteve . Rrjetet shumë të organizuara të kontrabandës kanë gjithashtu lidhje ose aftësi të brendshme për të shfrytëzuar migrantët e parregullt pasi ata kanë mbërritur në destinacionin e tyre, përmes një skllavërimi borxhi, duke theksuar lidhjen e ngushtë midis kontrabandës së emigrantëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore.³⁵

Referuar lidhjes së fenomenit të kontrabandimit të migrantëve me atë të trafikimit, në Raportin e DASH për Trafikimin e Personave 2020³⁶, vihet re një nga rekomandimet kryesore të tij, i cili thekson nevojën për finalizimin dhe zbatimin e procedurave të standardizuara për identifikimin dhe kontrollin e viktimave, të cilat duhet të përdoren nga zyrtarët e kufirit dhe të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit kur bien në kontakt me grupe vulnerabël, si migrantët e huaj pa dokumente, azilkërkuarit, e refugjatët³⁷.

Në Raportin e vitit 2021³⁸ u konstatua se vijonin raportimet se policisë kufitare i mungonin burimet, përkthyesit dhe njohuritë për të kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme ose për të zbatuar PSV-të për migrantët e parregullt dhe azilkërkuarit. Ndryshe nga vitet e mëparshme, nuk kishte raportime që qeveria i penalizonte viktimat për krime që trafikantët e tyre i detyronin të kryenin. Megjithatë, për shkak të mungesës së procedurave formale të identifikimit, qeveria mund të ketë ndaluar ose dëbuar migrantë të parregullt dhe azilkërkuarit. Qeveria nuk ka bërë përpjekje për të rregulluar ose dënuar rekrutuesit e punës për praktika të paligjshme që rritën vulnerabilitetin e migrantëve ndaj shfrytëzimit jashtë vendit.

Gjithashtu, raportet e GRETA-s për Shqipërinë trajtojnë çështje të vulnerabilitetit të migrantëve të parregullt për të qenë viktimat e mundshme trafikimi apo viktimat trafikimi. Sipas raportit të fundit të vlerësimit të vitit 2020 rezulton se shumica e migrantëve që mbërrijnë në Shqipëri e kanë të përcaktuar destinacionin e tyre, normalisht një vend të Evropës Perëndimore

³⁴https://migration.gov.gr/wp-content/uploads/2021/07/Risk_Analysis_2021.pdf, fq.18 e Raportit të analizës së riskut të Frontex, publikuar në 2021.

³⁵ https://migration.gov.gr/wp-content/uploads/2021/07/Risk_Analysis_2021.pdf, fq.19 e Raportit të analizës së riskut të Frontex, publikuar në 2021

³⁶ 2020 Trafficking in Persons Report_Department of State, fq.68: <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2020/06/2020-TIP-Report-Complete-062420-FINAL.pdf>

³⁷ Ibid, fq.69

³⁸ <https://www.state.gov/reports/2021-trafficking-in-persons-report/albania/>

dhe thajse 99% e azilkërkuesve, *de facto* braktisin procedurën e azilkërkimit brenda pak ditësh, duke u larguar dhe nga qendra e pritjes. Ky fenomen vërtetohet dhe nga interpretimi i të dhënave statistikore për periudhën kohore nga 1 Janari 2018 deri në mes të Gushtit 2019, ku 7,613 persona në kohën e procedurës paraprake të kontrollit në kufi treguan synimin për të kërkuar azil por realisht vetëm 87 prej tyre paraqitën zyrtarisht një kërkesë për azil pranë autoritetit përgjegjës.³⁹

Ka raportime dhe për rastet e kthimit të personave të identifikuar në kufirin me Greqinë pa zbatuar procedurën e *pre-screening*, si dhe mungesën e zbatimit nga Greqia të Marrëveshjes së Ripranimit BE-Shqipëri, duke rritur kështu rrezikun e kthimeve të kryera në shkelje të garancive të parashikuara në këtë Marrëveshje. Kthime të tilla ndikojnë negativisht në zbulimin e viktimave të trafikimit midis azilkërkuesve dhe migrantëve dhe ngrenë shqetësime të mëdha në lidhje me respektimin e disa detyrimeve të Konventës nga Shqipëria, sikurse detyrimi për identifikimin e viktimave të trafikimit, referimin e tyre në ndihmë, etj..⁴⁰

Përsa më sipër, gjithmonë e më shumë konstatohet risku se bashkë me flukset migratore rriten dhe rastet e viktimave të trafikimit, kryesisht midis kategorive vulnerabël të migrantëve të parregullt. Në këtë kuptim, parandalimi i migracionit të parregullt ndikon në parandalimin e kontrabandimit të migrantëve dhe rrjedhimisht në parandalimin e trafikimit të qënieve njerëzore.

Sa i përket *bashkëpunimit ndërkombëtar* si një element kyç në parandalimin dhe luftën ndaj migracionit të parregullt, Shqipëria është vendi i parë, jo anëtar i BE-së, e cila ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me FRONTEX.

Frontex (Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare) trajton sfidat migratore dhe kërcënimet e mundshme në kufijtë e jashtëm të BE-së. Puna e tij lidhet me ruajtjen e sigurisë së brendshme në respektim të plotë të të drejtave themelore, duke ruajtur lëvizjen e lirë të personave brenda Bashkimit Evropian. Që nga dhjetori 2019, Frontex ka zgjeruar përfshirjen e saj në vendet e treta.⁴¹

Marrëveshja e bashkëpunimit të Shqipërisë me Frontex synon:

- rritjen e nivelit të bashkëpunimit të vendit tonë me vendet e BE-së në kuadrin e menaxhimit të kufijve dhe migracionit të paligjshëm si dhe gjatë zhvillimit të operacioneve të kthimit e ripranimit;

- pjesëmarrjen në operacione të përbashkëta dhe trajnime;

- rritjen e nivelit profesional të punonjësve të policisë së shtetit dhe përcaktimin e detyrave e të kompetencave për menaxhimin dhe zgjidhjen e situatave;

- rritjen e bashkëpunimit operacional, shkëmbimin e informacionit si dhe krijimin e mundësisë për përdorimin e aseteve teknike e logjistike edhe në kufijtë e vendit tonë, në rastet e mundshme

³⁹GRETA- Evaluation Report, Albania, fq.37, parag.157, publikuar më 15 dhjetor 2020: https://www.ecoi.net/en/file/local/2042302/GRETA_2020_09_FGR_ALB_en.docx.pdf

⁴⁰ Ibid, fq.38, Parag.163.

⁴¹ Annual Report "Fundamental Rights Officer 2020", fq.2:

https://frontex.europa.eu/assets/Key_Documents/FRO_reports/FRO_Annual_Report_2020.pdf

të flukseve të mëdha migratore, të papërballueshme me kapacitetet njerëzore dhe teknike të vendit tonë⁴².

Në 21 Maj 2019, filloi Operacioni i Përbashkët JO FOA Western Balkan në Shqipëri (Joint Operation Flexible Operation Activities Western Balkan), i pari i këtij lloji i kësaj Agjencie në një vend jo-anëtar të BE. Në zbatim të Marrëveshjes janë përfshirë 75 oficerë policie nga 13 shtete anëtare të BE-së⁴³. Në vitin 2020 numri i migrantëve të parregullt të kapur në vendin tonë u rrit me 60%, ndërsa numri i të kapurve në kuadër të operacionit u rrit më shumë se 2 herë⁴⁴.

Në vitin 2021 situata e flukseve migratore në Ballkanin Perëndimor, ku përfshihet dhe Shqipëria, ka vazhduar të jetë në shifra të larta. Sipas të dhënave të Frontex për muajin Korrik 2021 rezulton se rruga e Ballkanit Perëndimor pati 3600 zbulime në muajin Korrik, 67% më shumë se viti paraardhës. Numri i përgjithshëm i kalimeve të paligjshme kufitare në vitin 2021 u rrit me 90% dhe arriti në 22600. Shumica e migrantëve vinin nga Siria dhe Afganistani, të ndjekur nga shtetasit e Marokut.⁴⁵ Referuar të dhënave, nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit, në kuadër të Operacionit të FRONTEX, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2021, 89.8% e migrantëve të parregullt të kapur në vendin tonë, janë kapur në Korçë dhe Gjirokastër.

Në këtë situatë, me qëllim parandalimin e migracionit të parregullt dhe luftës ndaj kontrabandimit të migrantëve, Shqipëria vazhdoi bashkëpunimin me Frontex duke nënshkruar marrëveshjen e re të punës me këtë agjenci në 17 mars të 2021⁴⁶. Kjo marrëveshje vjen si një vlerë e shtuar pasi, shkëmbimi i informacionit mbi bazën e kësaj marrëveshjeje do të fokusohet në luftën kundër migracionit të parregullt, krimin ndërkufitar dhe *modus operandi* të grupeve kriminale.

Shqipëria bashkëpunon ngushtë dhe me **EUROPOL** (Zyrën e Policisë Evropiane), nëpërmjet një marrëveshjeje të ratifikuar me ligjin nr.28/2014, “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional” të ndryshuar në vitin 2018, ku objekt i bashkëpunimit është edhe pjesmarrja në operacione të përbashkëta kundër trafikeve të paligjshme. Kjo marrëveshje është amenduar edhe në vitin 2021, mbishtrirjen e bashkëpunimit në shkëmbimin e informacionit edhe me institucionet e reja të drejtësisë të ngritura në vendin tonë, sikurse është edhe Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Byroja Kombëtare e Hetimit. Kjo do të sjellë rritjen e sasisë dhe cilësisë së informacionit që do të shkëmbehet dhe do të ndihmojë në parandalimin dhe goditjen e veprimtarive të paligjshme.

⁴² Fq.2 e Raportit të Komisionit të sigurisë Kombëtare dt.29.01.2019 për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojes Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”
<http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20190204100419Raport%20Marreveshja%20Bashkepunimi%20Roja%20Bregdetare%20BE.pdf>

⁴³ <https://mb.gov.al/2021/03/17/nenshkrhet-marreveshja-mes-mb-e-frontex-ministri-cuci-shqiperia-kandidat-i-denje-per-tu-bere-pjese-e-be/>

⁴⁴ Ibid, fjala e Ministrit të brendshëm z.Cuci, 17.03.2021

⁴⁵ <https://frontex.europa.eu/media-centre/news/news-release/july-increase-in-the-central-med-and-western-balkans-IOsJpO>

⁴⁶ https://frontex.europa.eu/assets/Key_Documents/Working_Arrangements/WA_with_Albania_2021.pdf

Që prej Korrikut 2019 Shqipëria u bë vendi i parë ndër 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, në të cilin EUROPOL ka caktuar një oficer ndërlidhës me qëllim intensifikimin e shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit në operacione të përbashkëta policore.

4.3 Respektimi i të drejtave të migrantëve

Të drejtat e migrantëve të parregullt janë sanksionuar në disa dokumenta shumë të rëndësishëm ndërkombëtarë, të pranuar këto dhe nga Qeveria Shqiptare e të reflektuara në një pjesë të mirë të kuadrit ligjor e strategjik në Shqipëri.

Kështu në **Deklaratën e Nju Jorkut për Refugjatët dhe Migrantët**, Shtetet Anëtare riafirmuan se të gjithë migrantët pavarësisht nga statusi, janë zotërues të të drejtave. Shtetet Anëtare janë të përkushtuara për të përmirësuar integrimin dhe përfshirjen e të gjithë migrantëve, me vëmendje të veçantë tek aksesit për arsim, kujdes shëndetësor, drejtësi dhe aftësimi gjuhësor. Më konkretisht, Shtetet Anëtare janë të detyruara të respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin të drejtat e njeriut të të gjithë migrantëve në territorin e tyre ose nën kontrollin e tyre efektiv, duke përfshirë migrantët e parregullt.

Është e rëndësishme të theksohet se mbrojtja e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, si e drejta për shëndet, strehim ose arsim, është e lidhur ngushtë me përfshirjen sociale dhe integrimin e migrantëve. Shtetet Anëtare janë zotuar të ofrojnë identitet ligjor për të gjithë, duke përfshirë regjistrimin e lindjeve, i cili është një hap vendimtar drejt garantimit që migrantët të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të kenë akses në shërbimet bazë.⁴⁷

Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, përfshin gjithashtu një angazhim për të siguruar respektimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe trajtimin njerëzor të migrantëve pavarësisht nga statusi i migracionit”, duke përfshirë, ndër të tjera:

Mbrojtja sociale; Qasja në shërbimet bazë; Shëndeti; Arsimi; Puna e denjë dhe Aksesit në drejtësi. Shqipëria është një nga vendet që ka vendosur Agjendën 2030 të Kombeve të Bashkuara si pjesë e prioritetëve të veta kombëtare dhe, gjithashtu, ka mirëpritur Marrëveshjen Globale mbi Migracionin dhe objektivat e saj.

Po kështu sipas OHCHR (Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut), rekomandohet se ndërhyrjet e mëposhtme të bazuara në të drejtat e njeriut janë kritike për të mbrojtur të drejtat e njeriut të migrantëve në situata të parregullta:⁴⁸

1. Sigurimi i aksesit jodiskriminues në të drejtat ekonomike, sociale, kulturore dhe shërbimet e tjera të ngjashme.
2. Të ndahet qartë ofrimi i shërbimeve nga zbatimi i detyrimeve lidhur me migracionin, për gëzimin e të drejtave. Kjo gjë, nënkupton faktin se migrantët duhet të jenë në gjendje të kërkojnë të drejtat e tyre, duke përfshirë raportimin e diskriminimit, dhunës, krimeve të

⁴⁷ <https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Migration/GlobalCompactMigration/IrregularMigrants.pdf>

⁴⁸ Ibid

urrejtjes dhe abuzimeve të tjera pa patur frikën e pasojave në lidhje me statusin e tyre të migracionit, si p.sh. identifikimi, arrestimi, ndalimi dhe dëbimi.

3. Përfundimi i përdorimit të paraburgimit si një mjet për menaxhimin e migracionit.

Të drejtat e të huajve në legjislacionin shqiptar, së pari janë sanksionuar nga **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**⁴⁹, ku në nenin 16 të saj, ajo parashikon se: *“Të drejtat e liritë themelore si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejné njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.”*

Gjithashtu, vendimi i Qeverisë Shqiptare që miratoi **Strategjinë e re Kombëtare për Migracionin dhe Planin e saj të Veprimit 2019-2022** hodhi një hap të rëndësishëm në realizimin e angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e migracionit.

Kur flasim për jo diskriminim dhe aksesin e migrantëve në të drejtat sociale apo të drejta të tjera bazike, ndër më kryesoret përmendim të drejtën për ushqim dhe ujë, për kujdes shëndetësor, për informim, për strehim, arsim, aksesin për të kërkuar azil, aksesin në drejtësi, dhe punësim. Respektimi i këtyre të drejtave merr akoma më shumë rëndësi kur i referohemi kategorive vulnerabël si gratë dhe fëmijët e pashoqëruar.

Përsa më sipër, do të analizojmë zbatimin e disa prej këtyre të drejtave në kontekstin shqiptar.

o E drejta për shërbime bazike

Për shkak të itinerareve të gjata dhe të vështira që përshkruajnë migrantët e parregullt, shpesh ata janë të paushqyer dhe nevojat e tyre më emergjente janë: ushqimi, uji i pijshëm trajtimi mjekësor dhe/ose veshmbathje. Në të gjitha pikat kufitare apo territorin ku ata identifikohen, tashmë është bërë praktikë që policia kufitare para se të fillojë me procesin e intervistimit, merret fillimisht me trajtimin e nevojave të tyre bazike. Në këtë proces ajo asistohet nga OJF-të dhe Organizatat Ndërkombëtare që operojnë në këtë fushë si: UNHCR, IOM, CARITAS, etj. Gjatë periudhës janar-gusht 2021 në Shqipëri, sipas UNHCR-së në kufi kanë hyrë 6453 migrantë dhe refugjatë të cilët janë ndihmuar (nga UNHCR) me 10864 racione ushqimore, 263 raste këshillimi, 395 referime mjekësore dhe 1217 artikuj jo ushqimorë⁵⁰.

o E drejta për informim

Një nga të drejtat themelore të migrantëve të parregullt është dhe e drejta për informim. Ata kanë nevojë dhe duhet të informohen në gjuhën e tyre, apo në një gjuhë tjetër që ata e njohin, mbi të drejtat e tyre në vendin ku ata po qëndrojnë si dhe mbi procedurat që do të ndiqen për ta nga autoritetet shtetërore. Këto të fundit në Shqipëri, kanë krijuar tashmë një eksperiencë të mirë në drejtimit të respektimit të kësaj të drejte nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë dhe me OJF-të apo organizatat ndërkombëtare. Kështu, në qendrat e përkohshme të pritjes në kufi migrantëve të parregullt u vihen në dispozicion fletëpalosje në disa gjuhë të ndryshme, me qëllim njohjen e të drejtave të tyre. Po kështu, merren masa për sigurimin e përkthyesve në

⁴⁹ <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>

⁵⁰2021 Joint Work Plans – Mid- year Review of Programme of Cooperation for Sustainable Development (Government of Albania and UN), fq.28.

gjuhën e tyre, me qëllim që gjatë intervistimit ata të mund të kuptojnë të gjitha pyetjet dhe të mundësohet zhvillimi i një procesi korrekt përzgjedhjeje.

Megjithë përpjekjet e deritanishme të autoriteteve shtetërore, ende ekziston nevoja e rritjes së kapaciteteve të tyre me përkthyes të gjuhëve të huaja, kryesisht ato të vendeve të Lindjes së Mesme, me qëllim procesimin në kohë të intervistave me migrantët e parregullt dhe identifikimin në kohë të nevojave të tyre.

Aktualisht nevojat për përkthim gjatë intervistave apo procesit të përzgjedhjes mbulohen kryesisht nëpërmjet asistencës së UNHCR-së. Nuk mund të thuhet sa efektive ka qenë asistenca e MARRI-it me përkthyes, nga krijimi në vitet e fundit të një “pool of translators”, nga e cila do të përfitonte dhe Shqipëria si vend pjesmarrës në këtë organizatë rajonale, pasi nuk ka raportime zyrtare për këtë.

o **E drejta për strehim**

Flukset migratore drejt Shqipërisë kanë ardhur vetëm në rritje vitet e fundit, ç’ka ka bërë të domosdoshme rritjen e kapaciteteve akomoduese për migrantët e parregullt dhe azilkërkuesit. Kapacitetet pritëse të Shqipërisë mbeten të kufizuara dhe konsistojnë në një Qendër Kombëtare pritjeje për Azilkërkuesit në Tiranë, një qendër të mbyllur për migrantët në Karreç dhe tre qendra të përkohshme pritjeje. Në Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2019-2022, konstatohet se kapaciteti i përgjithshëm pritës në vend është 400 shtretër dhe deri tani ka qenë i mjaftueshëm duke pasur parasysh natyrën e përkohshme të lëvizjes, por do të ishte i pamjaftueshëm nëse rritet numri i personave që qëndrojnë në vend. Është konstatuar gjithashtu mungesa e strehëzave të specializuara për gratë dhe fëmijët në rrezik, ndërkohë që referimet në qendrat rezidenciale të kujdesit të menaxhuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale kanë rezultuar të vështira për shtetasit e huaj.

Ndërkohë, në Raportin e Komisionit Evropian publikuar në Tetor të vitit 2020⁵¹ është konstatuar gjithashtu se kapaciteti i pritjes së migrantëve u rrit në vitin 2019 dhe 2020 dhe se Qendra Kombëtare e Azilkërkuesve në Tiranë, që mund të presë 240 persona, u plotësua me kapacitet në disa raste në fund të 2019 dhe fillim të 2020, por theksohet se ka nevojë për mirëmbajtje dhe kushte të duhura jetese dhe se situata e përkeqësuar e sigurisë brenda qendrës ka mbetur e pa adresuar. Një tjetër ambjent akomodimi për migrantët e parregullt ku referon ky raport është dhe Qendra e mbyllur e pritjes për migrantët e parregullt në Karreç me një kapacitet total prej 100 shtretërisht, ku theksohet se ka nevojë për rinovim..

UNHCR dhe IOM kanë advokuar në vazhdimësi për një sistem të përmirësuar për pritjen e aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare (dhe migrantëve), duke përfshirë këtu reagimin ndaj personave me nevoja të veçanta pritjeje (p.sh., fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë)⁵².

Mund të thuhet se një hap i rëndësishëm i ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare në drejtim të përmirësimit të kësaj situatë janë ndryshimet e fundit ligjore në ligjin 79/2021 “Për të huajt”, i cili parashikon dhe garanton një standart më të lartë të respektimit të të drejtave të migrantëve

⁵¹ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf, fq 46 e raportit

⁵² 2021 Joint Work Plans – Mid- year Review of Programme of Cooperation for Sustainable Development (Government of Albania and UN), fq.29.

të parregullt në ambientet e akomodimit të tyre, kryesisht me fokus target grupet vulnerabël si fëmijët dhe gratë.

Pavarësisht nevojave të identifikuar më sipër në trajtimin e migrantëve të parregullt, duhet theksuar se një gamë e madhe të drejtash, përfshi këtu dhe të drejtën për strehim, u garantohen kategorive specifike të migrantëve, kryesisht atyre me status të rregullt, si: azilkërkues, refugjatë, punëtorë migrantë. Për shembull me miratimin e **Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”**, përfitojnë nga programet e strehimit social shtetas të huaj, *me qëndrim të rregullt në Shqipëri* dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin si “punëtor migrant” dhe/ose “azilkërkues”, si dhe migrantët e rikthyer.⁵³

o E drejta për kujdes shëndetësor

Në Shqipëri, ligji për shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor, i hartuar sipas skemës së mbulimit universal, garanton marrjen e këtij shërbimi falas për gjithë qytetarët shqiptarë përfshi këtu dhe ata të huaj, duke krijuar kështu lehtësira për akses në të dhe për migrantët e parregullt. Edhe sa i përket shërbimeve të urgjencës mjekësore spitalore, nga këto mund të përfitojnë jo vetëm të huajt me leje qëndrimi të rregullt, por dhe migrantët pavarësisht statusit që kanë.

Gjithsesi, konstatohet se drejtoritë rajonale të kufirit dhe migracionit (DKM-të), shërbimet sociale dhe OJF-të që merren me të huajt koordinojnë veprimet rast pas rasti, por bashkëpunimi i tyre nuk është i formalizuar. Përveç kësaj, mungojnë planet e emergjencës për menaxhimin e situatës emergjente në lidhje me refugjatët dhe migrantët.⁵⁴

Ka një mungesë të koordinimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për ofrimin e shërbimeve për migrantët dhe refugjatët në kufi, që duhet të adresohet nëpërmjet një Urdhri të përbashkët ministror për ngritjen e një sistemi të përmirësuar Pre-screening (projekt në pritje të miratimit).⁵⁵

o E drejta për azil

Në Republikën e Shqipërisë e drejta për azil është e garantuar në **Ligjin nr.10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”**. Legjislacioni në fuqi është i përafuar me standardet evropiane, duke respektuar procedurat në përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare. Republika e Shqipërisë aderon në Konventën “Për statusin e refugjatëve”, nënshkruar në Gjenevë, më 28.7.1951, dhe në Protokollin “Për statusin e refugjatëve”, nënshkruar në Nju Jork, më 31.1.1967, duke krijuar një sistem efektiv të azilit, të të drejtave dhe të detyrimeve për azilkërkuesit, refugjatët, personat në mbrojtje dhe autoritetet përgjegjëse.

Gjithashtu, neni 80, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në këtë fushë do të përqendrohet në zbatimin e legjislacionit të brendshëm për përmbushjen e standardeve të Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe të Protokollit të Nju Jorkut të vitit 1967, për të siguruar, në këtë mënyrë, respektimin e parimit të moskthimit (*non-refoulement*) të individit në atë vend që përbën kërcënim për jetën e tij, si dhe të të drejtave të tjera të azilkërkuesve dhe të refugjatëve.

⁵³ Profili i Zgjeruar Kombëtar i Migracionit për vitet 2015–2018, fq.21: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/03/12/222>

⁵⁴ Strategjinë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e saj të Veprimit 2019-2022: <https://www.mb.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Migracionin-dhe-Plani-i-Veprimit-2019-2022.pdf>

⁵⁵ 2021 Joint Work Plans – Mid- year Review of Programme of Cooperation for Sustainable Development (Government of Albania and UN), fq.29.

Nga statistikat e analizuara në fillim të këtij raporti studimor, vihet re se numri i azilkërkuesve nga viti 2017 deri në vitin 2019 ka pësuar të njëjtin trend rritjeje si ai i numrit të migrantëve të parregullt, ku pothuajse gjysma e tyre kanë paraqitur një kërkesë për azil pranë autoriteteve shqiptare. Por, vihet re një trend shqetësues që prej vitit 2020 e në vijim, ku edhe pse numri i migrantëve të parregullt të kapur në kufi apo në territor, ka ardhur në rritje, numri i kërkesave për azil ka pësuar një rënie drastike. Ky fenomen është konstatuar nga disa organizata ndërkombëtare, në raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë, sidhe ato të Departamentit Amerikan të Shtetit.

Në një vlerësim të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara për Shqipërinë, i vitit 2021 konstatohet se qasja në territor dhe procedurat e azilit për personat që kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, kanë qenë të kufizuara, duke përfshirë mungesën e shqyrtimit të vazhdueshëm për nevojat e mbrojtjes ndërkombëtare ose marrjen parasysh të nevojave specifike të mbrojtjes përpara kthimit të tyre në vendin nga i cili mbërrinin në Shqipëri.

o **E drejta për arsim**

Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar. Ky parashikim i sanksionuar në nenin 5 të **Ligjit nr.69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”**⁵⁶, i përafuar plotësisht me Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, garanton pa ekuivok të drejtën e të gjithë migrantëve, pavarësisht statusit të tyre ligjor, të drejtën për arsim fillor dhe të detyrueshëm.

Por, megjithëse në parim e kanë të drejtën e arsimit për fëmijët e tyre, migrantët e parregullt nuk janë në gjendje të hyjnë në sistemin arsimor për shkak të mospasjes së lejes së qëndrimit të tyre të rregullt⁵⁷. Ende mbetet shumë për t'u bërë në këtë drejtim nga institucionet shtetërore në bashkëpunim me OJF-të që veprojnë në këtë fushë.

o **Mbrojtja e kategorive vulnerabël**

Fëmijët—Nga situata e përshkruar në Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2019-2022 rezulton se të miturit e pashoqëruar dhe të ndarë, zakonisht referohen dhe vendosen në Qendrën Kombëtare të Pritjes në Tiranë së bashku me të rriturit me të cilët ata udhëtojnë. Në këtë strategji konstatohet gjithashtu se një Raport i Ekipit të OKB-së ka vënë në dukje se intervistat individuale të fëmijëve në kufi nuk kryhen, përveç se në ato raste kur fëmijët identifikohen menjëherë si të pashoqëruar. Intervistat me të mitur të shoqëruar raportohen të kryera në prani të familjes edhe atëherë kur marrëdhënia e tyre nuk është e vërtetuar. Një praktikë e tillë, kufizon kapacitetin e intervistës përzgjedhëse për të identifikuar si duhet të miturit e pashoqëruar që nuk e deklarojnë veten si të tillë. Mungesa e vlerësimeve gjithëpërfshirëse, mungesa e mekanizmit të menaxhimit të rasteve dhe të referimit, gjithashtu tregojnë se fëmijët

⁵⁶ Ligji69/2012 “Për arsimin parauniversitar në RSh”, shiko linkun: <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/Ligji-nr-69-21-06-2012-1.pdf>

⁵⁷ Shiko Strategjinë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e saj të Veprimit 2019-2022, fq.32, në linkun: <https://www.mb.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Migracionin-dhe-Plani-i-Veprimit-2019-2022.pdf>

nuk kanë pasur të drejtë të merrnin shërbime për të cilat mund të kenë patur nevojë, siç është mbështetja psiko-sociale.

Pas miratimit të **Ligjit Nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”**, lindi nevoja emergjente për hartimin e një akti nënligjor që të rregullonte problematikat e përmendura më sipër. Kështu më 6 mars të vitit 2019, u miratua **Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës”**⁵⁸, i cili përcakton rregullat dhe procedurat për kthimin dhe riatdhesimin e fëmijës së pashoqëruar, qofshin këta shqiptarë apo të huaj. Ky vendim përcakton detyrimin e policisë së kufirit dhe e migracionit për të dorëzuar të miturin e pashoqëruar në Njësinë Vendore për Mbrojtjen e Fëmijëve, e cila ka përgjegjësinë për të ofruar strehim dhe për të përmbushur nevojat bazë të të miturit, për të caktuar një psikolog dhe një kujdestar ligjor.

Gjithsesi, sipas një vlerësimi të agjencive të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, ligji për shërbimet e kujdesit social është ende një pengesë për aksesin e fëmijëve të pashoqëruar apo të ndarë në shërbimet e kujdesit social⁵⁹.

Gratë në rrezik—Sipas analizës së situatës për këtë kategori vulnerabël, në Strategjinë Kombëtare për Migracionin është konstatuar se mes personave në lëvizje (në flukset migratore):

- Vetëm gratë viktime të trafikimit kanë të drejtën ligjore për shërbime të kujdesit rezidencial të ofruara nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale. Është e nevojshme që shërbime të tilla duhet të kenë dhe kategori të tjera vulnerabël tek gratë migrante, azilkërkuese dhe refugjate.
- Duhet të vihen shërbime të dedikuara për gratë migrante, azilkërkuese dhe refugjate për të trajtuar siç duhet çështjen e dhunës seksuale dhe atë me bazë gjinore. Aftësia për të identifikuar viktimat e dhunës me bazë gjinore është identifikuar si një çështje urgjente, pasi për momentin kjo gjë nuk është e mundur, sepse intervistat për përzgjedhje nuk japin informacion të mjaftueshëm për identifikimin e rasteve.
- Një sfidë tjetër është aftësia e kufizuar teknike për të identifikuar të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore ose viktimat e trafikimit nga autoriteti që strehon gratë dhe vajzat që kanë aplikuar për azil në kufi. Identifikimi vështirësohet dhe nga periudha e pamjaftueshme e qëndrimit të grave dhe vajzave në qendër (7-10 ditë) për shkak të rrethanave të lëvizjes tranzitore.

Kategori të tjera vulnerabël: *Personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit* në flukset migratore mbeten një kategori vulnerabël, ku duket se mungon vëmendja e shtuar e institucioneve përgjegjëse shtetërore. Në një vlerësim të dokumentave strategjikë dhe kuadrit ligjor që lidhet me migracionin mund të themi se ende duhen bërë përpjekje për të trajtuar në mënyrë të plotë çështjet që lidhen me mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarve në flukset migratore. Ky fakt përforcohet dhe nga mungesa e të dhënave për numrin apo raportime për trajtimin e këtyre kategorive vulnerabël.

Sa i përket kategorisë së migrantëve të parregullt që hyjnë në territorin shqiptar, në Raportin e GRETA-s (raundi i tretë i vlerësimit) i publikuar në 15 dhjetor të vitit 2020, pavarësisht se

⁵⁸ <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/03/06/111>

⁵⁹ 2021 Joint Work Plans – Mid- year Review of Programme of Cooperation for Sustainable Development (Government of Albania and UN), fq.29.

konstatohet respektimi i disa të drejtave bazike, si e drejta për kujdes shëndetësor, e drejta për informim, e drejta për azil etj., theksohet se ende ka nevojë për përmirësimin e tyre, kryesisht në drejtim të shërbimeve të specializuara për kategoritë vulnerabël ku përfshihen dhe VMT(viktimat e mundshme të trafikimit) apo VT (viktimat e trafikimit) .

Autoriteteve shqiptare u kërkohet të ndërmarrin hapa të mëtijshëm për të përmirësuar identifikimin e viktimave të qenieve njerëzore, veçanërisht⁶⁰:

- ✓ *duke i kushtuar vëmendje të shtuar zbulimit të viktimave të trafikimit ndërmjet azilkërkuesve dhe migrantëve, përfshirë personat e vendosur në qendrat e paraburgimit të imigracionit. Në këtë kontekst, trajnimi për identifikimin e viktimave të trafikimit duhet t'u ofrohet oficerëve të policisë kufitare dhe migracionit, doganierëve, zyrtarëve të azilit dhe personelit të qendrave të pritjes dhe qendrave të paraburgimit të migracionit, duke përfshirë personelin mjekësor;*
- ✓ *informimi sistematik i azilkërkuesve, në një gjuhë që ata mund ta kuptojnë, për të drejtat e tyre në kuadër të procedurës së azilit, si dhe për të drejtat ligjore dhe shërbimet në dispozicion të viktimave të trafikimit;*
- ✓ *të sigurojë që përpara të gjitha largimeve të detyruara nga Shqipëria, të vlerësohen plotësisht rreziqet e trafikimit ose të ritrafikimit në kthim, në përputhje me detyrimin e moskthimit (non-refoulement).*

o **Aksesi në drejtësi**

Sa i përket aksesit në drejtësi, kur flasim për migrantët e parregullt, i referohemi kryesisht mekanizmit të ofrimit të ndihmës ligjore falas. Në **Ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”** neni 10 parashikon se, veç shtetasve shqiptarë, ndihmën juridike e përfitojnë edhe:

- 1) *shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të përkohshme ose të përhershme dhe janë të pajisur me leje qëndrimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt;*
- 2) *shtetasit e huaj, ose personat pa shtetësi, që hyjnë në mënyrë të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që përfitojnë mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë ose bazuar në parimin e reciprocitetit;*
- 3) *azilkërkuesit, personat që gëzojnë statusin e refugjatit dhe personat që janë në proces ankimi të vendimeve administrative dhe/ose gjyqësore për refuzimin e aplikimit për azil ose revokimin e vendimit të statusit të refugjatit, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.*

Në bazë të **Ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”**, ndihma juridike falas ju ofrohet shtetasve të huaj, përfshirë dhe migrantët nëpërmjet:

- Qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore (QSHNJP);
- Klinikave ligjore të ngritura pranë universiteteve publike/private;
- OJF-ve të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, DNJF (Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas)⁶¹.

⁶⁰ GRETA- Evaluation Report, Albania, fq 39, parag.166., publikuar më 15 dhjetor 2020: https://www.ecoi.net/en/file/local/2042302/GRETA_2020_09_FGR_ALB_en.docx.pdf.

⁶¹ Raporti vjetor mbi zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2019-2022, për periudhën qershor 2019-qershor 2020, fq.36 <https://mb.gov.al/plane-dhe-strategji/>

Gjithsesi, të dhënat për numrin apo rastet e migrantëve përfitues (kryesisht atyre me status të parregullt) nga ky mekanizëm mungojnë, ç'ka tregon që në këtë drejtim ka ende shumë për të bërë, pavarësisht disa rasteve sporadike në praktikë të ofrimit të këtij shërbimi nga OJF-të vendase apo organizatat ndërkombëtare.

Në kuadër të respektimit të të drejtave të migrantëve, pritet që sëshpejti të finalizohet një “Marrëveshje Bashkëpunimi me Frontex mbi mekanizmin e Ankesave për Veprimet e ndërmarra” për të siguruar shkëmbimin e informacionit lidhur me pretendimet për shkelje/dhunim të të drejtave themelore gjatë të gjitha aktiviteteve operacionale të Agjencisë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky memorandum nënshkruhet në mbështetje të Rregullores Evropiane të Rojës Bregdetare dhe Kufirit, në veçanti nenit 111 të saj, Marrëveshjes Statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian “Mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia Evropiane dhe Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”, në veçanti pika 2 e nenit 8 të saj.

KREU V

ANALIZË E KUADRIT RREGULLATOR PËR MIGRACIONIN E PARREGULLT, PARANDALIMIN E TIJ DHE RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË MIGRANTËVE.

5.1 Kuadri ligjor dhe strategjik gjatë viteve 2018 - 2021 mbi çështjet e migracionit të parregullt në Shqipëri

I gjithë kuadri ligjor dhe strategjik që lidhet me migracionin, përbën politikën migratore të Republikës së Shqipërisë. Politikat migratore synojnë:

- i. minimizimin e kostove nga migracioni i parregullt;
- ii. maksimizimin e përfitimeve nga migracioni i rregullt;
- iii. garantimin e lirive dhe të drejtave themelore të migrantëve;
- iv. luftën kundër migracionit të paligjshëm;
- v. nxitjen e kthimit vullnetar;
- vi. mbështetjen e lidhjes ndërmjet migrimit dhe zhvillimit të vendit;
- vii. menaxhimin e flukseve migratore.

Arritja e këtyre synimeve kërkon një qasje ndërsektoriale ndaj qeverisjes së migracionit. Një hap i rëndësishëm drejt arritjes së një politike gjithëpërfshirëse të qeverisjes së migracionit ishte miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), 2016–2020. Në përputhje me vizionin strategjik të SKZHI-së, “për të krijuar një sistem efektiv të qeverisjes të migracionit në Shqipëri”, Qeveria Shqiptare miratoi me VKM nr.400 datë 19.06.2019 “Strategjinë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2019-2022”.⁶²

Në hierarkinë e akteve ligjore **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë** është akti më i rëndësishëm që garanton drejtpërdrejt çështje që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e të huajve në Republikën e Shqipërisë, si: *liria e lëvizjes, mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë e me dinjtet i të huajve, ndalimi i dëbimeve kolektive të shtetasve të huaj, e drejta e proceseve të ankimeve gjyqësore* etj.

Parimet e sanksionuara në të, vijnë në harmoni të plotë me kriteret e parashikuara në **instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që trajtojnë çështje migratore**, të cilat janë ratifikuar nga vendi ynë, si:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e vitit 1948;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e vitit 1966;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile Politike e vitit 1966;
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, që hyri në fuqi më 4 janar 1969;

⁶²Profili i Zgjeruar Kombëtar i Migracionit për vitet 2015–2018, fq.44 &45: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/03/12/222>

- Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, 3 shtator 1953, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në datën 2.3.2005;
- Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjes së Tyre (ICRMË), 2007;
- Konventa në lidhje me Statusin e Refugjatit, 1992;
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës (CRC), 1992;
- Konventa e ILO-së për Migracionin për Punësim (e rishikuar), 1949 (nr. 97), 2005;
- Konventa e ILO-së për Punëtorët Migrantë (Dispozita plotësuese), 1975 (nr. 143), 2006;
- Konventat për Pashtetësinë, 2003;
- Konventa Evropiane për Statusin Ligjor të Punëtorëve Migrantë, 2007;
- Konventa Evropiane për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal, 2005.

Sa i përket **dokumentave strategjikë** që trajtojnë çështje të migracionit, ato mund t'i rendisim si më poshtë vijon:

- **Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2019-2022**⁶³, e hartuar gjatë vitit 2018 dhe e miratuar në Qershor 2019 përbën një nga dokumentet më të rëndësishëm strategjikë në fushën e migracionit ku vizioni i saj vjen në përputhje me proceset e migracionit global po aq sa edhe me procesin e integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, me qëllim ofrimin e një përgjigje gjithëpërfshirëse dhe të plotë ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit në kontekstin e Shqipërisë.

Objektivi madhor i kësaj strategjie është qeverisja e efektshme e migracionit në Shqipëri për të trajtuar sfidat që rezultojnë nga lëvizjet migratore dhe për të rritur ndikimin e migracionit tek zhvillimi në të mirë të migrantëve dhe shoqërisë shqiptare. Realizimi i këtij objekti bazohet në katër prioritete strategjike, të cilat janë:

- A. Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri;
- B. Garantimi i migracionit të sigurt dhe të rregullt nga, përmes, dhe drejt Shqipërisë;
- C. Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit tek zhvillimi socio-ekonomik kombëtar/lokal;
- D. Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integritimit të tyre.

Një sërë raportesh monitorimi për realizimin e masave dhe aktiviteteve, që lidhen me këto objektiva specifike, janë hartuar nga sekretariati teknik në Ministrinë e Brendshme, nga ku ka rezultuar se ende ka masa dhe aktivitete në proces apo të përcaktuara nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie⁶⁴.

⁶³ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/06/19/400/9c1479e4-c523-4d32-9306-71a4d6bca1db;q=Strategjia%20Komb%C3%ABtare%20p%C3%ABr%20Migracionin%20dhe%20Plani%20i%20Veprimit%202019-2022>

⁶⁴ Raportet e monitorimit <https://mb.gov.al/plane-dhe-strategji/>

- **Strategjia Ndërsektorale për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2021-2027**⁶⁵ është sigurisht ndër dokumentat më të rëndësishëm strategjik.

Si pjesë e rëndësishme e vizionit të kësaj strategjie për vitet 2021-2027 është vlerësuar: “...marrja e masave të nevojshme për të parandaluar dhe goditur të gjitha format e krimit ndërkufitar dhe të migrimit të parregullt.” Në këtë strategji të rëndësishme kombëtare përshkruhet qartë koncepti i menaxhimit të integruar të kufirit, pjesë e të cilit janë dhe çështjet që adreson ky raport studimor si: menaxhimi i flukseve migratore, siguria kufitare, respektimi i të drejtave të njeriut (edhe për kategorinë e migrantëve të parregullt), parandalimi dhe goditja e trafiqeve të paligjshme si kontrabandimi i migrantëve.

Menaxhimi i Integruar i Kufirit (MIK) synon të garantojë një qarkullim ndërkufitar në mënyrë efikase dhe adresimin e sfidave migratore, kërcënimeve të mundshme ndaj sigurisë kufitare, duke kontribuar në:

- parandalimin dhe goditjen e krimeve të rënda me dimension ndërkufitar siç janë: trafiket e paligjshme, kontrabandimi i migrantëve, trafikimi i qenieve njerëzore, terrorizmi, kontrabanda;

- garantimin e një niveli të lartë të sigurisë së brendshme duke kontribuar në këtë mënyrë në stabilitetin e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera;

- respektimin e plotë të të drejtave themelore të qytetarëve.⁶⁶

- **Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025**⁶⁷ i kushton vëmendje të veçantë parandalimit të migracionit të paligjshëm e goditjes së çdo forme trafikimi që lidhet me të.

Konkretisht në *Objektivin specifik 1.2* të saj: *Goditja e trafiqeve të paligjshme*, përmendet ulja e kërcënimit që vjen nga veprimtaritë e paligjshme në fushën e trafiqeve, duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore, ndihmën për kalim të paligjshëm të kufirit apo e njohur ndryshe si kontrabandimi i migrantëve.

Plani Kombëtar i Veprimit kundër Trafikimit të Personave 2018-2020⁶⁸ ka në fokus dhe migrantët e parregullt (kryesisht të miturit) duke i kushtuar vëmendje identifikimit sa më të hershëm të tyre si viktimat e mundshme trafikimi (VMT) apo viktimat trafikimi (VT). Kjo qasje vihet re dhe në Planin e ri Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023⁶⁹ (drafti i publikuar në regjistrin e konsultimit publik), ku parashikohet një angazhim më i madh i institucioneve të tjera shtetërore, përveç Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, renditet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, kryesisht për kategorinë e fëmijëve, përfshirë këtu dhe ata të huaj me qëndrim të parregullt. Plani i ri synon një garantim të të

⁶⁵ Strategjia Ndërsektorale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027 është miratuar me VKM nr.1117, dt.16.12.2020.

⁶⁶ Fq.5 të Strategjisë Ndërsektorale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027 dhe planit të veprimit 2021-2023, miratuar me VKM nr.1117, dt.16.12.2020 : <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/16/1117>

⁶⁷ <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2021/01/STRATEGJIA-KUND%C3%8BR-KRIMIT-T%C3%8B-ORGANIZUAR-DHE-KRIMEVE-T%C3%8B-R%C3%8BND-2021-2025-DHE-PLANI-I-VEPRIMIT-2021-2022.docx>

⁶⁸ <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/VKM-nr.-770-date-26.12.2018-Plani-Kombetar-i-Veprimit-2018-2020-1-1.pdf>

⁶⁹ <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/354>

drejtave dhe një mbrojtje më të madhe për fëmijët e huaj të pashoqëruar, duke patur në fokus qartësimin e shërbimeve sociale që duhet të marrin në bazë të statusit të tyre. Është parashikuar gjithashtu hartimi i një draft ligji të veçantë për personat të identifikuar si VT dhe VMT, në linjë me ligjin për Azilin dhe ligjin për të Huajt, për të garantuar të gjitha të drejtat që lidhen me kategorinë e migrantëve, qofshin ata të parregullt apo të kontrabanduar. Sa i përket legjislacionit, që nga viti 2018 e deri në vitin 2021 ai ka pësuar disa ndryshime thelbësore, të tilla akte janë: ligji për të huajt, ligji për azilin, ligji për kontrollin kufitar e ligji për shtetësinë. Ligji për të huajt dhe ligji për azilin, janë dy ligje të rëndësishme që u ri-hartuan në trajtën e ligjeve të reja dhe jo thjesht të shtesave apo ndryshimeve të ligjeve ekzistuese, duke synuar përafrimin sa më të madh me *acquis-n* e BE. Edhe ligji për shtetësinë u hartua si një ligj i ri, duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe duke garantuar eliminimin e pashtetësisë si një nga format e shkeljes së të drejtave të njeriut, e veçanërisht të migrantëve, si kategori vulnerabël. Ligji për kontrollin kufitar pësoi ndryshime të rëndësishme me qëllim rritjen e sigurisë kufitare dhe parandalimin e goditjen e krimit ndërkufitar, bazuar në përafrimin e mëtejshëm të tij me *acquis-n* e BE.

Nëse do të bëjmë një analizë të shkurtër të risive të kuadrit të mësipërm ligjor, konstatojmë se:

- **Ligji nr.79/2021 “Për të huajt”⁷⁰** në nenin 1 të tij parashikon se: “Ky ligj rregullon regjimin e *hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë*. Ligji përcakton funksionet dhe kompetencat e autoriteteve shtetërore dhe të subjekteve të tjera, publike e private, shqiptare ose të huaja, që në përputhje me *parimin e interesit më të mirë të fëmijës, parimin e së drejtës për jetë familjare, parimin e moskthimit, parimin e procedurave të drejta dhe transparente dhe parimin e mosdiskriminimit kryejnë* aktivitete në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë të bëjnë me të huajt që kërkojnë të hyjnë, që hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga Republika e Shqipërisë.” Risi në këtë ligj është dhe zgjerimi i rrethit të personave që përfitojnë leje qëndrimi për arsye humanitare, duke garantuar kështu një mbrojtje më të madhe të të drejtave të migrantëve të parregullt, kryesisht ata të ardhur nga zona në konflikt, të miturit e pashoqëruar, gratë shtatzëna dhe ato me fëmijë, apo dhe në raste të tjera.

⁷⁰ <http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20210705135531ligj%20nr.%2079%20dt.%2024.6.2021.pdf>

Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

-**Vendimin e Këshillit 2004/573/KE, datë 29 prill 2004** “*Mbi organizimin e fluturimeve të përbashkëta për largime nga territori i dy ose më shumë shteteve anëtare, të shtetasve të vendeve të treta që janë objekt i urdhrave individualë të largimit*”. Numri CELEX 32004D0573, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.261, datë 6.8.2004, fq.28-35.

-**Direktivën 2009/52/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 18 qershor 2009** “*Mbi parashikimin e standardeve minimale të sanksioneve dhe masave ndaj punëdhënësve të shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme*”. Numri CELEX 32009L0052, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.168, datë 30.6.2009, fq. 24-32.

-**Direktivën 2008/115/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2008** “*Mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në shtetet anëtare për kthimin e shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të parregullt*”. Numri CELEX 32008L0115, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.348, datë 24.12.2008, fq.98-107.

- **Direktivën e Këshillit 2004/82/KE, datë 29 prill 2004** “*Mbi detyrimin e transportuesve për të komunikuar të dhënat për pasagjerët*”. Numri CELEX 32004L0082, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.261, datë 6.8.2004, fq.24-27.

- **Direktivën e Këshillit 2004/81/KE, datë 29 prill 2004** “*Mbi lejet e qëndrimit të lëshuara për shtetasit e vendeve të treta që janë viktime të trafikimit të qenieve njerëzore ose që kanë qenë subjekt i një veprimi për të lehtësuar imigracionin e paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente*”. Numri CELEX 32004L0081, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.261, datë 6.8.2004, fq.19-23.

- **Direktivën e Këshillit 2003/109/KE, datë 25 nëntor 2003** në lidhje me statusin e shtetasve të vendeve të treta që janë rezidentë afatgjatë, e ndryshuar. Numri CELEX 32003L0109, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.16, datë 23.1.2004, fq.44-53.

- **Direktivën e Këshillit 2003/86/KE, datë 22 shtator 2003** “*Mbi të drejtën e bashkimit familjar*”. Numri CELEX 32003L0086, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.251, datë 3.10.2003, faqe 12-18.

-**Vendimin Kuadër të Këshillit, 2002/946/DCB, datë 28 nëntor 2002** “*Mbi forcimin e kuadrit penal për të parandaluar ndihmën e hyrjes, transitit dhe qëndrimit të paautorizuar*”. Numri CELEX 32002F0946, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.328, datë 5.12.2002, fq.1-3.

Kështu neni 52 i ligjit, i titulluar “*Leje e qëndrimit për raste humanitare*”, përcakton kriteret e përfitimit të kësaj lejeje, ku vërehet se disa kategori vulnerabël migrantësh këndë përparësi në përfitimin e saj, si:

- personat pa shtetësi;
- të miturit e braktisur apo pa mbrojtje prindërore;
- gratë shtatzëna dhe
- personat e sëmurë rëndë që nuk mund të trajtohen në vendin e kthimit.

Në pikën 3 të këtij neni, të huajt që përfiton këtë leje i garantohet e drejta për kujdes shëndetësor, ndihmë financiare, ndihmë ligjore falas, të drejtën për përkthim dhe mbështetje psikologjike, si dhe të drejtën për të punuar nëse i përfiton sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Në nenin 53 të ligjit në fjalë parashikohet *një kategori e veçantë e të huajve që përfitojnë leje qëndrimi*. Bëhet fjalë për *viktimat e trafikimit të qenieve apo viktimat e mundshme të trafikimit*, kategori kjo ku shpesh bëjnë pjesë dhe kategoritë vulnerabël të migrantëve të parregullt apo të kontrabanduar. Në nenet 54 e 55 garantohen kushtet dhe kriteret e lëshimit të lejes së qëndrimit dhe për personat pashtetësi, ku pjesë e kësaj kategorie të huajsh jo rrallëherë janë dhe migrantët e parregullt.

Ligji nr.10/2021⁷¹ “**Për azilin në Republikën e Shqipërisë**” e afron Shqipërinë me standardet ndërkombëtare dhe legjislationin e BE-së për *çështjen e rëndësishme të menaxhimit të duhur të refugjatëve dhe migrantëve* që hyjnë në territorin shqiptar. Ai *garanton që personat që kërkojnë azil të kenë qasje në procedurën e azilit, rregullon kushtet për përpunimin e kërkesave të tyre dhe ofron garanci shitesë për trajtimin e kategorive të ndjeshme* midis azilkërkuesve – siç janë *të miturit e pashoqëruar, të cilët merren në mbrojtje dhe u caktohet një kujdestar*, në momentin që shprehin qëllimin për mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë. Ligji gjithashtu përforcon kornizën për integrimin e refugjatëve. Ai po ashtu kur plotësohen kushtet përshin një *procedurë të përshpejtuar për të vlerësuar kërkesat e azilit* .

Ky ligj është mbështetur mbi parime të cilat synojnë garantimin e të drejtave të njeriut, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, ku një nga parimet kryesore është ai i moskthimit (*non-refoulement*). Mbi bazën e këtij parimi, Republika e Shqipërisë nuk duhet ta dëbojë ose ta kthejë në asnjë mënyrë kërkuesin për mbrojtje ndërkombëtare, refugjatin, personin nën mbrojtje plotësuese apo personin nën mbrojtje të përkohshme, në kufijtë e territoreve ku i kërcënohet jeta apo liria e tij për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo bindjeve të tij politike.

Risi në këtë ligj është përcaktimi në mënyrë të shprehur i *kuptimit të persekutimit (neni 12)*, *përcaktimi në mënyrë të qartë i afateve për shqyrtimin e kërkesës* nga struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët, *janë parashikuar dispozita specifike që nga momenti i pranimit dhe akomodimit të tij në qendrat e pritjes për azil, organizimi dhe funksionimi i saj, liria e lëvizjes së kërkuesve gjatë qëndrimit të tyre, si dhe rastet dhe masat që merren kur kufizohet liria e lëvizjes*. Një aspekt tjetër i rëndësishëm që trajtohet në këtë ligj është njohja e së drejtës së refugjatit dhe personit me status të mbrojtjes plotësuese për të kërkuar bashkim familjar ku për herë të parë parashikohen lehtësira në kriteret për aplikim kur

⁷¹ <http://qgz.gov.al/eli/ligj/2021/02/01/10>

kërkesa për bashkim familjar dorëzohet brenda një periudhe prej 3 (tre) muajsh pas marrjes së statusit vetëm për anëtarët e mëposhtëm të familjes:

- a) bashkëshortit të refugjatit;
- b) fëmijët e refugjatit dhe të bashkëshortit të tij, duke përfshirë fëmijët e birësuar;
- c) fëmijët, duke përfshirë fëmijët e birësuar të tij, kur refugjati ka kujdestarinë dhe fëmijët janë të varur prej tij. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të autorizojë bashkimin e fëmijëve, kujdestaria e të cilëve është e përbashkët, me kusht që pala tjetër që ndan kujdestarinë të ketë dhënë pëlqimin e saj;
- ç) fëmijët, duke përfshirë fëmijët e birësuar të bashkëshortit, kur ai ka kujdestarinë dhe fëmijët janë të varur prej tij. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të autorizojë bashkimin e fëmijëve, kujdestaria e të cilëve është e përbashkët, me kusht që pala tjetër që ndan kujdestarinë të ketë dhënë pëlqimin e saj. (shih nenin 71 pika 4)

Gjithashtu, risi në ligjin e ri për azilin është dhe parashikimi i një kreu të veçantë për trajtimin e të dhënave personale (shih kreun XIII, nenet 94-97), duke grantuar kështu përputhshmëri të lartë me standartet e parashikuara nga BE.

- Me qëllim shmangien e pashtetësisë, **Ligji nr.113/2020**⁷² “Për shtetësinë” parashikon për herë të parë se shtetësinë shqiptare me lindje e fitojnë edhe fëmijët e lindur apo të gjetur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kur janë lindur nga prindër të panjohur. Ky parashikim vjen në harmoni me Konventën Evropiane “Për shtetësinë”, të ratifikuar me ligjin nr. 8942, datë 19.9.2002 , si dhe me Konventën “Për reduktimin e pashtetësisë”, të cilën Republika e Shqipërisë ka ratifikuar me ligjin nr. 9059, datë 8.5.2003. Subjektet që mund të përfitojnë nga ky parashikim janë dhe ajo kategori vulnerabël migrantësh të parregullt si *gratë shtatzëna*, për të cilat është i pamundur verifikimi apo vërtetimi i shtetësisë, duke i dhënë mundësi fëmijëve të tyre të lindur në territorin e Republikës së Shqipërisë të mos mbeten pa shtetësi por të marrin shtetësinë shqiptare.

Në këtë ligj është parashikuar *fitimi i shtetësisë shqiptare nga refugjatët, apo personat në mbrojtje plotësuese*, duke vendosur kusht qendrimin në mënyrë të ligjshme dhe banimin në mënyrë të vazhdueshme në Republikës së Shqipërisë për një periudhë prej jo më pak se 10 vjet nga dita e komunikimit të statusit.⁷³

- **Ligji nr.22/2020 “Për disa shtesa në ligjin nr.71/2016 “Për kontrollin kufitar”**⁷⁴

Në veçanti, objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij ligji janë kryesisht, por pa u kufizuar, *përforcimi i kontrollit të kufijve, parandalimi i migracionit të paligjshëm*, rritja e parametrave të sigurisë kombëtare, por edhe asaj publike në përgjithësi, dhe në veçanti në fushën e transportit ndërkombëtar. Gjithashtu, nëpërmjet zbatimit të detyrimit për çdo transportues ajror që të transmetojë pranë autoriteteve kompetente të dhënat e “regjistrimit të

⁷² <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/07/29/113>

⁷³ <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2019/01/Relacion-per-projektligjin-Per-Shtetesine.doc>

⁷⁴ <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/03/05/22>

emrit të pasagjerit” (PNR), *synohet parandalimi, zbulimi dhe hetimi i akteve kriminale dhe identifikimi i autorëve të tyre*.⁷⁵

Sa i përket parandalimit të migracionit të parregullt, kryesisht luftës ndaj kontrabandimit të migrantëve apo trafikimit të qënieve njerëzore, një ndër aktet më të rëndësishme ligjore është Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.⁷⁶

- **Kodi Penal** bazohet në *Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në parimet e përgjithshme të së drejtës penale ndërkombëtare, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar (neni 1/a). Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin...etj.(neni 1/b).*

Neni 298 “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve” konsiderohet si një parashikim i fortë ligjor i cili ndikon në luftën kundër kontrabandimit të migrantëve. Ky nen është në përputhje me Protokollin kundër Kontrabandimit të Migrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri (ratifikuar në gusht 2002), i cili plotëson Konventën kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar të OKB-së, si dhe Direktivës së Këshillit të BE-së 2002/90/EC që përcakton lehtësimin e hyrjes, tranzitit dhe qëndrimit të paautorizuar' dhe Vendimit Kuadër i Këshillit të BE-së 2002/946/JHA 'Mbi forcimin e kuadrit penal për të parandaluar lehtësimin e hyrjes, tranzitit dhe qëndrimit të paautorizuar'.

Kjo dispozitë vjen në përputhje më shumë me kuadrin rregullator të BE-së sesa me Protokollin e OKB-së. Është pikërisht elementi i “përfitimit material” që përbën dallimin. Ky nuk është element i Direktivës dhe Vendimit Kuadër të Këshillit, ashtu sikurse dhe në dispozitën tonë penale, duke shënuar kështu një ndryshim të rëndësishëm me Protokollin kundër Kontrabandimit të Migrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri. Në legjislacionin tonë penal vërtetimi i ekzistencës së një 'përfitimi financiar ose material' shërben si një rrethanë rënduese për të caktuar një dënim më të lartë (neni 298, prg II) për personat që merren me kontrabandë migrantësh për arsye përfitimi. Shqetësimi me këtë qasje është që, në mungesë të përjashtimeve të tjera ligjore, ekziston *mundësia e kriminalizimit të aktiviteteve* të personave që ndihmojnë migrantët e parregullt ose anëtarët e familjes së tyre në procesin e migrimit pa kërkuar përfitim material ose i ndihmojnë ata për arsye humanitare (përfshirë refugjatët dhe azilkërkuesit). Është me rëndësi të përmendet fakti se lidhur me këtë shqetësim në vitin 2017, Komisioni Evropian kreu vlerësimin e parë gjithëpërfshirës mbi kuadrin rregullator të BE-së që lidhet me kontrabandimin e migrantëve e quajtur “*Facilitators Package*”⁷⁷. Vlerësimi vuri në dukje një perceptim të mungesës së sigurisë të ligjit dhe mungesën e komunikimit të duhur midis autoriteteve dhe atyre që veprojnë në terren. Komisioni Evropian propozoi një shkëmbim më efektiv të njohurive dhe praktikave të mira ndërmjet prokurorëve, agjencive të zbatimit të ligjit dhe shoqërisë civile për të adresuar këto çështje. Në korrik 2018, Parlamenti Evropian miratoi një Rezolutë mbi udhëzimet për Shtetet Anëtare për të parandaluar kriminalizimin e ndihmës

⁷⁵<https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200227102321relacion%20ligji%20%2071%20kontrolli%20kufitar.doc%20final.pdf>

⁷⁶ <https://qbz.gov.al/preview/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d>

⁷⁷ Direktiva e Këshillit 2002/90/EC e 28 Nëntorit 2002 që përcakton lehtësimin e hyrjes, tranzitit të paautorizuar dhe vendbanimin (OJ L 328/17) dhe Vendimi Kuadër i Këshillit 2002/946/JHA të 28 Nëntorit 2002 mbi forcimin e kuadrit penal për të parandaluar lehtësimin e hyrjes, tranzitit dhe qëndrimit të paautorizuar (OJ L 328/1) janë instrumente që u miratuan së bashku dhe zakonisht quhen "Facilitator's Package".

humanitare, duke i bërë thirrje Komisionit “*të miratojë udhëzime për Shtetet Anëtare që specifikojnë se cilat forma të lehtësimit nuk duhet të kriminalizohen, në mënyrë që të sigurohet qartësi dhe uniformitet në zbatimin e acquis aktuale*”. Kështu në shtator 2020 Komisioni miratoi dokumentin me “*Udhëzimet për zbatimin e rregullave të BE -së për përcaktimin dhe parandalimin e lehtësimit të hyrjes, tranzitit dhe qëndrimit të paautorizuar*”.⁷⁸ Në praktikën tonë gjyqësore penale nuk janë ngritur shqetësime lidhur me kriminalizimin e ndihmës humanitare. Në kuadër të zbatimit korrekt të Protokollit të OKB-së për Kontrabandimin e Migrantëve dhe Udhëzimeve të fundit të Komisionit Evropian që lidhen me “*Facilitator’s Package*”, sugjerohet që neni 298 i Kodit Penal të rishikohet në këtë frymë. Në disa raste vepra penale e kontrabandimit të migrantëve ndërthuret me atë të trafikimit të qenieve njerëzore, kryesisht në rastet kur migrantët e parregullt përjetojnë trajtim dhe shfrytëzim degradues. Për këtë arsye, veprat penale të trafikimit të parashikuara në Kodin tonë Penal (*shiko nenet 110/a, 110/b, 110/c dhe 128/b*) përbëjnë një garanci për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, përfshi këtu dhe migrantët e parregullt, kryesisht kategoritë vulnerabël gratë dhe fëmijët e pashoqëruar.

5.2 Analizë kronologjike e zbatimit të legjislacionit dhe politikave mbi migracionin sipas Raporteve të Komisionit Evropian 2018-2021

Që nga viti 2018 e deri më sot Shqipëria ka bërë progres sa i përket krijimit të një legjislacioni që rregullon fushën e migracionit duke e përafëruar atë gjithnjë e më shumë me *acquis-n* e BE, por dhe në harmoni me parimet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të migrantëve.

Pavarësisht ekzistencës së një kuadri të plotë ligjor, aktualisht sistemi vuan nga mungesa e zbatimit efikas të tij. Ky fakt nënvizohet nga raportet ndërkombëtare mbi Shqipërinë, raportet vjetore të institucioneve shtetërore shqiptare, si dhe nga raportet e vlerësimit nga OJF-të vendase.

Në Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2018 bie në sy konstatimi i mungesës së një strategjie gjithpërfshirëse kombëtare mbi çështjet e menaxhimit të migracionit, si dhe inicimi i hartimit dhe miratimit të një marrëveshjeje me FRONTEX, e cila do të lejonte këtë të fundit të asistonte autoritetet shqiptare në menaxhimin e kufijve të jashtëm, me qëllim forcimin e kontrollit kufitar dhe luftën ndaj trafikeve të paligjshëm. Janë konstatuar gjithashtu probleme në zbatueshmërinë e ligjit për të huajt, pasi “në vend ka vetëm një qendër të mbyllur për migrantët e parregullt (Qendra për migrantët e parregullt në Karreç), dhe nuk ka ambjente të posaçme për kategoritë vulnerabël të migrantëve të parregullt si: fëmijët, gratë dhe personat me probleme shëndetësore”.

Përsa i përket zbatueshmërisë së kuadrit ligjor lidhur me azilin, në Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2018 konstatohet se “autoritetet shqiptare duhet të sigurojnë që azilkërkuessit të kenë *të drejtën e ndihmës juridike* dhe shtetasit e kapur të vendeve të treta të kenë *akses në informacion* në lidhje me të drejtat dhe procedurat e azilit. Udhëzimi që rregullon procesin e *prescreening*, *ndalimin*, *kthimin dhe ripranimin* duhet të rishikohet dhe të

⁷⁸ https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/commission-guidance-implementation-facilitation-unauthorised-entry_en.pdf

përafrohet me standardet ndërkombëtare. Versioni i rishikuar duhet të përfshijë garanci procedurale për të gjitha kategoritë e personave vulnerabël. Ai duhet të harmonizojë përmbajtjen e tij me ligjin e ri për të drejtat e fëmijëve dhe t'i referohet në mënyrë specifike pajtueshmërisë me *të drejtat gjuhësore dhe parimin e mos-kthimit*”⁷⁹.

Në Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë **për vitin 2019** është theksuar se kuadri ligjor për migracionin duhet të përafrohet më tej me *acquis* e BE. Në këtë raport përmendet si pozitiv fakti se në qershor 2019, Shqipëria planifikonte të miratonte Strategjinë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit dhe Planin e Veprimit 2019-2022, duke siguruar një kuadër të qartë për të menaxhuar dhe koordinuar më mirë flukset e migrimit. Arritje konsiderohet dhe hyrja në fuqi e Marrëveshjes Statusore me FRONTEX dhe fillimi i zbatimit të saj në 1 Maj 2019, duke e konsideruar një kontribut të shtuar në luftën kundër migracionit të paligjshëm dhe trafikimit të migrantëve.

Në këtë raport është konstatuar se “flukset migratore ishin kryesisht të një natyre tranzitore, me shumicën e migrantëve që mbërritën nga Greqia dhe u larguan nga Shqipëria pas disa ditësh. Kapaciteti pritës i Shqipërisë për të akomoduar migrantët ishte i mjaftueshëm. Qendra e saj pritëse për migrantët e parregullt në Karreç, me një kapacitet të përgjithshëm prej 150 shtretërish, kërkon rinovim. Ashtu si në raportin e vitit 2018 theksohet sërish se vendi ende nuk ka mjedise për të miturit e pashoqëruar. Alternativat e ndalimit duhet të vendosen për fëmijët, gratë në rrezik dhe personat me gjendje të rëndë mjekësore, siç parashikohet në Ligjin për të huajt”. Gjithashtu është vërejtur se ende Shqipëria nuk kishte një *Plan Kontigjence* të përditësuar për një fluks të mundshëm masiv të migrantëve dhe azilkërkuesve, të miratuar zyrtarisht nga qeveria.

Një tjetër problematikë që lidhet me zbatimin e kuadrit ligjor për të huajt, që prek migrantët e parregullt, ishte dhe ajo e disa raportimeve për kthime joformale në Greqi. Në këtë raport është kërkuar që Shqipëria të zbatojë procedurat e kthimit në përputhje me Ligjin për të huajt dhe të sigurojë që mekanizmi i kthimit të saj për migrantët e parregullt të jetë në përputhje me *acquis* të BE -së.

Sa i përket çështjeve të zbatimit të kuadrit ligjor mbi azilin, paraqiten në përgjithësi të njëjta problematika në zbatim si në vitin 2018⁸⁰.

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë **për vitin 2020**, thekson se kuadri ligjor për migracionin është kryesisht i harmonizuar me *acquis-në* e BE-së, por ka nevojë për përditësim në përputhje me zhvillimet e fundit. Është vlerësuar se ka një progres të mirë në trajtimin e sfidave të migracionit të parregullt, përfshirë forcimin e kontrolleve të kufirit, por Shqipëria vazhdoi të përjetojë një fluks në rritje të migrantëve të parregullt, kryesisht nga Greqia, të cilët largoheshin nga Shqipëria pas disa ditësh, për të shkuar në vendet e tjera të BE-së. Në këtë raport rekomandohet gjithashtu se “Shqipëria duhet të krijojë alternativa ndaj paraburgimit për fëmijët, gratë në rrezik dhe personat me gjendje të rëndë mjekësore, siç parashikohet në ligjin “Për të huajt”, nuk ka ambiente akomodimi të veçanta për të miturit e pashoqëruar, dhe se duhet të miratohet një plan emergjence për një numër të konsiderueshëm të mundshëm të mbërritjeve të migrantëve dhe azilkërkuesve, me një buxhet dhe modalitete të qarta për zbatimin e tij”.

⁷⁹ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/20180417-albania-report.pdf>

⁸⁰ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2019-07/20190529-albania-report.pdf>

Një problematikë e theksuar në këtë raport, në vazhden e konstatimeve për moszbatim rigoroz të kuadrit ligjor që lidhet me migrantët e parregullt, i referohet disa raporteve për migrantë të kthyer në Greqi jashtë kuadrit ligjor dhe/ose procedural, përpara se të kryhej shqyrtimi paraprak (procedura e pre-screening). Për pasojë, është rekomanduar që Shqipëria duhet të zbatojë procedurat e kthimit në përputhje me ligjin “Për të huajt” dhe të sigurojë që mekanizmi i kthimit për migrantët e parregullt të jetë në përputhje me *acquis-në* e BE.

Përsa i takon kuadrit ligjor mbi azilin dhe zbatimin e tij është konstatuar se mbeten ende mangësi sa i takon hartimit të akteve nënligjore dhe udhëzimeve të brendshme për të rregulluar procedurat dhe për të udhëzuar autoritetet kompetente. Është konstatuar si problematikë fakti që Komisioni Kombëtar për Refugjatët dhe Azilin nuk ka funksionuar në vitin 2018 dhe 2019, nuk janë caktuar burimet e nevojshme për përkthyes të kualifikuar me kohë të plotë gjatë dhe pas identifikimit fillestar, refugjatët janë përjashtuar nga strehimi social dhe azilkërkuesit janë përjashtuar nga ndihma sociale. Në këto rrethana, përpjekjet për të ofruar ndihmë për integrim mbeten mjaft të kufizuara.

Problematika të tjera në këtë fushë, gjatë 2020, ishin kufizimet e intervistave dhe procedurave të azilit gjatë shpërthimit të pandemisë COVID-19, nevoja për ndryshime në udhëzimet e identifikimit fillestar për të përfshirë masa mbrojtëse shtesë, veçanërisht për njerëzit në nevojë dhe ata me nevoja specifike, duke përfshirë identifikimin e hershëm të fëmijëve në rrezik. Sipas këtij raporti e gjithë procedura e azilit mund të përmirësohet me kontribut më të drejtpërdrejtë nga Drejtoria për Azil dhe Shtetësi, me pjesëmarrjen e rregullt në intervista dhe mbështetjen për policinë.⁸¹

Gjetjet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë **për vitin 2021**, lidhur me çështjet e migracionit të parregullt drejt Shqipërisë, janë të fokusuar kryesisht në problematikat e mëposhtme⁸²:

- ✓ Identifikimin e hershëm të viktimave dhe viktimave të mundshme, veçanërisht në flukset e përziera të migracionit dhe të intensifikojë bashkëpunimin ndërkufitar me vendet fqinje dhe bashkëpunimin ndërkombëtar (fq.39);
- ✓ Kuadri ligjor për migracionin është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së, por ka nevojë për përditësim në përputhje me zhvillimet e fundit në anën e BE-së (fq.43);
- ✓ Mungesa e ambienteve të veçanta për të miturit e pashoqëruar. Shqipëria duhet të miratojë një plan emergjence për një numër të konsiderueshëm të mundshëm ardhjesh të migrantëve dhe azilkërkuesve, me një buxhet dhe modalitete të qarta për nxitjen e tij (fq.44);
- ✓ Oficerët e Policisë Kufitare dhe Migracionit duhet të rrisin kapacitetet e tyre për të identifikuar migrantët me nevoja specifike. Koordinimi me departamentet e mbrojtjes së fëmijëve dhe antitrafikimit duhet gjithashtu të përmirësohet. Në vitin 2020 ka pasur një rast të kthimit vullnetar të një shtetasi libian, të ndihmuar nga IOM. Raportimet për migrantët që kthehen në Greqi jashtë një kuadri ligjor dhe/ose procedural, pa ekzaminim paraprak, kanë vazhduar gjatë periudhës raportuese. Shqipëria duhet të zbatojë procedurat e kthimit në përputhje me Ligjin për të huajt dhe të sigurojë që mekanizmi i kthimit të migrantëve të

⁸¹ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/albania_report_2020.pdf

⁸² https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

- parregullt të jetë në përputhje me *acquis* të BE-së, duke përfshirë respektimin e plotë të të drejtave themelore (fq.44);
- ✓ Në vitin 2020, në Policinë e Kufirit dhe Migracionit kanë bërë kërkesë për azil 2 102 persona, që paraqet një rënie shumë të konsiderueshme krahasuar me 6 677 në vitin 2019, ndërsa numri i migrantëve të kapur është rritur. Pas rihapjes së kufijve në qershor, janë regjistruar vetëm 50 referime për azil deri në fund të vitit 2020. Qasja në procedurat e azilit duhet të përmirësohet (fq.45)
 - ✓ Udhëzimi i ri i përzgjedhjes duhet të miratohet me shpejtësi nga Ministria e Brendshme dhe të zbatohet dhe të përmirësohen procedurat e azilit. Zyra Evropiane e Mbështetjes për Azilin ra dakord për një Udhërrëfyes për bashkëpunimin me Shqipërinë në janar 2021;
 - ✓ Duhet të forcohen kompetencat hetimore të policisë kufitare, veçanërisht për të zbuluar rastet e kontrabandës dhe trafikimit të qenieve njerëzore (fq.47);
 - ✓ Bashkëpunimi operacional me vendet fqinje vazhdoi të jetë i mirë, megjithëse duhet të shtojë përpjekjet për të përmirësuar bashkëpunimin dypalësh (fq.48);
 - ✓ Duhet të përmirësohet më tej bashkëpunimi ndërkombëtar dhe zbatimi në kohë i instrumenteve shumëpalëshe. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin me *acquis* të BE-së dhe për të promovuar shkëmbimin e praktikave më të mira në bashkëpunimin gjyqësor (fq.48).

Vazhdojnë të mbeten sfida të zbatimit në praktikë të çështjeve të tilla si: identifikimi i hershëm i viktimave dhe viktimave të mundshme në flukset e përziera migratore, procedurat e *pre-screening* të zbatuara plotësisht, aksesit në azil, mekanizmi i kthimit për migrantët e parregullt që do të zbatohet në përputhje me *acquis* të BE-së etj.

Duhet theksuar se në vitin 2021 u miratua dhe hyri në fuqi ligji i ri për azilin (Ligji nr.10/2021) dhe ligji për të huajt (Ligji nr.76/2021), të cilët i hapën rrugën hartimit të akteve të reja nënligjore, duke përafuar më shumë legjislacionin tonë me *acquis* të BE, e duke kontribuar në përmbushjen e rekomandimeve të raporteve të Komisionit Evropian, por edhe implementimit më të mirë të kuadrit ligjor bazuar në standartet ndërkombëtare. Sigurisht, zbatimi në praktikë nga institucionet përgjegjëse shqiptare i gjithë këtij kuadri të ri ligjor, do të kërkojë kohën e nevojshme për t'u vlerësuar, por dhe për të identifikuar risqet apo problematikat në zbatim.

Nëse do të analizojmë zbatimin e masave të parashikuara në dokumenta të rëndësishëm strategjikë që lidhen me migracionin, e specifikisht Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2014-2020, referuar analizës së bërë në strategjinë e re të miratuar në dhjetor 2020, rezulton se objektivat e strategjisë dhe planit të veprimit (2014–2020) janë realizuar në një pjesë të konsiderueshme të tyre, mundësuar kjo dhe nga një seri aktivitesh të ndërmarra në bashkëpunim me Bashkimin Evropian, me prioritetet e mëposhtme⁸³:

- harmonizimi i legjislacionit me *acquis* të BE-së;
- përfundimi i marrëveshjeve bilaterale për kufirin shtetëror, vendkalimet kufitare dhe trafikun kufitar;
- nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale të bashkëpunimit policor dhe protokolleve për patrullime të përbashkëta;

⁸³ VKM nr.1117,dt.16.12.2020 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Kufirit 2021-2027”, fq.8 dhe 9: <https://cve.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/vendim-2020-12-16-1137.pdf>

- harmonizimi i konceptit organizativ dhe të personelit;
- modernizimi dhe përmirësimi i sistemeve të arsimit dhe të aftësisë, si dhe ngritja e nivelit të profesionalizmit të oficerëve të kufirit;
- përmirësimi i sistemit të informacionit dhe infrastrukturës kufitare;
- prokurimi i pajisjeve teknike të nevojshme për kryerjen e kontrolleve kufitare dhe mbikëqyrjen kufitare;
- krijimi dhe përditësimi i analizës së rrezikut dhe shkëmbimi i informacionit në përputhje me një model të përbashkët të analizës së rrezikut;
- forcimi i aftësive për të luftuar korrupsionin dhe forcimi i kornizës ligjore dhe mekanizmave për bashkëpunim dypalësh dhe shumëpalësh.

Në vijim të analizës së sipërcituar, lidhur me realizimin e objektivit për përmirësimin e infrastrukturës për akomodimin e migrantëve dhe azilkërkuesve, në bashkëpunim me agjencitë e përfshira në këtë proces është mundësuar hapja e Qendrave të Përkohshme të Pritjes në Gjirokastrë, Kakavijë dhe Ersekë.

Gjithashtu, në sajë të mbështetjes së ofruar nga organizata dhe institucione partnere, në Policinë Kufitare dhe Migracionit situata e furnizimit me pajisje ka ndryshuar dukshëm, duke forcuar kapacitetet e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit.

5.3 Një vështrim krahasues me praktikën e BE-së dhe standarteve më të mira ndërkombëtare

- **Pakti i ri mbi Migracionin dhe Azilin** ⁸⁴

Nëse do të flasim për modelin apo standartet më të mira të BE-së për menaxhimin e migracionit, kryesisht me qëllim parandalimin e migracionit të prregullt, është e rëndësishme t'i referohemi dokumentit të fundit të miratuar nga Komisioni Evropian, i quajtur “Pakti i ri mbi Migracionin dhe Azilin”.

Ky dokument siguron një qasje gjithëpërfshirëse, duke bashkuar politikat në fushat e migracionit, azilit, integritit dhe menaxhimit të kufirit, duke pranuar se efektiviteti i përgjithshëm varet nga përparimi në të gjitha aspektet.

“Pakti i ri mbi Migracionin dhe Azilin” krijon procedura më të shpejta, agjenci më efektive, qeverisje më të fortë të politikave të migracionit dhe kufijve të mbështetur nga sistemet moderne të IT. Ai synon të reduktojë rrugët e pasigurta dhe të parregullta dhe të promovojë rrugë ligjore të qëndrueshme për ata që kanë nevojë për mbrojtje. Ai nxit ardhjen e migrantëve në BE përmes kanaleve ligjore duke e ndërlidhur me nevojat e tregut të punës në BE. ⁸⁵

Vlen të theksohet se ky dokument shoqërohet me një paketë prej 9 instrumentash ⁸⁶ ligjore të cilat synojnë të rregullojnë kryesisht procesin e përzgjedhjes (screening) së migrantëve të parregullt, procedurat e azilit, një rregullore të re për menaxhimin e migrimit dhe azilit, për

⁸⁴ https://ec.europa.eu/home-affairs/news/new-pact-migration-and-asylum-setting-out-fairer-more-european-approach-2020-09-23_en

⁸⁵ COMMUNICATION FROM THE COMMISSION on a New Pact on Migration and Asylum, Brussels 23.09.2020 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52020DC0609>

⁸⁶ [New Pact on Migration and Asylum, setting out a fairer, more European approach \(europa.eu\)](#)

menaxhimin e krizave migratore, rishikimin e Rregullores për bazën e të dhënave evropiane të daktiloskopisë së azilit (Eurodac)⁸⁷ si dhe një Udhëzues mbi direktivën për facilituesit e hyrjeve, tranzitit dhe qëndrimeve të paautorizuara.

Duke qenë se Shqipëria është një ndër vendet e Ballkanit Perëndimor që vazhdon të preket nga shifra të larta të flukseve migratore, dhe vazhdon të përafrojë legjislacionin e saj me *acquis* e BE “Pakti i ri mbi Migracionin dhe Azilin” duhet të shërbejë si një busull orientimi edhe për autoritetet shqiptare në përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për menaxhimin e migracionit, parandalimin e flukseve migratore, luftën ndaj kontrabandimit të migrantëve, dhe forcimin e bashkëpunimit me agjencitë evropiane si EASO, FRONTEX, EUROPOL, etj.

- ***Modeli i kontrollit të aksesit me katër nivele***

Bazuar në nevojën për bashkëpunim ndërmjet agjencive dhe bashkëpunimin ndërkombëtar (rajonal, dypalësh dhe shumëkombësh), *modeli i kontrollit të aksesit me katër nivele* përshkruhet si thelbi i menaxhimit të integruar të kufirit (MIK) në Katalogun Shengen të BE-së për Kontrollin e Kufijve të Jashtëm dhe Kthimin dhe Ripranimin.

Ky model përbëhet nga një sërë masash plotësuese që zbatohen në katër nivele të ndryshme: 1) Masat në vendet e treta; 2) Bashkëpunimi me vendet fqinje; 3) Kontrolli kufitar (në kufirin e jashtëm); dhe 4) Masat e kontrollit në zonën e lëvizjes së lirë, duke përfshirë kthimin.⁸⁸

Ky model kontrolli, pjesë thelbësore e konceptit të MIK, duhet të përshtatet e zbatohet dhe në kontekstin shqiptar. Edhe pse në Strategjinë e re Ndërinstitucionale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027 ka një qasje për të qenë në një linjë me konceptin e MIK të BE-së, mbetet ende shumë për të bërë në drejtim të zbatimit të këtij modeli kontrolli me qëllim minimizimin e migracionit të parregullt kontrabandimit të migrantëve. Kështu përshebull, autoritet shqiptare ende nuk kanë arritur që me vendet nga të cilat kanë flukset më të mëdha migratore (vende të Lindjes së Mesme apo dhe ato të Afrikës së Veriut) të nisnin një proces dialogu mbi migracionit të parregullt që ka origjinën nga këto vende dhe të finalizojnë Marrëveshjet dhe Protokollet e Ripranimit me to.

Sa i përket *bashkëpunimit me vendet fqinje*, tashmë është realitet se ka marrëveshje të bashkëpunimit ndërkufitar me to, madje në disa raste kryhen dhe patrullime të përbashkëta, kryesisht në pjesën e kufirit të gjelbër. Ky bashkëpunim ka nevojë të intensifikohet më shumë, pasi vitet e fundit shifrat tregojnë rritje të numrit të migrantëve të parregullt, të cilët shpesh lëvizin nga një vend i Ballkanit Perëndimor (BP) në një tjetër, duke abuzuar dhe me të drejtën për azil. Marrëveshjet e protokollit të ripranimit me vendet fqinje të BP edhe pse ka kohë që po zbatohen, ende ka problematika në zbatimin rigoroz të tyre, si dhe mungojnë raportet publike të monitorimit dhe zbatimit të këtyre marrëveshjeve. Në këtë kuadër, duhet theksuar se ende nuk është finalizuar protokollit i ripranimit me Greqinë, kufiri me të cilin mbetet porta kryesore

⁸⁷ <https://www.eulisa.europa.eu/Activities/Large-Scale-It-Systems/Eurodac>

⁸⁸ Guidelines for Integrated Border Management in European Commission External Cooperation, extracted version march 2015 , fq.8:

<https://www.icmpd.org/content/download/48352/file/Guidelines%20for%20Integrated%20Border%20Management%20in%20the%20European%20Commission%20External%20Cooperation%20-%20Extracted%20Version%20EN.pdf>

hyrëse e fluksit të migrantëve të parregullt në Shqipëri, dhe padyshim kjo mbetet një çështje për t'u përmbyllur nga autoritetet shqiptare, qoftë edhe me mbështetjen e BE-së.

Lidhur me *kontrollin kufitar* në Shqipëri, duhet theksuar se ndër vite ai është përmirësuar jo vetëm në sajë të legjislacionit të ri mbi kontrollin kufitar i cili pjesërisht është përafruar me atë të BE-së, por edhe se infrastruktura e Pikave të Kalimit Kufitar dhe pajisjet e policisë kufitare janë përmirësuar në sajë dhe të asistencës së donatorëve, kryesisht asaj të Bashkimit Evropian. Por, ende ka nevojë për përmirësim të kontrollit kufitar si përsa i përket pjesës së pajisjeve dhe teknologjisë (së fundmi, pas shtesave në Ligjin për Kontrollin Kufitar nr.22/2020), me nevojën për implementimin e sistemeve *API* dhe PNR***⁸⁹), por edhe shtimit e kualifikimit të burimeve njerëzore.

Sa i përket *kontrolleve brenda territorit të Shqipërisë*, ato duhen forcuar më tej dhe duhen marrë masa konkrete në drejtim të forcimit të ndërveprimit të departamentit të kufirit dhe migracionit me atë sigurisë publike dhe policisë kriminale. Kjo pasi vitet e fundit në territor është vërejtur një prezencë e shtuar e migrantëve të parregullt, të cilët shpesh bien pre e kontrabandistëve duke u premtuar kalimin e kufirit shqiptar drejt vendeve të BE-së. Edhe pse vitet e fundit është rritur forca goditëse në drejtim të rasteve të kontrabandimit të migrantëve, ende mbeten të larta rastet e identifikimit brenda territorit të migrantëve të parregullt, e po kështu mbeten ende të ulëta shifrat e kthimit të tyre. Këto të fundit, edhe pse ka një tendencë në rritje vitet e fundit, ende qëndrojnë në nivele të ulëta krahasuar me flukset migratore. Të ulëta mbeten dhe kthimet vullnetare. Vihet re se kthimet, raportohen në total duke llogaritur kthimet vullnetare, kthimet e detyrueshme dhe dëbimet, duke mos dhënë kështu një panoramë të qartë mbi llojet e kthimeve të aplikuar ndaj migrantëve të parregullt dhe atyre që iu është mohuar kërkesa për azil.

- ***Përmirësimi i mekanizmave të bashkëpunimit gjyqësor***

Një nga agjencitë evropiane që ushtron veprimtarinë në fushën e bashkëpunimit gjyqësor, EUROJUST, në kuadër të luftës kundër migracionit të paligjshëm, rekomandon si një masë të rëndësishme, përmirësimin e mekanizmave të bashkëpunimit gjyqësor.

Më 6 dhjetor 2018, Këshilli i Drejtësisë dhe i Çështjeve të Brendshme të Bashkimit Evropian miratoi një 'gamë masash gjithëpërfshirëse dhe operacionale' për të avancuar përgjigjen ndaj rrjeteve të kontrabandës së migrantëve. Një nga masat e miratuara përfshin një thirrje për Eurojust-in "që të vazhdojë të lehtësojë rrjetëzimin e praktikuesve (prokurorëve dhe gjyqtarëve) për të nxitur shkëmbimin e praktikave më të mira, identifikimin e sfidave dhe mësimet në nxjerra në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të kontrabandës së migrantëve, duke përfshirë edhe marrjen parasysh të nevojës për të ngritur një rrjet prokurorësh për këtë qëllim".⁹⁰

⁸⁹ <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/03/05/22>

*Informacioni paraprak i pasagjerëve (API) përfshin marrjen e të dhënave biografike të një pasagjeri dhe detajet e tjera të fluturimit nga transportuesi përpara nisjes dhe transmetimin e detajeve me mjete elektronike tek agjencitë e kontrollit të kufirit në vendin e destinacionit.

** Të dhënat PNR janë informacione të paverifikuara të ofruara nga pasagjerët dhe të mbledhura nga transportuesit ajrorë për të mundësuar proceset e rezervimit dhe check-in.

⁹⁰ <https://www.eurojust.europa.eu/eurojust-steps-fight-against-migrant-smuggling>

Për të forcuar më tej luftën kundër kontrabandimit të migrantëve, në Prill 2020 Eurojust krijoi një fokus grup prokurorësh dhe gjyqtarësh hetues që luftojnë kontrabandën e migrantëve. Ai përbëhet nga prokurorë dhe gjyqtarë hetues nga shtetet anëtare të BE-së të specializuar në rastet e kontrabandës së migrantëve dhe bashkon të gjithë aktorët e interesuar në zinxhirin e sigurisë dhe drejtësisë penale. Kësaj nisme iu bashkua edhe Qendra Evropiane e Kontrabandës së Migrantëve (QEKM) e Europol-it. Fokus grupi shërben si një qendër e rëndësishme për të lidhur rregullisht aktorët kryesorë gjyqësorë në nivel kombëtar në Shtetet Anëtare të BE-së, të cilët janë përgjegjës për trajtimin e krimeve të kontrabandës së migrantëve, për të mbështetur reagimin e tyre të përbashkët operacional.

Një nga synimet themelore është krijimi i një marrëdhënieje të përfortuar mes praktikuesve në fushën e kontrabandës së migrantëve dhe rritja e shkëmbimit të ekspertizës së tyre, me mbështetjen e Eurojust.




Figura 8

Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Përcjelljen e praktikave më të mira nga historiku i hetimeve të kontrabandës së migrantëve;
- Analizimin e tendencave dhe zhvillimeve të reja në taktikat operative të grupeve të kimit të organizuar aktive në kontrabandën e migrantëve;
- Studimi i ndikimit të ndryshimeve në rrugët e kontrabandës së migrantëve;
- Mbledhja e të dhënave nga praktikuesit gjyqësorë për sfidat aktuale dhe diskutimi i mundësive të bashkëpunimit gjyqësor në luftimin e këtij lloji specifik të kimit ndërkufitar.⁹¹

Ndoshta një model i tillë mund të replikohet edhe në kontekstin e brendshëm të përmirësimit të bashkëpunimit gjyqësor, e më pas në kontekstin rajonal e atë të bashkëpunimit me vendet e BE-së.

⁹¹ <https://www.eurojust.europa.eu/ar2020/4-enhancing-judicial-cooperation-policy-and-instruments/431-migrant-smuggling>

Tashmë Shqipëria pranë Eurojust që prej shkurtit 2021, ka prokurorin e saj ndërlidhës, duke hedhur kështu një hap konkret në drejtim të përmirësimit të luftës kundër migracionit të paligjshëm nëpërmjet mekanizmit të bashkëpunimit ndërkufitar, mbështetur nga Eurojust, kryesisht me fokus kryerjen e hetimeve të përbashkëta.

KREU VI

Analiza e pyetësorëve të kryer

Bazuar në gjetjet nga rishikimi i literaturës dhe në përputhje me supozimet teorike në lidhje me migracionin e parregullt, u hartua një pyetësor me 27 pyetje për të mbledhur të dhëna nga punonjësit e 4 strukturave: Sektori Anti-trafik dhe Migracioni (Ministria e Brendshme), Departamenti i Kufirit dhe Departamenti Migracionit (Policia e Shtetit), Sektori i Trafikeve (Policia e Shtetit), Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit (Ministria e Brendshme). Në kuadër të masave të ndërmarra për t'u mbrojtur nga pandemia, pyetësorët janë zhvilluar online. Ky seksion ofron rezultatet e sondazhit dhe interpretimin e të dhënave të mbledhura nga 11 pyetësorë të plotësuar. Konkretisht:

- 2 pyetësorë – Sektori Anti-trafik dhe Migracioni (MB);
- 1 pyetësor – Departamenti i Kufirit dhe Departamenti Migracionit (PSH);
- 5 pyetësorë – Sektori i Trafikeve (PSH);
- 3 pyetësorë – Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit (MB).

Gjatë analizimit të këtyre pyetësorëve nga grupi i punës, janë evidentuar disa mangësi dhe kufizime si më poshtë:

- Mungesa e numrit të planifikuar të pyetësorëve;
- Mungesa e përgjigjeve për një sërë pyetjesh (12 pyetje gjithsej);
- Mungesa e përgjigjeve për pyetjen respektive duke anashkaluar qëllimin e pyetjes;

Të pakta kanë qenë rastet kur përgjigja e dhënë nuk ka qenë relevante me pyetjen. Arsyeja e zbrërthimit jo të duhur të pyetjes mund të jetë perceptimi jo i saktë i pyetjes nga i intervistuari, ose mënjanimi i përgjigjes negative për zbatimin e detyrimeve nga ana e institucionit që përfaqëson.

Në këtë kontekst, për të patur një vlerësim sa më të plotë dhe të saktë, konsiderojmë marrjen parasysh të kufizimeve më lart. Pjesa vijuese e kësaj përmbledhje paraqet një vlerësim të gjetjeve kryesore të evidentuara nga analizimi i 11 pyetësorëve⁹² sipas 4 seksioneve kryesore të pyetësorit.

Seksioni 1: Informacion i përgjithshëm

Fillimisht vlen të sjellim në vëmendje se të intervistuarit janë thuajse të gjithë të angazhuar në pozicionin e specialistit në sektorët përkatës, ku 7 prej tyre janë femra dhe 4 janë meshkuj. Në grupin e të intervistuarve vihet re se numri i punonjësve me deri në 5 vite eksperiencë është thuajse i njëjtë me numrin e punonjësve me më shumë se 10 vite eksperiencë. Vetëm 2 prej tyre kanë 5-10 vite eksperiencë. Kohëzgjatja e eksperiencës së të intervistuarve, reflektohet në

⁹² Analizimi i pyetësorëve është realizuar nëpërmjet kodimit të pyetjeve-përgjigjeve me Programin MAXQDA.

përkufizimin që ata japin për konceptin e “parandalimit të trafikimit të migrantëve” dhe “mbrojtjes së të drejtave të migrantëve të trafikuar”. Thujse të gjithë të intervistuarit janë në dijeni se të parandalosh trafikimin, do të thotë të ndërmarrësh masa ligjore, nisma për organizimin e fushatave ndërgjegjësuere, ngritjen e kapaciteteve të punonjësve shtetërorë, hartimin e politikave për punësim, rritjen ekonomike, etj. Përsa i përket mbrojtjes së të drejtave të migrantëve të trafikuar, vetëm një numër i kufizuar i të intervistuarve e kanë përkufizuar atë si “marrjen e masave ose politikave kombëtare për respektimin e të drejtave të migrantëve të trafikuar, në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe konventat e ratifikuara”. Disa të intervistuar kanë dhënë përkufizim të ngushtë, ndërkohë që pjesa tjetër e të intervistuarve nuk e ka trajtuar fare si koncept. Ky fakt tregon se pavarësisht eksperiencës për një periudhë të caktuar kohore në strukturat përkatëse, konceptet bazë nuk janë kuptuar ose nuk janë konsideruar si të rëndësishme për t’u përthithur. Në këtë rast, rekomandohet që institucionet të kontrollojnë njohuritë mbi konceptet bazë të punonjësve duke ju ofruar mundësi trajnimi të herëpashershëm.

Përsa i përket natyrës së punës, 4 prej të intervistuarve ushtrojnë profesionin e tyre duke punuar në zyrë, ndërsa 7 prej tyre ushtrojnë profesionin duke punuar në zyrë si dhe duke u angazhuar në terren sipas rasteve dhe rrethanave konkrete. Avantazhi i karakteristikave të lartpërmendura të të intervistuarve është së këndvështrimet e tyre do të na japin një panoramë të qartë dhe realiste të situatës aktuale.

Seksioni 2: Parandalimi i trafikimit të migrantëve

Përsa i përket parandalimit të trafikimit të migrantëve, të intervistuarit u pyetën nëse ishin në dijeni të ekzistencës së kuadrit ligjor në lidhje me këtë çështje, duke i stimuluar të përmendin dokumenta/akte për të cilat kanë dijeni. Ndër aktet dhe dokumentat më të rëndësishme që u përmendën janë si më poshtë vijon:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
- Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut;
- Konventa mbi Statusin e Refugjatit (1951) dhe protokollin e saj zbatues;
- Ligji nr. 9642/2006, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”;
- Ligji nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 7895/1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 108/2013, “Për të huajt” i ndryshuar;
- Ligji nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”;
- Ligji nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 582/2011 “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 115/2016 “Për një shtesë në vendimin nr. 663, datë 17.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të

luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013–2020, dhe Planit të Veprimit 2013–2016”;

- Udhëzim i Ministrisë të Brendshme nr.293/2015 “Mbi procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë”;
- Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufijve 2014-2020;
- Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2019-2022;
- Memorandum Bashkëpunimi nr. 6538, datë 15.10.2014, ndërmjet Kordinatorit Kombëtar për luftën kundër trafikimit të personave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore “Për procedurat e bashkëpunimit për identifikimin e rasteve të punës së detyruar dhe trafikimit me qëllim shfrytëzimin e punës”;
- Marrëveshje Bashkëpunimi nr. 432/1, datë 22.01.2016, ndërmjet Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara për "Ofrimin e ndihmes ligjore e psikologjike falas për të miturit dhe krijimin e kushteve për respektimin e të drejtave të tyre”;
- Memorandum Mirëkuptimi nr. 6960/2, datë 10.10.2019, ndërmjet Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin dhe Policisë së Shtetit;

Vihet re se pjesa më e madhe e të intervistuarve kanë përmendur vetëm disa akte ligjore kombëtare, e disa të tjerë kanë përmendur vetëm disa akte ligjore ndërkombëtare. Shumë pak të intervistuar kanë renditur një kuadër të plotë ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar. Disa prej tyre kanë pohuar ekzistencën e një kuadri ligjor por pa dhënë asnjë specifikim, sikurse ka dhe të intervistuar që shprehen se nuk janë në dijeni të akteve konkrete ligjore dhe/ose nënligjore. Një panoramë e tillë, nënkupton se punonjësit kanë mangësi në njohuritë teorike që kanë ndërlidhje me fushën e tyre të veprimit. Kjo dukuri ndikon drejtpërdrejt në mënyrën e zbatimit të detyrave funksionale dhe interpretimin e të dhënave të përfuara nga praktika. Si e tillë, nevojitet që burimet njerëzore të strukturave përkatëse të hartojnë një plan konkret trajnimi të herëpashershëm për njohuritë teorike të punonjësve.

Në lidhje me përafrimin e legjislacionit ekzistues, pothuajse të gjithë të intervistuarit vlerësojnë si të nevojshëm rishikimin dhe përafrimin e legjislacionit kombëtar me *acquis* të BE. Ky gjykim në pamje të parë duket si paradoksal përse kohë shumë prej të intervistuarve nuk kanë dijeni konkretisht për kuadrin ligjor në fuqi.

Pavarësisht kësaj, vlerësimi merret për bazë përse kohë mbulon të intervistuarit që kanë dijeni për të. Të ndodhur në kushtet që vendi ynë aktualisht po përfiton asistencë teknike për procesin e integritimit evropian, vlerësimi i mësipërm rekomandohet të merret në konsideratë nga grupi i punës përgjegjës për Kapitullin 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”, që trajton ndër të tjera rishikimin e legjislacionit kombëtar dhe përafrimin e tij me *acquis*-në e Bashkimit Evropian.

Për të hyrë në detaje më konkrete, të intervistuarit u pyetën nëse janë në dijeni se ekzistojnë protokolle apo mjete që ndihmojnë në identifikimin e migrantëve të trafikuar. Si rregullore/protokolle, janë përmendur të tilla si psh.procedura standarde nr. 172, datë 08.02.2018 “Për përzgjedhjen e shtetasve të huaj të parregullt dhe masat që merren”, janë formularët e intervistimit dhe të identifikimit dhe intervistimi paraprak i personit.

Ajo që vihet re është se ka raste në të cilat pyetja nuk ka marrë përgjigje ose të intervistuarit janë shprehur se nuk ka protokolle apo rregullore për të identifikuar migrantin e trafikuar.

Disa nga përgjigjet kanë qënë mjaft të përgjithshme si përshebull pohimi se ka procedura të miratuara, ose duke u shprehur thjesht se pas identifikimit, punonjësit procedojnë sipas parashikimeve ligjore dhe procedurave të parashikuara.

Këto përgjigje krijojnë përshtypjen se personat e përfshirë në këtë proces, nuk kanë dijeni për të. Sugjerohet që burimet njerëzore të strukturave të posaçme të përgatisin një informacion shkurtimisht të përmbledhur për protokollet, rregulloret dhe mjetet që ndihmojnë në identifikimin e migrantëve të trafikuar.

Të intervistuarit u pyetën se si procedojnë ata pas identifikimit të migrantit të trafikuar. Ata u përgjigjën se fillimisht krijohet mundësia e komunikimit fillestar me migrantin, për të kuptuar se nga vjen dhe gjuha që ai flet, më pas pyetet në prani të një përkthyesi. Qëllimi i intervistimit është marrja e të dhënave të detajuara për identitetin e tyre, itinerarin e lëvizjes, arsyet /shkaqet e largimit nga vendi i tyre në mënyrë të parregullt, mënyrën e udhëtimit, nëse është ndihmuar apo shfrytëzuar nga persona të tjerë për të kryer kalimin e paligjshëm të kufirit. Pas këtij veprimi migranti dorëzohet në Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit i cili është autoriteti që kryen procedurat e mëtejshme për migrantët e paligjshëm e për ndjekjen e procedurave për azil (nëse ai e kërkon) ose për riatdhesim. Gjithashtu u përmend se migrantëve të trafikuar u plotësohen nevojat bazë (ushqim, uje, tualet, ngrohje dhe siguri fizike) dhe ata dërgohen në qendrën më të afërt spitalore me qëllim marrjen e trajtimit dhe kujdesit mjekësor. Në çdo rast njoftohet ambasada/konsullata përkatëse e vendit nga i cili vjen migranti, si dhe njoftohen OSHC-të që kanë objekt mirëqenien e migrantit. Kategoritë “vulnerabël” (gra, gra shtatzëna, fëmijë, persona me aftësi të kufizuar, të sëmure etj) bëhen subjekte të procedurës së intervistimit/përzgjedhjes pas përfitimit të asistencës së nevojshme dhe sistemimit/akomodimit në ambientet përkatëse. Këtu i kushtohet rëndësi dhe identifikimit të VMT/VT, duke respektuar PSV-të në fuqi, të miratuara me VKM në vitin 2018. Një hallkë e rëndësishme e procesit është dhe qëndrimi në koherencë me Prokurorin e gatshëm për ta ndihmuar atë në identifikimin e “kontrabanduesit”, bashkëpunëtorët e tij, në rast se nuk është bërë e mundur kapja e tyre në flagrancë bëhet kërkimi policor apo njoftimi në kufi, sekuestrimi i sendeve, mjeteve dhe kryerja e vendimeve të ekspertimit daktiloskopik vlerësues si dhe çdo veprim tjetër procedural i nevojshëm në varësi të rastit.

Nga tërësia e përgjigjeve për këtë çështje, vihet re se të intervistuarit janë në dijeni dhe të qartë për fazat që ndiqen kur identifikohet një migrant i trafikuar.

Një çështje mjaft e diskutuar janë masat e marra nga institucioni shtetëror për të parandaluar trafikimin e migrantëve. Një pjesë e të intervistuarve nuk kishin dijeni mbi masat e marra kundër këtij fenomeni, duke e lënë pyetjen pa përgjigje, duke dhënë përgjigje të përgjithshme ose jo relevante me pyetjen. Vetëm një pjesë e vogël e të intervistuarve kishin njohuri të sakta mbi masat për parandalimin e trafikimit të migrantëve, të cilat renditen si më poshtë vijon:

- kontrolli në kufi;
- bashkëpunimi me Frontex;
- hetimet dhe zbulimin e rasteve në bashkëpunim me prokurorinë;

- Kryerja e hetimeve proaktive me metoda speciale të hetimit;
- Kontrolle të vazhdueshme në zonat me risk, ndalimi apo arrestimi i kontrabandistëve, referimi i rasteve në prokurori dhe bashkëpunimi i ngushtë me këtë institucion;
- kontrolle të vazhdueshme në terren;
- identifikimi i personave kontigjentë të cilët kanë këtë tendencë dhe mbajtja e tyre nën vëzhgim;
- komunikimi i vazhdueshëm me personat e akomoduar në qendër për të parë nëse ka ndryshime të sjelljes, gjë që mund të çojë në identifikimin e një rasti të tillë;
- grumbullimi i informacioneve nga komuniteti apo në rrugë operative, etj.

Përsa më sipër, sugjerohet që punonjësit të informohen dhe të njihen me llojet e masave që institucioni shtetëror duhet të ndërmarrë për të parandaluar trafikimin e migrantëve.

Përgjigjet e të intervistuarve janë thuajse unanime në vlerësimin e nevojës mjaft të madhe për më shumë burime njerëzore dhe logjistike për të luftuar trafikimin e migrantëve. Përsa i përket nevojës për të rritur kapacitetet hetimore për të luftuar trafikimin e migrantëve, të intervistuarit ndahen në dy grupe. Njëri grup vlerëson si lehtësisht më pak të nevojshme rritjen e kapaciteteve hetimore, ndërsa pjesa tjetër e vlerëson si shumë të nevojshme.

Nga ky rezultat, sugjerohet që rritja e burimeve njerëzore, logjistike dhe kapaciteteve hetimore të marri vëmendje të posaçme dhe të adresohen sa më parë me prioritet.

Në lidhje me bashkëpunimin aktual rajonal dhe shkëmbimin e informacionit për parandalimin e trafikimit të migrantëve, pjesa më e madhe e të intervistuarve e vlerësojnë atë si të kënaqshëm. Një pjesë e konsiderueshme e tyre e konsideron bashkëpunimin rajonal dhe shkëmbimin e informacionit disi të kënaqshëm. Në përgjigjet e dhëna ka patur vetëm një rast që e vlerëson si shumë të kënaqshëm dhe një rast si aspak të kënaqshëm.

Duke ju referuar alternativave të vlerësimit në pyetësor të cilat janë të të gjitha niveleve, si dhe tërësisë së përgjigjeve, rekomandohet që bashkëpunimi rajonal dhe shkëmbimi i informacionit duhet analizuar me kujdes për të kuptuar qartë se cilët janë faktorët që ndikojnë në mungesën e vlerësimit maksimal. Drejtuesit e strukturave përkatëse duhet të adresojnë pengesat dhe vështirësitë me të cilat përballen punonjësit e tyre në raport me homologët e huaj, në aspektin e kuadrit ligjor, administrativ dhe procedural.

Roli i OSHC-ve në parandalimin e trafikimit të migrantëve, përgjithësisht vlerësohet si i mirë. Vlerësimi për to si shumë i mirë dhe jo aq i mirë ndahet në dy grupe të barabarta.

Kjo larmishmëri vlerësimi, duhet marrë në konsideratë nga OSHC-të (që në objektin e veprimtarisë së tyre kanë migracionin e parregullt), me qëllim rishikimin e mënyrës së zbatimit të projekteve të tyre dhe adresimin e nevojave të target grupeve. Vlerësimi i lartpërmendur sugjerohet të merret në konsideratë dhe nga donatorët, të cilët duhet të tregojnë kujdes në monitorimin e zbatimit të projekteve të tilla, si dhe vlerësimin e përmbushjes së qëllimit nëse arrin në nivelin e pritshëm ose jo.

Mjaft interesante paraqitet panorama e sfidave kryesore në parandalimin e trafikimit të migrantëve, të cilat të intervistuarit në fakt i kanë parashtruar si nevoja. Konkretisht:

- forcimi i bashkëpunimit midis agjencive të zbatimit të ligjit;

- krijimi i “të dhënave të gjurmueshme”, të proceseve dhe dënimeve të shoqëruara me përdorimin sistematik të hetimeve financiare të personave që kryejnë trafikimin e migrantëve;
- rritja e kapaciteteve njerëzore dhe njohja me eksperiencat dhe praktikat më të mira të shteteve të tjera;
- përmirësimi dhe zbatimi i duhur i i legjislacionit;
- forcimi i sanksioneve;
- rritja dhe forcimi i bashkëpunimit policor rajonal dhe ndërkombëtar;
- marrja e masave shtrenguese për parandalimin e fenomenit;
- intensifikim i punës për parandalimin, evidentimin, hetimin dhe goditjen në kohë të rasteve personave që merren me trafikimin e migrantëve;
- forcimi i kontroleve të vijës kufitare.

Nga interpretimi i tërësisë së sfidave/nevojave të listuara, arrihet të kuptohet se vështirësitë në luftimin e fenomenit janë shumë dimensionale. Në këtë kuadër, rekomandohet që nevojat e adresuara të përfshihen në planet vjetore të veprimit, duke i zbërthyer në nënaktivitete, në mënyrë të tillë që të shërbejnë si indikatorë matës drejt përmbushjes së qëllimit brenda një periudhe të caktuar kohore.

Seksioni 3: Mbrojtja e migrantëve të trafikuar

Në kuadër të migracionit të parregullt, një vëmendje të veçantë i është dedikuar mbrojtjes së migrantëve të trafikuar. Në këtë seksion, fillimisht të intervistuarit u pyetën se çfarë mendimi ndanin për legjislacionin dhe dokumentat strategjike kombëtare, nëse këto të fundit i plotësojnë kriteret evropiane dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e migrantëve të trafikuar ose jo. Thujse të gjitha përgjigjet ishin unanime në konstatimin se legjislacioni ynë është përafuar me mekanizmat ndërkombëtare me qëllim unifikimin e praktikave për raste të ngjashme. Vetëm një pjesë e vogël të intervistuarve mendojnë se ka ende nevojë për përmirësim.

Përgjigjet e mësipërme, rezultojnë të mos jenë në raport të drejtë me përgjigjet në lidhje me pyetjen nëse duhet përmirësuar kuadri rregullator në lidhje me mbrojtjen e migrantëve të trafikuar. Shumica e të intervistuarve sugjerojnë që kuadri ligjor ka lehtësisht nevojë për përmirësim. Pjesa tjetër mendon se legjislacioni ka shumë nevojë për përmirësim. Nga analizimi i mësipërm, rekomandohet që kuadri ligjor dedikuar mbrojtjes së migrantëve të trafikuar, të marrë një vëmendje të posaçme dhe të trajtohet me kujdes nivel i rishikimit dhe përmirësit të tij.

Të intervistuarit u pyetën për zyrtarët që janë në kontakt me migrantët e trafikuar, nëse kanë njohuri të mjaftueshme për trajtimin e tyre në kuadër të respektimit të të drejtave të njeriut. Pjesa më e madhe u përgjigjën se këta zyrtarë kanë njohuri të mjaftueshme, ndërsa një pjesë e vogël e tyre u shprehën se zyrtarët kanë pjesërisht njohuri. Në këtë konstatim, rekomandohet të hulumtohet më tej se çfarë mangësish kanë zyrtarët, të cilat duhet të rikupërohen.

Përsa i përket bashkëpunimit midis agjencive të ndryshme shtetërore në lidhje me mbrojtjen e migrantëve të trafikuar, përgjigjet e të intervistuarve janë ndarë thujse në dy grupe të barabartë

që e kanë vlerësuar si të mirë dhe shumë të mirë. Në vijim të kësaj pyetje, të intervistuarit janë nxitur të ndajnë eksperiencën e tyre për këtë çështje por vihet re se asnjë prej tyre nuk ka sjellë një rast konkret të bashkëpunimit si të mirë apo shumë të mirë. Nga ky rezultat, rekomandohet që rastet e bashkëpunimit të vlerësuara si “të mira”, të analizohen me kujdes dhe të evidentohen faktorët që i pengojnë ato për të qënë bashkëpunime “shumë të mira”.

Një çështje sensitive është dhe përcaktimi i migrantëve të trafikuar si viktime të mundshme të trafikimit (VMT). Thuhet të gjithë të intervistuarit shprehen se migrantët e trafikuar në disa raste ndodh që të jenë të tillë, pra jo gjithmonë. Nga eksperiencat personale të të intervistuarve, ata shprehen se grupi më i riskuar i migrantëve si VMT janë minorenët e pashoqëruar dhe femrat, të ardhur kryesisht nga vendet e luftës. Përtej kësaj, ata listojnë treguesit parësorë dhe dytësorë që ndihmojnë në identifikimin e migrantit si VMT, si më poshtë vijon:

Tregues parësorë

- Personi informon se është keqpërdorur, abuzuar, kërcënuar, shfrytëzuar dhe është i kënaqur/e kënaqur që ka rënë në kontakt me autoritetet dhe jep shenja se kërkon ndihmë;
- I mituri/e mitura është i/e shoqëruar nga një i/e rritur që është i/e njohur për trafikimin e personave të rritur e të mitur;
- Personi deklaron se ka punuar apo ka ndërmend të punojë në një punë të papërshtatshme për moshën e tij/saj;
- Personi ka dokumente false;
- I mituri/e mitura që po kalon kufirin ilegalisht nuk udhëton me dijeninë e prindërve;
- Personi ka shenja të dukshme dhune dhe shfrytëzimi;
- I mituri/e mitura është i/e pashoqëruar dhe mungesa e autorizimit të prindit për të udhëtuar nuk shpjegohet thjesht me neglizhencën e prindërve;
- I mituri/e mitura nuk ka pasaportë apo ndonjë dokument identifikimi dhe rezulton si i paregjistruar (nuk ka pasur ndonjëherë dokument) etj.

Tregues dytësorë

- Personi është i/e frikësuar apo i/e pakënaqur që ka rënë në kontakt me autoritetet, qëndron i/e mbyllur dhe refuzon të flasë apo ka frikë të flasë me një person të ligjit;
- Personi duket i/e lënë pas dore: është i/e kequshqyer, i/e veshur në mënyrë të papërshtatshme për moshën apokushtet atmosferike;
- Personi paraqet vetëbesim dhe pjekuri të pazakontë për moshën e tij/saj;
- I mituri/e mitura deklaron se e ka siguruar dokumentin e udhëtimit dhe vizën nga familjarët;
- Personi/i mituri ka para apo sende me vete për të cilat nuk ka një shpjegim bindës;
- I mituri/e mitura është i/e shoqëruar nga një i rritur/e rritur jo familjar i cili/e cila ngul këmbë të qëndrojë me të gjatë gjithë kohës.

Pyetjes nëse sistemi ynë i azilit është ndikuar nga migrantët e parregullt, shumica e të intervistuarve shprehen si sistemi është ndikuar lehtësisht nga ky target grup. Ndërkohë që një pjesë e vogël e tyre, shprehen se sistemi i azilit është shumë i ndikuar.

Roli i OSHC-ve në mbrojtjen e migrantëve të trafikuar, përgjithësisht vlerësohet si i mirë. Vlerësimi për to si shumë i mirë dhe jo aq i mirë ndahet në dy grupe të barabarta. Kjo shkallë vlerësimi, duhet marrë në konsideratë nga OSHC-të, me qëllim rishikimin e mënyrës së zbatimit të projekteve të tyre dhe adresimin e nevojave të target grupit. Vlerësimi i lartpërmendur sugjerohet të merret në konsideratë dhe nga donatorët, të cilët duhet të tregojnë kujdes në monitorimin e zbatimit të projekteve të tilla, si dhe vlerësimin e përmbushjes së qëllimit nëse arrin në nivelin e pritshëm ose jo.

Seksioni 4: Praktikrat më të mira mbi sigurinë e qenieve njerëzore dhe kufijve

Të intervistuarit u pyetën nëse ishin në dijeni të praktikave më të mira lokale, rajonale dhe/ose ndërkombëtare mbi sigurinë e qenieve njerëzore dhe kufijve. Pjesa më e madhe u shprehën se janë në dijeni, ndërkohë që pjesa tjetër u shpreh se nuk ka dijeni për to.

Edhe pse pyetja në fjalë, shoqërohet nga stimulimi i të intervistuarve për të dhënë shembuj konkretë, ata që u shprehën se janë në dijeni, nuk kanë përcjellë shpjegim të shtjelluar mbi praktikrat më të mira.

Vetëm një nga intervistuarit ka shpjeguar të tilla praktika duke përmendur se ndërmjet Pikave të Kalimit Kufitar operohet me kushte dhe teknologji bashkëkohore, ku bashkëpunimi reciprok ndërmjet dy shteteve fqinje, patrullimi i përbashkët në zonën e gjelbërt, vendosja e kamerave termike (PKK tokësorë), përdorimi i skanerave për mjetet, bashkëpunimi me doganat, etj., janë një sërë veprimesh të cilat ndihmojnë në identifikimin e rasteve. Rekomandohet që punonjësit e strukturave të posaçme të vihen në dijeni për praktikrat më të mira lokale, rajonale dhe ndërkombëtare mbi sigurinë e qenieve njerëzore dhe kufijve.

Përsa i përket rolit që kanë palët e interesuara jashtetërore si përshembull organizata të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare, media, sektori privat, etj., në adresimin e çështjeve të trafikimit të migrantëve dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre, të intervistuarit unanimisht e vlerësojnë atë si rol shumë të rëndësishëm mbështetës në parandalimin dhe evidentimin e rasteve, sikurse dhe në ri-integrimin e migraenteve si viktima të trafikimit.

Vlerësim shumë të mirë kanë marrë edhe partnerët/donatorët ndërkombëtarë të cilët kanë mbështetur institucionet shqiptare në lidhje me parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të migrantëve dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Në këtë kuadër është sjellë dhe një shembull suksesi, në të cilën punonjësi kishte identifikuar një shtetase të si viktimë e mundshme e trafikimit, e cila falë mbështetjes ndërmjet institucionit dhe partnerit ndërkombëtar, arriti të riatdhesohej shumë shpejt pranë familjes së saj.

Marrëveshja me Frontex për të luftuar trafikimin e migrantëve është vlerësuar maksimalisht nga të gjithë të intervistuarit, duke e konsideruar patrullimin e përbashkët në kufi midis

efektivëve të Policisë së Shtetit/Departamentit të Kufirit dhe atyre të Frontex si një nga përvojat më të mira për mënyrën e organizimit të punës dhe të bashkëpunimit reciprok.

Përsa i përket bashkëpunimit me EUROPOL, një pjesë e të intervistuarve e vlerësojnë atë si shumë të mirë, e pjesa tjetër e vlerëson si të mirë. Nga ky rezultat, rekomandohet që rastet e bashkëpunimit të analizohen me kujdes dhe të evidentohen faktorët që i pengojnë ato për të qënë bashkëpunime “shumë të mira”.

Opinionit ndërkombëtar

Pjesë e këtij raporti studimi janë dhe gjetjet e pyetësorit drejtuar “International Organization for Migration” (IOM). Ky i fundit u pyet për vlerësimin për sa i përket parandalimit të trafikimit të migrantëve dhe respektimit të të drejtave të tyre. IOM-i vlerëson se institucionet në Shqipëri ndjekin rregullisht Procedurat Standarde të Operacionit në identifikimin, referimin dhe ndihmën që duhet t'u ofrohet migrantëve. Të drejtat e migrantëve të njohura në instrumentet ndërkombëtare janë transpozuar në legjislacionin shqiptar, i cili është në përputhje të vazhdueshme me *acquis* të BE-së. Ministria e Brendshme është e angazhuar vazhdimisht me partnerët rajonalë dhe një shembull i mirë konkret është Marrëveshja e Bashkëpunimit e nënshkruar me FRONTEX. Theksohen përpjekjet që Ministria e Brendshme bën për të punuar në nivel kombëtar dhe rajonal për shkëmbimin e rregullt të të dhënave dhe statistikave për migracionin. Policia e Shtetit Shqiptar ka ndërmarrë hapa konkretë dhe ka shembuj të mirë të Grupeve të Përbashkëta Hetimore dhe shkëmbimit efikas të të dhënave jopersonale për të parandaluar dhe reduktuar rrezikun e kontrabandës në nivel kombëtar dhe rajonal.

Përsa i përket pyetjes nëse ka nevojë të përmirësohet kuadri rregullator, sipas praktikave më të mira të BE-së dhe/ose standardeve ndërkombëtare, IOM shprehet se në vitin 2019, Strategjia e re Kombëtare për Migracionin dhe Plani i saj i Veprimit (2019-2022), i zhvilluar me asistencën e IOM-it, është miratuar nga Qeveria e Shqipërisë, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 400/19.6.2019. Në mbështetje të zbatimit të Strategjisë, IOM ka kryer në vitin 2020 një vlerësim të thelluar të kapaciteteve institucionale për qeverisjen e migracionit dhe ka dhënë rekomandime për institucionet e përfshira. IOM po mbështet sistemin e koordinimit dhe monitorimit të Strategjisë me ekspertizë shtesë të vendosur në Sekretariatit Teknik për Migrim në Ministrinë e Brendshme.

Përsa i përket pyetjes nëse në Ministrinë e Brendshme dhe Policinë e Shtetit nevojiten ndryshime në strukturat përgjegjëse për migracionin dhe azilin, për të përballuar siç duhet sfidat e migrimin të parregullt, IOM shprehet se referuar vlerësimin institucional të kryer nga IOM, kërkohet rritje e koordinimit ndërmjet institucioneve të përfshira në menaxhimin e migracionit në Shqipëri. Ekziston nevoja për të përfshirë më gjerësisht shërbimet sociale dhe për të adoptuar një qasje më të fokusuar në rishikimin e strukturave dhe kuadrit rregullator në Shqipëri. Ekziston nevoja për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit, përkatësisht Policisë Kufitare dhe Migracionit, Anti-Trafikimit dhe shërbimeve të mbrojtjes sociale (Shërbimi Social Shtetëror dhe Agjencia Shtetërore e Fëmijëve).

Rekomandime të dala nga pyetëtorët

- ❖ Burimet njerëzore të strukturave përkatëse të hartojnë një plan konkret trajnimi të herëpashershëm për njohuritë teorike dhe praktike të punonjësve;
- ❖ Legjislacioni kombëtar nevojitet të rishikohet dhe përafrohet tërësisht me *acquis* të Bashkimit Evropian;
- ❖ Punonjësit të informohen dhe të njihen me llojet e masave që institucioni shtetëror duhet të ndërmarë për të parandaluar trafikimin e migrantëve;
- ❖ Të rriten kapacitetet njerëzore, logjistike dhe hetimore;
- ❖ Bashkëpunimi rajonal dhe shkëmbimi i informacionit për parandalimin e trafikimit të migrantëve duhet analizuar me kujdes për të kuptuar qartë se cilët janë faktorët që ndikojnë në mungesën e vlerësimit maksimal. Drejtuesit e strukturave përkatëse duhet të adresojnë pengesat dhe vështirësitë me të cilat përballen punonjësit e tyre në raport me homologët e huaj, në aspektin e kuadrit ligjor, administrativ dhe procedural;
- ❖ OSHC-të që operojnë në parandalimin e trafikimit të migrantëve dhe mbrojtjen e migrantëve të trafikuar, duhet të rishikojnë mënyrën e zbatimit të projekteve të tyre dhe adresimin e nevojave të target grupeve. Donatorët duhet të tregojnë kujdes në monitorimin e zbatimit të projekteve të tilla, si dhe vlerësimin e përmbushjes së qëllimit nëse arrin në nivelin e pritshëm ose jo;
- ❖ Sfidat e adresuara në lidhje me parandalimin e trafikimit të migrantëve, të përfshihen në planet vjetore të veprimit, duke i zbërthyer në nënaktivitete, në mënyrë të tillë që të shërbejnë si indikatorë matës drejt përmbushjes së qëllimit brenda një periudhe të caktuar kohore;
- ❖ Të trajtohet me kujdes niveli i rishikimit dhe përmirësit të kuadrit ligjor dedikuar mbrojtjes së migrantëve të trafikuar;
- ❖ Të analizohen rastet e bashkëpunimit midis agjencive të ndryshme shtetërore në lidhje me mbrojtjen e migrantëve të trafikuar, si dhe me EUROPOL të cilësuar si “të mira”, dhe të evidentohen faktorët që i pengojnë ato për t’u cilësuar si bashkëpunime “shumë të mira”;
- ❖ Punonjësit e strukturave të posaçme të vihen në dijeni për praktikat më të mira lokale, rajonale dhe ndërkombëtare mbi sigurinë e qenieve njerëzore dhe kufijve;
- ❖ Nevojitet trajnim i specializuar për punonjësit e pikave kufitare;
- ❖ Të rritet koordinimi ndërmjet institucioneve të përfshira në menaxhimin e migracionit në Shqipëri;
- ❖ Të përfshihen më gjerësisht strukturat përkatëse të shërbimit social;
- ❖ Të përmirësohet bashkëpunimi ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve të mbrojtjes sociale.

KREU VII

PËRFUNDIME

Nisur nga analizimi dhe interpretimi i mësipërm i të dhënave mbi situatën e flukseve migratore, arrihet në konkluzionin se Shqipëria vazhdon ende të preket nga shifra të larta të migrantëve të parregullt, ku shumica prej tyre e shohin atë si vend tranziti drejt vendeve të BE-së. Për situata emergjence në rast fluksesh të mëdha migratore, Ministria e Brendshme së fundmi ka miratuar dhe planin e ri të kontigjencës, me qëllim krijimin e kapaciteteve të nevojshme pritëse, kapaciteteve logjistike e organizative, duke mbajtur parasysh elementët e sigurisë dhe atë të respektimit të të drejtave të migrantëve të parregullt.

Në drejtim të legjislacionit lidhur me çështjet migratore, legjislacioni shqiptar në tërësinë e tij është në përputhje me aktet ndërkombëtare në këtë fushë, kryesisht me konventat e OKB-së dhe ato të Këshillit të Europës, por pjesërisht dhe me *acquis* të BE. Garantimi dhe respektimi i të drejtave të migrantëve, duhet theksuar se, gjejnë vend në legjislacionin tonë të brendshëm në një nivel të kënaqshëm.

Në kuadrin e dokumentave strategjikë, dy strategjitë kryesore në fushën e migracionit, Strategjia Kombëtare për Migracionin 2019-2022 dhe Strategjia Ndërsektoriale për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2021-2027, janë hartuar në të njëjtën frymë me dokumentat e rëndësishëm ndërkombëtarë dhe në përputhje me dy koncepte shumë të rëndësishme: *qeverisja e migracionit* dhe *menaxhimi i integruar i kufirit*.

Sa i përket parandalimit të migracionit të parregullt drejt Shqipërisë dhe kontrabandimit të migrantëve, institucionet përgjegjëse shqiptare janë të fokusuara në drejtim të:

- forcimit të kontrollit kufitar;
- rritjes së kapaciteteve hetuese dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kontrabandimit të migrantëve;
- forcimit të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese evropiane si: FRONTEX, EUROPOL, etj.
- rritjes së bashkëpunimit me vendet fqinje në drejtim të kontrollit kufitar.

Bashkëpunimi ndërkombëtar vitet e fundit, duke filluar nga viti 2018, ka shënuar rritje në drejtim të forcimit të kontrollit kufitar dhe luftës ndaj krimit ndërkufitar, përfshi këtu migracionin e paligjshëm dhe kontrabandimin e migrantëve. Shqipëria, u bë vendi parë në Ballkanin Perëndimor që nënshkroi dhe ratifikoi Marrëveshjen Statusore me FRONTEX, duke bërë të mundur kryerjen e operacione të përbashkëta, kryesisht në kufirin jugor me Greqinë. Gjithashtu, bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit kufitar me vendet fqinje, gjatë këtyre viteve janë zhvilluar patrullime të përbashkëta në kufi, me qëllim rritjen e sigurisë kufitare, por dhe parandalimin e migracionit të parregullt.

Institucionet shtetërore përgjegjëse në fushën e migracionit vazhdojnë të bashkëpunojnë me organizatat ndërkombëtare dhe ato të shoqërisë civile nëpërmjet dhënies së asistencës për përmirësimin e kuadrin rregullator e strategjik në këtë fushë, por edhe në atë të ofrimit të

shërbimeve ndaj migrantëve të parregullt duke iu siguruar akses në të drejtat bazike si ushqimi, veshja, strehimi, asistencë psikologjike, njohja me të drejtat e tyre, përkthimi etj.

Në drejtim të zbatimit të kuadrit rregullator dhe strategjik, Shqipëria deri në vitin 2020 ka ndërtuar dhe forcuar kapacitetet e saj institucionale dhe ato logjistike duke siguruar një standart të mirë të zbatimit të legjislacionit në fushën e migracionit. Gjithësesi, ende gjendet para sfidave të reja me hyrjen në fuqi të shumë ligjeve të reja që prekin fushën e migracionit (*ligji për azilin, ligji për të huajt*), por edhe të strategjive të reja në këtë fushë që prekin çështje të migracionit të parregullt dhe të të drejtave të migrantëve.

KREU VIII

REKOMANDIME

Bazuar në analizën shumë dimensionale të të dhënave, studimi jep rekomandimet e mëposhtme:

→ Në drejtim të përmirësimit të kuadrit rregullator rekomandohet:

- Vlerësimi dhe rishikimi i legjislacionit që lidhet me strehimin, arsimin, shëndetin, punësimin, asistencën ligjore dhe përkujdesjen sociale, për të siguruar përputhshmërinë maksimale me standartet e BE –së ;
- Forcimi i sistemit të kujdestarisë për fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë duke zbatuar në mënyrë efektive Rekomandimin e Komitetit të Ministrave CM/Rec(2019)11 “Mbi kujdestarinë efektive për fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë në kontekstin e migrimit”;
- Negociimi dhe miratimi sa më parë i Marrëveshjeve të Ripranimit me vendet që kanë numrin më të madh të migrantëve të parregullt të identifikuar në kufi dhe brenda territorit shqiptar si Iraku, Irani, Siria, Afganistani, Pakistani, Maroku, etj.;
- Vlerësimi dhe rishikimi i nenit 298 të Kodit Penal për dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit, në përputhje me Udhëzimet e fundit të Komisionit Evropian⁹³ të Shtatorit 2020;
- Miratimi sa më parë i paketës së plotë të akteve nënligjore për Ligjin “Për të huajt” dhe Ligjin “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” ;
- Hartimi dhe zbatimi i standardeve minimale për kushtet e pritjes dhe shërbimeve për migrantët e parregullt për të siguruar përputhjen me standartet evropiane të të drejtave të njeriut dhe Direktivës 2013/33/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 26 Qershor 2013, që përcakton standartet për pritjen e aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare;

→ Në drejtim të përmirësimit të planeve të veprimit, procedurave, udhëzuesve dhe raporteve të monitorimit rekomandohet:

- Hartimi i një Plan Veprimi specifik nga Policia e Shtetit për luftën ndaj kontrabandimit të migrantëve, nëpërmjet koordinimit sa më të mirë të Departamentit të Policisë Kriminale, Departamentit të Policisë Kufitare dhe Migracionit dhe Departamentit të Rendit dhe Sigurisë Publike;
- Vlerësimi dhe hartimi sa më parë i procedurave në lidhje me kthimin vullnetar të asistuar të migrantëve të parregullt, duke inkurajuar autoritetet përgjegjëse shtetërore të marrin masat përkatëse për zbatimin më të gjerë të kësaj procedure kthimi, pasi garanton një standart më të lartë të respektimit të të drejtave të migrantëve;
- Hartimi nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Antitrafikut dhe Migracionit dhe Drejtoria e Azilit), në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe Migracionit si

⁹³ https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/commission-guidance-implementation-facilitation-unauthorised-entry_en.pdf

dhe INSTAT, i një udhëzuesi mbi procedurën e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave lidhur me migrantët e parregullt⁹⁴;

- Të hartohen rregullisht raporte monitorimi mbi:
 - efektshmërinë dhe zbatimin në praktikë të legjislacionit e ri të sapo miratuar, që prek fushën e migracionit;
 - zbatimin e Strategjisë për Migracionin dhe Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, duke identifikuar problematikat që kryesisht kanë të bëjnë me migracionin e parregullt, të drejtat që lidhen me këtë kategori migrantësh dhe luftën ndaj kontrabandimit të migrantëve;
- Hartimi dhe zbatimi i një Plan Veprimi nga Ministria e Brendshme lidhur me zbatimin e rekomandimeve për të drejtat e migrantëve, të dala nga raportet e monitorimit të:
 - Institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut si: Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, etj;
 - Organizatave ndërkombëtare veprimtaria e të cilave lidhet me migracionin dhe Shqipëria ka bashkëpunim të ngushtë;
 - Institucioneve ndërkombëtare si: Departamenti Amerikan i Shtetit, Komisioni Evropian, Këshilli Europës...etj.;

→ **Në drejtim të përmirësimit të strukturës së institucioneve shtetërore përgjegjëse në fushën e migracionit:**

- Forcimi i strukturave të migracionit dhe azilit në Ministrinë e Brendshme, nëpërmjet shtimit të burimeve njerëzore (rritje e numrit të stafit) dhe rritjes së kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të ofruara nga IOM, UNHCR, OSCE, MARRI, EASO, etj.;
- Forcimi i kapaciteteve në burime njerëzore, logjistike dhe hetuese të Policisë Kufitare nëpërmjet rritjes së numrit të punonjësve të policisë kufitare dhe trajnimit të vazhdueshëm të tyre mbi praktikën më të mira evropiane, pajisja e vazhdueshme me mjete bashkëkohore të mbikqyrjes së kufirit;
- Rikthimi i njësisë së hetimit në policinë kufitare dhe forcimi i kapaciteteve hetuese ndaj krimit ndërkufitar me fokus luftën ndaj migracionit të paligjshëm.

⁹⁴ **Shpjegim:** Evidencat e sakta, do të jenë një bazë e mire për të hartuar dhe implementuar politika më të mira dhe efektive në lidhje me parandalimin e migracionit të parregullt, garantimin e të drejtave migrantëve të parregullt dhe luftën ndaj kontrabandimit të migrantëve. Gjithashtu, këto të dhëna statistikore duhet të përmbajnë dhe të dhëna të sakta mbi kthimet e migrantëve të ndara sipas llojit të kthimeve: dëbim ose largim vullnetar dhe sa të rritur e sa fëmijë. Aktualisht të dhëna të tilla të specifikuar është pothuajse e pamundur t'i gjejmë në raportet e publikuara nga institucionet përgjegjëse.

BIBLIOGRAFIA

○ Dokumente dhe raporte zyrtare:

1. IOM Glossary on Migration: https://publications.iom.int/system/files/pdf/iml_34_glossary.pdf
2. Analiza vjetore e Policisë së Shtetit 2019: <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Policia-e-Shtetit-ANALIZA-VJETORE-2019.pdf,fq.16>
3. MARRI, 25 January 2021- Analysing the COVID-19 influence on migration in the MARRI Participants: http://marri-rc.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/FINAL-REPORT_Analysing-the-influence-of-COVID-19-on-migration-in-the-MARRI-Praticipants-1.pdf?fbclid=IwAR0KLKkK275b50Q71vMq0XxZ9e781PfdV5sYoPf5iePilGoqWFuMEPpjLU
4. Frontex, Risk Analysis for 2020: <https://frontex.europa.eu/publications/frontex-releases-risk-analysis-for-2020-vp0TZ7>
5. Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani Veprimit 2019-2022: https://www.mb.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Migracionin-dhe-Plani-i-Veprimit_2019-2022.pdf
6. Raport i Komisionit Evropian për Shqipërinë, publikuar në tetor 2020: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf
7. Raport i Komisionit Evropian për Shqipërinë, viti 2019: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2019-07/20190529-albania-report.pdf>
8. [How COVID-19-related crime infected Europe during 2020 | Europol \(europa.eu\): https://www.europol.europa.eu/publications-events/publications/how-covid-19-related-crime-infected-europe-during-2020](https://www.europol.europa.eu/publications-events/publications/how-covid-19-related-crime-infected-europe-during-2020)
9. 2020 Trafficking in Persons Report_Departament of State, Albania: <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2020/06/2020-TIP-Report-Complete-062420-FINAL.pdf>
10. GRETA- Evaluation Report, Albania, publikuar më 15 dhjetor 2020 https://www.ecoi.net/en/file/local/2042302/GRETA_2020_09_FGR_ALB_en.docx.pdf
11. Annual Report “Fundamental Rights Officer 2020” https://frontex.europa.eu/assets/Key_Documents/FRO_reports/FRO_Annual_Report_2020.pdf
12. 2021 Joint Work Plans – Mid- year Review of Programme of Cooperation for Sustainable Development (Government of Albania and UN)
13. Profili i Zgjeruar Kombëtar i Migracionit për vitet 2015–2018 <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/03/12/222>
14. Raporti vjetor mbi zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2019-2022, për periudhën qershor 2019-qershor 2020: <https://mb.gov.al/plane-dhe-strategji/>
15. Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027 dhe planit të veprimit 2021-2023, miratuar me VKM nr.1117, dt.16.12.2020 <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/16/1117>
16. Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe plani i veprimit 2021–2022, miratuar me VKM nr. 1140, dt.24.12.2020: <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2021/01/STRATEGJIA-KUND%C3%8BR-KRIMIT-T%C3%8B-ORGANIZUAR-DHE-KRIMEVE-T%C3%8B-R%C3%8BNDA-2021-2025-DHE-PLANI-I-VEPRIMIT-2021-2022.docx>

17. Udhëzime për zbatimin e rregullave të BE -së për përcaktimin dhe parandalimin e lehtësimit të hyrjes, tranzitit dhe qëndrimit të paautorizuar-Dokument i Komisionit Evropian
https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/commission-guidance-implementation-facilitation-unauthorised-entry_en.pdf
18. Pakti i ri mbi Migracionin dhe Azilin –Dokument i Komisionit Evropian:
https://ec.europa.eu/home-affairs/news/new-pact-migration-and-asylum-setting-out-fairer-more-european-approach-2020-09-23_en
19. COMMUNICATION FROM THE COMMISSION on a New Pact on Migration and Asylum, Brussels 23.09.2020
<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52020DC0609>
20. Guidelines for Integrated Border Management in European Commission External Cooperation, extracted version march 2015
<https://www.icmpd.org/content/download/48352/file/Guidelines%20for%20Integrated%20Border%20Management%20in%20the%20European%20Commission%20External%20Cooperation%20-%20Extracted%20Version%20EN.pdf>
21. Eurojust Annual Report 2020 (4.3.1 Migrant Smuggling)
https://www.eurojust.europa.eu/sites/default/files/Documents/pdf/eurojust_annual_report_2020.pdf
22. Research Report of Global Initiative Against Transnational Organized Crime “Spot Prices- Analyzing flows of people, drugs and money in the Western Balkans”
<https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/05/Spot-Prices-Analyzing-flows-of-people-drugs-and-money-in-the-Western-Balkans-1.pdf>
23. UNODC, Global Study on Smuggling of Migrants 2018
https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/glosom/GLOSOM_2018_web_small.pdf
24. Recommendation 2171 (2020) “Concerted action against human trafficking and the smuggling of migrants”
<http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=28594&lang=en>
25. Policy Briefing of European Parliamentary Research Service “Understanding EU action against migrant smuggling”
[https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2021/659450/EPRS_BRI\(2021\)659450_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2021/659450/EPRS_BRI(2021)659450_EN.pdf)
26. Interpol “People smuggling – the issues” <https://www.interpol.int/Crimes/People-smuggling>
27. 2019 Report on Illegal Migration in Southeast Europe
https://www.selec.org/wp-content/uploads/2020/04/SELEC-Report-on-Illegal-Migration-in-SEE_public-version.pdf
28. UNODC, Observatory on Smuggling of Migrants
https://www.unodc.org/res/som/docs/Observatory_Methodological_Guide.pdf
29. Europol (2021), European Migrant Smuggling Centre - 5th Annual Report [EUROPEAN MIGRANT SMUGGLING CENTRE 5th ANNUAL REPORT | Europol \(europa.eu\)](https://www.europol.europa.eu/europol-5th-annual-report)
30. Vulnerable Asylum Seekers and Irregular Migrants in Albania Trends, Challenges, and Policy Solutions –Policy Brief, IDM June 2019
https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/policy-brief_Vulnerable-asylum-seekers-and-irregulat-migrants.pdf
31. Illegal immigration along Western Balkan Route and neighbouring countries, July 2018 - June 2019 EUROPOL, FRONTEX AND EASO JOINT REPORT
<https://www.statewatch.org/media/documents/news/2020/feb/eu-europol-frontex-easo-wb-smuggling-report.pdf>

32. European Union Serious and Organised Crime Threat Assessment (EU SOCTA) 2021
<https://www.europol.europa.eu/publication-events/main-reports/european-union-serious-and-organised-crime-threat-assessment-socta-2021>
33. UNODC Toolkit to Combat Smuggling of Migrants https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/SOM_Toolkit_E-book_english_Combined.pdf
34. FRONTEX Risk Analysis for 2021
<https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/2e68fde4-de04-11eb-895a-01aa75ed71a1/language-en>
35. KShH –Raport Monitorimi “Mbi të drejtat dhe liritë e emigrantëve, azilkërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri”
https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/03/Raport-monitorimi_Mbi-te-drejtat-dhe-lirite-e-emigranteve-azilkerkuesve-dhe-refugjateve-ne-Shqiperi_compressed.pdf

○ **Faqet zyrtare të institucioneve**

1. IOM <https://www.iom.int/about-migration>
2. Ministria e Brendshme
 - https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/T%C3%AB-dh%C3%ABna-p%C3%ABr-migracionin-dhe-Azilin_2015-2020.pdf;
 - <https://mb.gov.al/plane-dhe-strategji/>
 - <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2020/10/RELACION-AZILI.pdf>
 - <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2021/11/BULETINI-SHTATOR-2021.pdf>
 - <https://mb.gov.al/2021/03/17/nenshkruhet-marreveshja-mes-mb-e-frontex-ministri-cuci-shqiperia-kandidat-i-denje-per-tu-bere-pjese-e-be/>
 - <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2019/01/Relacion-per-projektligjin-Per-Shtetesine.doc>
3. Kuvendi i Shqipërisë
 - <http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20190204100419Raport%20Marreveshja%20Bashkepunimi%20Roja%20Bregdetare%20BE.pdf>
 - <http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20210705135531ligj%20nr.%2079%20dt.%2024.6.2021.pdf>;
 - <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200227102321relacion%20ligji%20%2071%20kontrolli%20kufitar.doc%20final.pdf>
4. Qendra e Publikimeve Zyrtare
 - <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/03/12/222>
 - <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>
 - <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/03/06/111>
 - <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2021/02/01/10>
 - <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/07/29/113>
 - <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/03/05/22>
5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/Ligj-nr-69-21-06-2012-1.pdf>
6. FRONTEX
 - <https://frontex.europa.eu/media-centre/news/news-release/july-increase-in-the-central-med-and-western-balkans-IOsJpO>;
 - https://frontex.europa.eu/assets/Key_Documents/Working_Arrangements/WA_with_Albania_2021.pdf

7. OHCHR
<https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Migration/GlobalCompactMigration/IrregularMigrants.pdf>
8. European Commission /Migration and Home Affairs
https://ec.europa.eu/home-affairs/news/new-pact-migration-and-asylum-setting-out-fairer-more-european-approach-2020-09-23_en
9. EU-Lisa (European Union Agency for the Operational Management of Large-Scale IT Systems in the Area of Freedom, Security and Justice)
<https://www.eulisa.europa.eu/Activities/Large-Scale-It-Systems/Eurodac>
10. EUROJUST (European Union Agency for Criminal Justice Cooperation)
<https://www.eurojust.europa.eu/eurojust-steps-fight-against-migrant-smuggling>

Aneks 1

Pyetësor

Për t'u plotësuar nga intervistuesi	
Data e intervistës	
Mënyra e zhvillimit të intervistës (<i>fizikisht ose elektronikisht</i>)	
Emri i departamentit/institucionit/organizatës	

Ky pyetësor është bërë për qëllimet e projektit "Siguria për Qeniet Njerëzore dhe Kufijtë - Luftimi i Kontrabandës së Migrantëve në Ballkanin Perëndimor" që u zhvillua si përgjigje rajonale e 7 OSHC -ve të lidhura me Këshillin Ballkanik për Refugjatët dhe Migracionin (BRMC) përfshirë këtu Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), për problematikën e madhe të përbashkët *Rrugës së Migrimit të Ballkanit Perëndimor - kontrabandimin e emigrantëve*. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian në kuadër të Programit të Ndihmës dhe Shoqërisë Civile 2018-2019 nën thirrjen "Rritja e angazhimit të OSHC-ve në menaxhimin e migrimit të ndjeshëm ndaj mbrojtjes".

Objektivi i përgjithshëm është kontributi në procesin e përafrimit të BE -së duke krijuar menaxhim mbrojtës të ndjeshëm të migrimit në BP me një ekuilibër të mirë midis sigurisë dhe mbrojtjes së kufirit të vendeve dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të migrantëve.

Me pjesëmarrjen tuaj në pyetësorin e mëposhtëm, ju po mbështetni ekipin tonë për të hulumtuar dhe analizuar:

- kuadrin ligjor dhe strategjik të 3 viteve të fundit (2018 - 30 qershor 2021) duke dhënë një pasqyrë të plotë të fenomenit të migrimit të parregullt në Shqipëri;
- zbatimin e legjislacionit dhe politikave në tërësi;
- identifikimin e çështjeve që lidhen me një mjedis të sigurt për migrantët dhe aksesin që ata kanë në të drejtat e tyre themelore, përfshirë çështjet që lidhen me parandalimin e fenomenit të kontrabandës;
- Rekomandime / Sugjerime kryesisht (por jo vetëm) për aktorët shtetërorë në drejtim të përmirësimit të politikave, zbatimit të tyre, bashkëpunimit rajonal dhe shoqërisë civile.

Formulari i dhënies së pëlqimit

Unë e kam lexuar informacionin e mësipërm për këtë projekt

- po
- jo

Unë jam bërë me dije se informacioni i mbledhur në këtë pyetsor do të paraqitet si "anonim" dhe se identiteti im nuk do të ekspozohet në asnjë nga materialet e prodhuara nga projekti i KShH.

- po
- jo

Seksioni 1: Informacion i përgjithshëm

1. Gjinia:

- Femër
- Mashkull
- Tjetër

2. Cili është institucioni/departamenti/organizata për të cilën ju punoni?

3. Cili është pozicioni juaj ?

4. Sa vite punë keni në instituconin ku ju aktualisht punoni?

- 0-5 vite
- 5-10 vite
- Më shumë se 10 vite

6. Fizikisht, puna juaj është:

- Kryesisht në terren, me kontakt personal direkt me migrantë të parregullt apo të kontrabanduar
- Kryesisht në zyrë, pa kontakt direkt

- Të dyja bashkë. Mund të jetë në të dyja format, varet nga:

7. Si do t'i përkufizonit ju me pak fjalë termat “parandalim i kontrabandimit të migrantëve” dhe “mbrojtja e të drejtave të migrantëve të kontrabanduar” ?

Seksioni 2: Parandalimi i kontrabandimit të migrantëve

8. A ekziston një kuadër ligjor gjithpërfshirës/i plotë ose dokumente strategjike që lidhen me parandalimin e kontrabandimit të emigrantëve? Nëse po, ju lutemi përmendini ato për të cilat keni dijeni.

9. A mendoni se ka ende nevojë për të përmirësuar ose përafruar legjislacionin ekzistues sipas standardeve të BE -së? (zgjidhni një nga opsionet e mëposhtme)

- Po
- Disi
- Jo
- Nuk e di

10. A ka ndonjë rregullore/protokoll apo PSV, për agjenci të ndryshme, për të identifikuar një migrant të kontrabanduar? Nëse po, ju lutemi shpjegoni diçka për të.

11. Si procedoni ju pasi keni identifikuar një migrant të kontrabanduar?

12. Cilat janë masat e marra nga agjencia/institucioni/departamenti juaj për të parandaluar kontrabandimin e emigrantëve? Ju lutemi, përmendni disa prej tyre.

13. A mendoni se nevojiten më shumë burime njerëzore dhe logjistike për të luftuar kontrabandën e migrantëve? Ju lutemi jepni një vlerësim nga 1 (nuk nevojitet fare) në 5 (shumë e nevojshme)

1 2 3 4 5

14. A mendoni se ka ende nevojë për të rritur kapacitetet hetimore për të luftuar kontrabandën e emigrantëve? Ju lutemi jepni një vlerësim nga 1 (nuk nevojitet fare) në 5 (shumë e nevojshme)

1 2 3 4 5

14. A jeni të kënaqur me bashkëpunimin aktual rajonal dhe shkëmbimin e informacionit për parandalimin e kontrabandimit të migrantëve? (zgjidhni një nga opsionet e mëposhtme)

- Aspak i kënaqur
- Disi i kënaqur
- I kënaqur
- Shumë i kënaqur

15. Si e vlerësoni rolin e OSHC-ve në parandalimin e kontrabandimit të migrantëve? (zgjidhni një nga opsionet e mëposhtme)

- Shumë i mirë
- I mirë
- Jo aq i mirë
- I dobët

16. Cilat janë sfidat kryesore, sipas mendimit tuaj, në parandalimin e kontrabandimit të emigrantëve?

Seksioni 3: Mbrojtja e migrantëve të kontrabanduar

17. A mendoni se legjislacioni dhe dokumentet tona strategjike i plotësojnë kriteret ndërkombëtare apo ato të BE-së për mbrojtjen e migrantëve të kontrabanduar? (Ju lutemi, jepni një shpjegim të shkurtër për këtë)

18. A konsideroni se zyrtarët që janë në kontakt me migrantët e kontrabanduar kanë njohuri të mjaftueshme për trajtimin e tyre në respektim të të drejtave të njeriut? (zgjidhni një nga opsionet e mëposhtme)

- Po, kanë.
- Po, pjesërisht kanë.
- Jo, nuk kanë.
- Nuk e di.

19. A mendoni se ka nevojë për të përmirësuar kuadrin rregullator në lidhje me mbrojtjen e migrantëve të kontrabanduar? Ju lutemi jepni një vlerësim nga 1 (nuk nevojitet fare) në 5 (shumë e nevojshme)

1 2 3 4 5

20. Si e vlerësoni bashkëpunimin midis agjencive të ndryshme shtetërore në lidhje me mbrojtjen e migrantëve të kontrabanduar? (zgjidhni një nga opsionet e mëposhtme)

- Shumë të mirë
- Të mirë
- Jo aq të mirë
- Të dobët

A mund të ndani eksperiencën tuaj mbi këtë çështje?

21. Kur konsiderohen migrantët e kontrabanduar si Viktima të Mundshme Trafikimi (VMT)? (zgjidhni një nga opsionet e mëposhtme)

- Gjithmonë
- Në disa raste
- Asnjëherë

A mund të ndani eksperiencën tuaj mbi këtë çështje?

22. A është afektuar shumë sistemi ynë i azilit nga ky target grup (migrantët e kontrabanduar)? Ju lutemi jepni një vlerësim nga 1 (aspak i prekur) në 5 (shumë i prekur)

1 2 3 4 5

22. Si e vlerësoni rolin e OSHC-ve në drejtim të mbrojtjes së migrantëve të kontrabanduar? (zgjidhni një nga opsionet e mëposhtme)

- Shumë të mirë
- Të mirë
- Jo aq të mirë
- Të dobët

Seksioni 4: Praktikrat më të mira mbi sigurinë e qenieve njerëzore dhe kufijve

23. A jeni në dijeni të praktikave më të mira lokale apo rajonale/ndërkombëtare mbi sigurinë e qenieve njerëzore dhe kufijve? (nëse po, jepni një shpjegim të shkurtër)

- Po
 - Jo
-
-
-

24. Sipas mendimit tuaj, a munden palët e interesuara joshtetërore (organizata të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare, media, sektori privat, etj.) të luajnë një rol më aktiv në adresimin e çështjeve të kontrabandës së migrantëve dhe mbrotjes së të drejtave të tyre? (nëse dini ndonjë shembull të praktikës më të mirë, ju lutemi shpjegojeni shkurt)

25. Si e vlerësoni rolin e partnerëve/donatorëve ndërkombëtarë në mbështetjen e agjencisë/institucionit/departamentit tuaj në lidhje me çështjen e parandalimit dhe luftës ndaj kontrabandimit të migrantëve dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre? (zgjidhni një nga opsionet e mëposhtme)

- Shumë të mirë
- Të mirë
- Jo aq të mirë
- Të dobët

Nëse dini ndonjë shembull të praktikës më të mirë, ju lutemi shpjegojeni shkurt

26. Si e vlerësoni Marrëveshjen me Frontex për të luftuar kontrabandën e migrantëve? Ju lutemi jepni një vlerësim nga 1 (aspak efektive) në 5 (shumë efektive)

1 2 3 4 5

A mund të përmendni një rast të praktikës më të mirë ose dicka nga përvoja juaj lidhur me këtë?

27. Si e vlerësoni bashkëpunimin mes agjencive tona zbatuese dhe EUROPOL -it në luftën kundër kontrabandës së migrantëve? (zgjidhni një nga opsionet e mëposhtme)

- Shumë i mirë
- I mirë

- Jo aq i mirë
- I dobët

A mund të përmendni një rast të praktikës më të mirë ose dicka nga përvoja juaj lidhur me këtë?
